

INDEKSI

Kosovar i Shoqërisë Civile 2016

Tetor 2016



Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është përgatitur nga ekipi i hulumtimit të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile.

AUTOR

Taulant Hoxha

BASHKËAUTORE DHE UDHËHEQËSE E HULUMTIMIT

Erëblina Elezaj

EKIPI I HULUMTUESVE TË KCSF-së

Nart Orana

Donika Elshani

Mirjeta Ademi

EKIPI I HULUMTUESVE TË JASHTËM

Kujtim Kryeziu – Intervistues

Kushtrim Mustafa – Intervistues

Diellza Kosumi – Intervistuese

Fisnik Ferizi – Intervistues

Yllza Xheladini – Intervistuese

Andi Emimi – Intervistues

Agon Ahmeti – Intervistues

Ky publikim është përkrahur financiarisht nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), nëpërmjet projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP). KCSF mbështetet nga Sida.

Përmbajtja e këtij publikimi është në tërësi përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdomeërisht qëndrimet e SCO-K apo Sida-s.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	7
Hyrje	9
Metodologjia	10
Struktura e shoqërisë civile në Kosovë.....	14
Korniza ligjore	22
Liria e asocimit.....	23
Liritë e tjera	25
Raportimi financiar	27
Auditimet financiare	29
Aktivitetet ekonomike të OJQ-ve.....	30
Stimulimet për donatorët e OShC-ve	31
Statusi për përfitim publik	32
Qeverisja dhe kapacitetet e brendshme	34
Organet udhëheqëse	35
Vendimmarrja.....	36
Dokumentet e brendshme dhe transparenca	37
Të punësuarit.....	38
Rekrutimi i të punësuarëve	41
Kapacitetet e brendshme.....	42
Infrastruktura përkrahëse për shoqërinë civile	47
Rrjetëzimi dhe komunikimi	49
Angazhimi i qytetarëve.....	52
Aktivizmi qytetar.....	53
Vullnetarizmi	55
Financimi	58
Qarkullimi vjetor.....	59
Burimet e financimit	60
Trendët e planifikimit dhe të financimit	62
Llojet e përkrahjes.....	63
Programimi i fondeve të donatorëve	66
Ndikimi i donatorëve në punën e OShC-ve.....	68
Fondet e BE-së.....	69
Fondet publike	70
Kontratat shtetërore për shërbime publike.....	72
Përkrahja jofinanciare.....	74
Donacionet private dhe filantropia	76
Ndikimi i perceptuar	78
Reagueshmëria	79
Ndikimi i perceptuar	81
Avokimi.....	83
Qasja në informata.....	85
Pjesëmarrja në politikëbërje.....	87
Ambienti i jashtëm	92
Konteksti socio-ekonomik	93
Konteksti socio-politik	94
Konteksti socio-kulturor	96

Lista e figurave

(Fig.1: OJQ-të në numra – Burimi: Regjistri i OJQ-ve dhe ATK)	16
(Fig.2: Shpërndarja gjeografike e OJQ-ve – Burimi: Regjistri i OJQ-ve).....	17
(Fig. 3: Trendi i regjistrimit të OJQ-ve sipas viteve – Burimi: Regjistri i OJQ-ve).....	18
(Fig.4: Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anketa me OShC dhe ATK)	19
(Fig.5: Numri i punëtorëve të OShC-ve të cilat kanë deklaruar se kanë të punësuar në vitin 2015 – Burimi: ATK).....	20
(Fig.6: Vlerësimi i procesit të regjistrimit të OJQ-ve – Burimi: Anketa me OShC (OShC-të e regjistruara gjatë viteve 2014-2015)).....	23
(Fig.7: Përvojat e OShC-ve në kufizimin e lirisë së shprehjes së tyre – Burimi: Anketa me OShC)	26
(Fig.8: Përvoja e OShC-ve në kufizime të kanaleve të tyre të komunikimit – Burimi: Anketa me OShC)	27
(Fig.9: Aktiviteti financiar i OShC-ve dhe pagesa e tatimeve – Burimi: Anketa me OShC)	28
(Fig.10: OShC-të me së paku një auditim të jashtëm financiar sipas qarkullimit vjetor të OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anketa me OShC).....	30
(Fig.11: OShC-të që kanë përfutur prej lehtësirave tatimore gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC).....	32
(Fig.12: Organet më të larta drejtuese të deklaruara nga shoqatat – Burimi: Anketa me OShC)	35
(Fig.13: Shpeshësia e takimeve të organeve më të larta drejtuese gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)	36
(Fig.14: Ekzistimi i dokumenteve të brendshme – Burimi: Anketa me OShC)	38
(Fig.15: Shpërndarja gjeografike e të punësuarve të OJQ-ve – Burimi: FKPK)	40
(Fig.16: Shpërndarja gjinore e të punësuarve në shoqërinë civile dhe në sektorë të tjerë në vitin 2015 – Burimi: FKPK).....	41
(Fig.17: Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në organizatë krahasuar me qarkullimin vjetor të OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anketa me OShC).....	42
(Fig.18: Vetëvlerësimi i kapaciteteve të brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC).....	43
(Fig.19: Vetëvlerësimi për përparësitë dhe dobësitë kryesore të kapaciteteve të brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC).....	44
(Fig.20: Vlerësimi i donatorëve të huaj lidhur me kapacitetet e brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketa me donatorë).....	45
(Fig.21: Vlerësimi i rrjeteve të OShC-ve për kapacitetet e tyre të brendshme – Burimi: Anketa me rrjete)	46
(Fig.22: Vlerësimi i OShC-ve për disponueshmërinë e organizatave/shërbimeve përkrahëse për OShC-të – Burimi: Anketa me OShC).....	48
(Fig.23: Vlerësimi i donatorëve të huaj për disponueshmërinë e organizatave.shërbimeve përkrahëse për OShC-të – Burimi: Anketa me donatorë)	48
(Fig.24: Vlerësimi i rrjeteve të OShC-ve për disponueshmërinë e organizatave/shërbimeve përkrahëse për OShC-të – Burimi: Anketa me rrjete)	49
(Fig.25: Rrjetëzimi i OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)	50
(Fig.26: Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete publike – Burimi: Pulsi publik i UNDP-së).....	53
(Fig.27: Angazhimi i qytetarëve në shoqërinë civile në vitet 2013 dhe 2016 – Burimi: Pulsi publik i UNDP-së).....	54
(Fig.28: Numri i vullnetarëve krahasuar me numrin e punëtorëve me paga në OShC-të e anketura, gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)	55
(Fig.29: Perceptimet e OShC-ve për trendët e vullnetarizmit në shoqërinë civile gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC).....	56
(Fig.30: Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anketa e OShC-ve dhe ATK)	59

(Fig.31: Trendi i të hyrave dhe shpenzimeve të OShC-ve në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 – Burimi: Anketa me OShC).....	60
(Fig.32: Burimet e financimit të sektorit të shoqërisë civile – Burimi: Anketa me OShC).....	61
(Fig.33: OShC-të sipas burimeve të financimit – Burimi: Anketa me OShC)	62
(Fig.34: Kohëzgjatja e planifikimit të punës së OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)	63
(Fig.35: Lloji i përkrahjes së dhënë OShC-ve nga donatorët e huaj gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me donatorë).....	64
(Fig.36: Lloji i procedurave të aplikimit për fondet e huaja gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me donatorë)	65
(Fig.37: Vlerësimi i donatorëve lidhur me procedurat e aplikimit për fonde të huaja gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me donatorë)	65
(Fig.38: Ftesa e OShC-ve nga donatorët e huaj për programimin e fondeve të tyre – Burimi: Anketa me donatorë).....	67
(Fig.39: Ndërhyrja e donatorëve në punën e OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)	68
(Fig.40: Sfidat kryesore në aplikimin/zbatimin e fondeve të BE-së – Burimi: Anketa me OShC).....	69
(Fig.41: Përvoja e OShC-ve me monitorimin dhe raportimin e fondeve publike gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC).....	71
(Fig.42: Vlerësimi i OShC-ve për fondet publike gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)	72
(Fig.43: Kontratat shtetërore të fituara nga OShC-të e anketuara gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)	73
(Fig.44: Llojet dhe sfidat e përkrahjes jofinanciare të OShC-ve gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)	75
(Fig.45: Vlerësimi i OShC-ve për ambientin për filantropi në Kosovë – Burimi: Anketa me OShC)..	77
(Fig.46: Perceptimi i OShC-ve për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore të qytetarëve – Burimi: Anketa e OShC-ve)	79
(Fig.47: Perceptimi i palëve të jashtme për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore për qytetarët – Burimi: Anketa e Perceptimeve të Jashtme)	80
(Fig.48: Perceptimi i OShC-ve për fushat kryesore të ndikimit të shoqërisë civile në përgjithësi – Burimi: Anketa me OShC).....	81
(Fig.49:Perceptimi i OShC-ve për fushat kryesore të ndikimit të organizatës së tyre – Burimi: Anketa me OShC)	82
(Fig.50: Perceptimi i palëve të jashtme për fushat kryesore të aktivitetit të shoqërisë civile – Burimi: Anketa e Perceptimeve të Jashtme).....	83
(Fig.51: Komunikimi i OShC-ve me institucionet publike përgjegjëse për bashkëpunim me shoqërinë civile – Burimi: Anketa me OShC).....	84
(Fig.52: Përfshirja e OShC-ve në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 – Burimi: Anketa me OShC).....	85
(Fig.53: Përvoja e OShC-ve në qasjen në informata publike gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC).....	86
(Fig.54: Vlerësimi i OShC-ve për publikimin e propozimeve të politikave dhe ligjeve gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC).....	88
(Fig.55: Ftesat ndaj OShC-ve për konsultime publike – Burimi: Anketa me OShC)	89
(Fig.56: Perceptimi i OShC-ve për ndikimin e shoqërisë civile në politikëbërje – Burimi: Anketa me OShC)	90
(Fig.57: Përvoja e OShC-ve me procedurat e përzgjedhjes në trupat e përbashkëta të themeluara nga institucionet publike – Burimi: Anketa me OShC).....	91
(Fig.58: Trendët e mendimeve të qytetarëve për drejtimin politik, proceset demokratike dhe gatishmërinë për protesta – Burimi: Pulsi publik i UNDP-së).....	96
(Fig.59: Niveli i besimit të qytetarëve në sektorë/institucione të ndryshme – Burimi: Anketa e RIINVESTIT).....	97
(Fig.60: Niveli i besimit ndërpersonal në mes të qytetarëve – Burimi: Pulsi publik i UNDP-së).....	98

Lista e shkurtesave

Anketa e rrjeteve – Anketa e rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile

Anketa me Donatorë – Anketimi me Partnerët Zhvillimor

Anketa me OShC - Anketa e organizatave

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

BCSDN – Rrjeti Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile

BE – Bashkimi Europian

BPV – Bruto Produkti Vendor

Departamenti për OJQ – Departamenti për OJQ në Ministrinë e Administratës Publike

EULEX – Misioni i Bashkimit Europian për Sundim të Ligjit në Kosovë

FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

GF – Grup i Fokusit

IKShC – Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile

KCSF – Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

LGBTI – Komuniteti i lezbikeve, gejve, biseksualve, trans dhe interseksualve

Ligji për OJQ – Ligji për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare

MSA – Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim

NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior

OJQ – Organizatë jo-qeveritare

OShC – Organizatë e Shoqërisë Civile

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

RTK – Radio Televizioni I Kosovës

TVSh – Taksa mbi Vlerën e Shtuar

UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Përmbledhje ekzekutive

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile (IKShC) është një studim i rregullt i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Ky studim vlerëson gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë në baza periodike, duke matur dimensionet kryesore të këtij sektori, siç janë: struktura e sektorit, korniza ligjore, qeverisja dhe kapacitetet e brendshme, angazhimi qytetar, financimi, ndikimi i perceptuar dhe ambienti i jashtëm për veprimtari të shoqërisë civile. Metodologjia e hulumtimit përfshin hulumtimin e literaturës dhe rishikimin e kornizës ligjore, anketa parësore, diskutime në grupe të fokusit dhe analizë të të dhënave.

Përkundër që ekzistojnë mbi 8,500 OJQ të regjistruara dhe disa të tjera që janë nisma të paregjistruara, numri i OShC-ve aktive në Kosovë llogaritet të jetë rreth 1,500. Më pak se 1,000 OShC kanë pasur ndonjë aktivitet financiar ose të punësuar gjatë vitit 2015. Shumica e sektorit përbëhet nga OShC të vogla, si në kuptim të fondeve ashtu edhe të stafit. Sektori dominohet nga OShC-të me qendër në Prishtinë apo qendrat tjera rajonale të Kosovës. Trendi i regjistrimit të OJQ-ve të reja ka qenë stabil përgjatë gjashtë viteve të fundit, me rreth 500 OJQ të reja që regjistrohen çdo vit.

Ligji bazë për OJQ në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, edhe pse legjislacioni dytësor që është në fuqi nga viti 2014 ka prodhuar ndërhyrje të drejtpërdrejta të shtetit në punët e brendshme të OJQ-ve. Liria e tubimit, sa i përket OShC-ve, në përgjithësi respektohet, edhe pse vetëm një pjesë e sektorit kanë organizuar ndonjë tubim a protestë gjatë vitit 2015. Nuk ka pasur ndonjë problem serioz me lirinë e shprehjes për aktivistë të shoqërisë civile, përkundër problemeve të kohëpaskohshme të presionit të raportuar për qëndrime kundërshtuese ose kritika ndaj autoriteteve shtetërore. Pjesë të ligjeve të tjera trajtojnë çështje relevante për OShC në fushat si raportimi financiar, trajtimi dhe përfitimet tatimore dhe fiskale, si dhe punësimi. Shumë prej tyre nuk i trajtojnë nevojat e veçanta të sektorit, ndërsa lehtësirat ekzistuese tatimore janë të paqarta ose nuk prodhojnë ndonjë efekt në praktikë, përfshirë ato për Organizatat me Status të Përfitimit Publik. Niveli i plotësimit të obligimeve tatimore nga OShC-të është shumë i lartë, ashtu siç është edhe numri i auditimeve të jashtme financiare i OShC-ve me të ardhura vjetore mbi 100,000 euro. Një numër i dispozitave shumë kufizuese për OJQ të legjislacionit kundër pastrimit të parave tashmë është larguar, përkundër që disa kufizime kanë mbetur ende.

Shumica e OShC-ve janë të regjistruara si shoqata, por jo të gjitha i respektojnë kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me organin e tyre më të lartë. Më pak se gjysma e OShC-ve konfirmojnë që kanë dokumente të qeverisjes së brendshme, ndërsa OShC-të më të mëdha kanë më shumë rregulla të brendshme. Rreth gjysma e OShC-ve kanë faqe të internetit ose të *Facebook-ut* në të cilat mund t'i publikojnë informatat relevante për punën e tyre. Përderisa shumica e OShC-ve kanë pak ose aspak staf, sektori i shoqërisë civile megjithatë përfaqëson një gjenerues të rëndësishëm të punësimit në Kosovë. Përkundër që vlerësojnë që stafi i tyre ka kapacitete solide, OShC-të ballafaqohen me sfida të mëdha kur u duhet të punësojnë staf të kualifikuar. Për dallim nga sektorët tjerë, përfaqësimi gjinor në stafin e punësuar në shoqëri civile është gati se i baraspeshuar ndërmjet burrave dhe grave. Financimi afat-shkurtër rezulton me kohëzgjatje të shkurtër të qëndrimit të stafit në organizatë. Rrjetëzimi dhe komunikimi brenda-sektoral brenda vendit është më i zhvilluar krahasuar me rrjetëzimin dhe komunikimin ndërkombëtar.

Anëtarësimi i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile mbetet i ulët dhe është pjesë e një apatie më të gjerë ndaj jetës qytetare në Kosovë. Me pak përjashtime, shumë OShC kanë shumë pak

anëtarë, përkundër që shumica prej tyre janë të regjistruara si shoqata. Përkrahje më e madhe vërehet për çështjet dhe kauzat e veçanta në të cilat është angazhuar shoqëria civile, ndërsa më shumë se gjysma e qytetarëve kanë besim në shoqërinë civile dhe besojnë që sektori është duke bërë punë të mirë. Trendet e ulëta të vullnetarizmit mbesin të pandryshuara dhe ndër arsyet kryesore për këtë është ambienti jo i favorshëm për vullnetarizëm. Megjithatë, shoqëria civile në përgjithësi ka më shumë vullnetarë sesa të punësuar.

Financimi për sektorin mbetet stabil. Dy të tretat e sektorit operojnë me më pak se 10,000 euro në vit, ku gjysma e këtij grupi nuk kanë fare fonde. Donatorët e huaj japin pjesën më të madhe të financimit të sektorit, edhe pse pjesa e OShC-ve që marrin fonde të huaja është zvogëluar. Për shkak të financimit afat-shkurtër, shumica e sektorit nuk është në gjendje të planifikojë mbi një vit. Nëpërmjet konsultimit nga organizatat donatore, disa OShC mund t'i ndikojnë prioritetet e financimit të donatorëve të huaj. Vetëm një pjesë e vogël e sektorit ka pasur sukses të ketë qasje në fondet e BE-së, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve për të aplikuar dhe zbatuar projektet e financuara nga BE. OShC-të e vogla, sidomos ato që veprojnë në nivel lokal, kryesisht janë të varura nga fondet publike, e të cilat nuk janë të rregulluara me ndonjë kriter ose procedurë. Pak OShC mund të marrin kontrata shtetërore për shërbime publike, ndërsa donacionet private janë të ulëta si në kuptim të shpeshtësisë ashtu edhe të shumave.

Shoqëria civile e Kosovës ka ndikim të kufizuar në çështjet që janë brenga kryesore të qytetarëve, siç janë zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit. Është interesant fakti që shoqëria civile duket të jetë më kritike ndaj vetes krahasuar me palët jashtë sektorit kur vlerësohet ndikimi i sektorit në këto fusha. Një ndikim më i madh perceptohet të jetë në fushën e demokratizimit. Përkundër ndikimit të perceptuar, fushat ku shoqëria civile shihet të jetë më aktive janë transparenca dhe llogaridhënia si dhe sundimi i ligjit. Shoqëria civile ka një komunikim të mirë me institucionet publike relevante për punën e saj, por kjo nuk përkthehet në qasje të mjaftueshme në informata dhe përfshirje në konsultimet publike për procesin e politikëbërjes. Përderisa OShC-të e mëdha janë më të ekspozuara ndaj procesit të politikëbërjes, ndikimi i sektorit në këtë proces mbetet i kufizuar.

Shoqëria civile në Kosovë vazhdon të veprojë në një ambient të jashtëm të pavaforshëm. Ekonomia e Kosovës mbetet e pazhvilluar dhe nuk krijon mjaftueshëm vende pune. Niveli i papunësisë mbetet i lartë ndërsa qytetarët e Kosovës janë ndër më të varfërit e rajonit. Kushtet e rënda socio-ekonomike kanë rezultuar në një valë të gjerë migrimi gjatë viteve 2014 dhe 2015. Perceptimet mbi nivelin e korrupsionit dhe sundimit të ligjit nuk janë aspak të kënaqshme. Përkundër përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, vendi mbetet nikoqire dhe subjekt i organizatave të huaja politike, gjyqësore dhe ushtarake. Progresi fillestar në njohjen ndërkom-bëtare të Kosovës së fundi është ndalur. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 dhe marrëveshjet e mëvonshme me Serbinë dhe Malin e Zi kanë shkaktuar një krizës të gjatë politike. Polarizimi i spektrit politik ka bllokuar punën e Kuvendit të Kosovës për një pjesë të madhe të dy viteve të fundit. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim me BE-në, Kosova ka shënuar marrëdhënien e parë kontraktuale me BE-në. Megjithatë, progresi në reformat për anëtarësim në BE mbetet i kufizuar. Partitë politike të varura nga liderët e të cilave u mungon transparenca nuk japin shumë shpresë për progres. Kënaqshmëria me drejtimin politik të vendit është në rënie, sikurse edhe besimi ndaj institucioneve kryesore në Kosovë. Përkundër kësaj, gatishmëria e qytetarëve për t'iu bashkuar protestave publike është në rënie, ndërsa niveli i besimit ndërpersonal mbetet i ulët.

Hyrje

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile (IKShC) është një studim i rregullt i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) që vlerëson gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë në baza periodike. Ky studim e vazhdon traditën e KCSF-së në ofrimin e informatave gjithëpërfshirëse mbi sektorin e shoqërisë civile në Kosovë, e filluar me Antologjinë e shoqërisë civile më 2001, Analizën e shoqërisë civile në Kosovë më 2005, Indeksën e Shoqërisë Civile për Kosovë të CIVICUS më 2011 dhe Indeksën Kosovar të Shoqërisë Civile më 2014. Ky studim ndërmirret çdo dy vite dhe i mat dimensionet kryesore të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.

Metodologjia e studimit bazohet në botimet e kaluara të Indeksit të Shoqërisë Civile më 2011 dhe 2014, por ka përshtatje të metodave hulumtuese për të adresuar krakteristikat e veçanta të shoqërisë civile në Kosovë. Metodologjia përfshin hulumtimin e literaturës dhe rishikimin e kornizës ligjore, anketa parësore, diskutime në grupe të fokusit dhe analizë të të dhënave. Përdërisa pjesa tjetër e metodologjisë është e ngjashme me atë të IKShC 2014, ndryshimi kryesor ka ndodhur në mostrën e Anketës me OShC, respektivisht kriteret për ta konsideruar një OShC si aktive. Mostra e IKShC 2014 kishte përfshirë të gjitha ato OShC të cilat kishin dëshmuar një lloj niveli të aktivitetit (pjesëmarrje në takime të ndryshme, përgjigje në e-maila, etj.) përgjatë tre viteve të fundit. Mostra e IKShC 2016 është zgjeruar të të gjitha ato OShC të cilat i janë përgjigjur pozitivisht ftesës për intervistë për anketë, dhe kjo është konsideruar si shenjë e ekzistencës së tyre. Ky ndryshim është bërë për të përmbushur sa më mirë me standardet ndërkombëtare për aktivitetin e shoqërisë civile, si dhe për të pasur një shtrirje gjithëpërfshirëse të studimit. Edhe pse minor, pasojat praktike të këtij ndryshimi janë përfshirja më e madhe në anketë e OShC-ve të vogla, e që si rrjedhojë ka pasur rezultate pak më të ndryshme në disa indikatorë të caktuar.

Anketat janë ndërmarrë në fund të vitit 2015 dhe fillim të vitit 2016, dhe kanë mbledhur informata për vitin kalendarik 2015. Megjithatë, studimi reflekton edhe zhvillime tjera relevante nga pjesa e parë e vitit 2016, si p.sh. ndryshimet në legjislacionin relevant për shoqëri civile. IKShC i mbulon shtatë fusha kryesore që e karakterizojnë punën e sektorit të shoqërisë civile: struktura e sektorit, korniza ligjore, qeverisja dhe kapacitetet e brendshme, angazhimi qytetar, financimi, ndikimi i perceptuar dhe ambienti i jashtëm për veprimtari të shoqërisë civile.

Duke paraqitur shpjegime të detajuara të një numri të madh të indikatorëve, ky raport u dedikohet për përdorim ekspertëve, hulumtuesëve dhe profesionistëve, si dhe vendim-marrësve në institucionet publike, organizatat donatore dhe OShC-të të cilat merren me sektorin e shoqërisë civile. Për të pasur një shtrirje më të gjerë të audiencat jashtë grupeve të përmendura më lart, rezultatet e IKShC 2016 janë paraqitur edhe në platforma shitesë, përfshirë vizualizimin e mbi 50 indikatorëve kryesorë dhe një serie të infografikave tematike të cilat do të lansohen gjatë vitit 2016 dhe 2017.¹

¹ Platforma e IKShC 2016 mund të qaset në www.kcsfoundation.org/index2016

Metodologjia

Metodologjia e hulumtimit e Indeksit Kosovar të Shoqërisë Civile 2016 (IKShC) është bazuar në një numër metodash që janë përdorur për komponentë të ndryshëm të raportit, duke përfshirë hulumtimin e literaturës dhe rishikimin e kornizës ligjore, grumbullimin e të dhënave primare përmes anketave dhe diskutimeve në grupe të fokusit, si dhe analizat statistikore të të dhënave relevante të grumbulluara nga institucionet e tjera.

Hapi i parë, ai i grumbullimit të të dhënave kryesore ka përfshirë një anketë me organizata (Anketa me OShC) me pjesëmarrje të 101 organizatave të shoqërisë civile (OShC) nga mbarë Kosova, e cila është bërë përmes intervistave sy me sy gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2015. Me qëllim të kontrollit të ndërthurtë të aspekteve të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë civile, siç janë: qeverisja e brendshme e organizatave, kapacitetet lidhur me aplikimin për fonde dhe për zbatimin e programeve e projekteve, burimet e financimit dhe të ngjashme, janë organizuar edhe dy anketa të tjera. Njëra anketë është bërë me 20 donatorët më të rëndësishëm për shoqërinë civile në Kosovë, ndërsa tjetra është realizuar me gjashtë rrjete të shoqërisë civile. Informatat për perceptimet e jashtme lidhur me rolin dhe ndikimin e shoqërisë civile janë mbledhur përmes anketës me 50 aktorë të jashtëm me interes apo hisedarë nga fusha të ndryshme relevante për sektorin e shoqërisë civile, duke përfshirë: institucionet e ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit; institucionet publike (ofruesit publikë të shërbimeve shëndetësore, shkollat fillore, institucionet publike të kulturës), ndërmarrjet publike, agjencitë e pavarura, komunitat, sektorin privat, mediet, botën akademike dhe partnerët ndërkombëtarë zhvillimorë. Të dhënat përkthimi me perceptimet e qytetarëve për shoqërinë civile, për praktikën e tyre të vullnetarizimit dhe për aktivizimin në sektorin civil janë marrë nga anketa e UNDP-së për Pulsin Publik 9,² e cila ka intervistuar një mostër përfaqësuese prej 1300 të rriturve nga tërë Kosova.

Rishikimi i kornizës ligjore është bazuar në nismën e Matricës së Monitorimit, që është një monitorim vjetor i ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile. Kjo nismë rajonale e anëtarëve të Rrjetit Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile (BCSDN) monitoron në baza vjetore një vistër të standardeve dhe indikatorëve, në legjisllacion dhe praktikë, të të gjitha elementeve që e përbëjnë ambientin për veprimtari të shoqërisë civile.³ KCSF e ndërmerr këtë monitorim që nga viti 2013, ndërsa për këtë studim janë përdorur një numër i konsiderueshëm i të gjeturave nga Raporti për Kosovë 2015. Zhvillimet tjera që kanë ndodhur në fillim të vitit 2016 kanë qenë pjesë e hulumtimit shtesë të literaturës dhe kornizës ligjore.

Pas hulumtimit të literaturës, rishikimit të kornizës ligjore dhe analizës paraprake të të dhënave të të gjitha anketave të lartpërmendura, janë identifikuar temat kryesore lidhur me zhvillimin e shoqërisë civile për t'u diskutuar në kuadër të tri grupeve të fokusit (GF). Njëri është bërë me organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet, tjetri me agjencitë donatore dhe diskutimi i tretë është organizuar me qytetarët e rëndomtë. Me qëllim të hulumtimit të hollësishëm të temave të përzgjedhura për diskutim, në grupin e parë të fokusit u zgjedhën OShC-të më të vogla, të cilat veprojnë në nivel lokal dhe që kanë pasur probleme me grumbullimin e fondeve gjatë

² Një anketë e realizuar dy herë gjatë vitit me një mostër përfaqësuese të 1,300 kosovarëve gjithandej vendit, e cila mbledh informata mbi mendimet dhe perceptimet e qytetarëve rreth punës së Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve tjera, si dhe rreth zhvillimeve të fundit politike, ekonomike dhe shoqërore.

³ Më shumë për Matricën e Monitorimit mund të gjindet në www.monitoringmatrix.net

dy viteve të fundit, si dhe organizatat përkrahëse vendore. Në GF të dytë janë ftuar agjencitë donatore të cilat kanë bashkëpunim të ngushtë me organizata e ndryshme të shoqërisë civile, ndërsa në GF të tretë janë ftuar qytetarë të moshave, gjinive, shkollimit dhe karrierave të ndryshme. Secili nga GF-të ka pasur rreth 10 pjesëmarrës. Në GF të parë, OShC-të e vogla janë përzgjedhur nga rajon të ndryshme të Kosovës, si urbane ashtu edhe rurale, ndërsa për t'i përzgjedhur ato që kanë qenë më pak të ekspozuara ndaj fondeve ose janë themeluar së voni, janë shfrytëzuar informata nga njësia e grantdhënies e KCSF-së. Si organizata përkrahëse janë përzgjedhur disa OShC vendore të cilat shpërndajnë grante për shoqërinë civile dhe ofrojnë mbështetje për ngritje të kapaciteteve të OShC-ve, e si rrjedhojë janë të ekspozuara në baza ditore ndaj nevojave të OShC-ve grantiste dhe përfituesëve të tyre. Duke i kombinuar përgjigjet nga të dyja grupet e organizatave është reflektuar ana e kërkesës dhe e ofertës për përkrahje për shoqërinë civile. Për GF me donatorë, janë ftuar donatorë me prezencë më afat-gjate në Kosovë dhe ata të cilët kryesisht ofrojnë përkrahje më afat-gjate, për shkak të përvojës dhe thellësisë së informatave ndaj OShC-ve të ndryshme. Për GF të tretë, janë ftuar qytetarë të ndryshëm për të diskutuar rreth perceptimeve mbi shoqërinë civile, kanaleve të informimit për sektorin, nismat qytetare dhe rolin e pritur të shoqërisë civile në trajtimin e brengave të tyre. Pjesëmarrësit e GF të fundit u përzgjedhën me kujdes për të pasur një përfaqësim të baraspeshuar gjinor, të moshës, profesional dhe gjeografik.

Në fund, me qëllim të thellimit të njohurive rreth ambientit ku veprojnë organizatat e shoqërisë civile në veri të Kosovës, në partneritet me OJQ-në Aktiv, kemi realizuar tri grupe të fokusit me OShC-të nga ky regjion i Kosovës. Këto tri grupe të fokusit kanë përfshirë pjesëmarrësit nga komuna e Zveçanit, Leposaviqit, Mitrovicës së veriut dhe nga ajo e Zubin Potokut.

Mostra e Anketës me OShC është përzgjedhur nga Regjistri i OJQ-ve i Departamentit për OJQ në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, e cila kishte gjithsej 8,112 organizata vendore dhe 457 të huaja dhe ndërkombëtare. Me qëllim të mbledhjes së informatave gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese për sektorin në aspektin e madhësisë, fushës së aktivitetit, viteve të punës në sektor dhe shpërndarjes gjeografike, është përdorur metodologjia e mostrimit të rëndomtë shtresor. Mostra e anketës është përzgjedhur në bazë të dy hapave:

1) Caktimit të targeteve për kategoritë e shtresave: 10 OShC të mëdha dhe të konsoliduara,⁴ 5 OShC ndërkombëtare, 5 OShC nga komuniteti serb dhe 5 OShC nga komunitetet e tjera etnike (joshqiptare dhe joserbe). Për të siguruar përfaqësim gjeografik të organizatave, pjesëmarrësit në anketë janë ndarë në rajone, dhe atë si në vijim: më së paku 15 OShC nga Prishtina dhe më së paku 10 OShC nga rajonet e tjera kryesore të Kosovës. Përveç kësaj, në çdo nënmostër rajonale, është mostruar së paku një OJQ nga komunat më të vogla apo nga viset rurale për të parë për ndonjë dallim me të cilin ballafaqohen në punën e tyre të përditshme. OShC-të nga komuniteti serb janë mostruar në komunat kryesisht të banuara me popullatë serbe: Mitrovicë të veriut, Zveçan, Leposaviq, Graçanicë dhe Shtërpçë;

2) Përzgjedhja e rëndomtë e OShC-ve nga secila shtresë apo kategori, bazuar në listën e OJQ-ve të regjistruara. Për shkak të nivelit të lartë të OShC-ve jo-aktive e që janë pjesë e Regjistrimit të OJQ-ve, metodologjia e njëjtë e mostrimit është përsëritur disa herë, derisa është plotësuar numri përfundimtar i planifikuar i anketës. Kjo është bërë duke i caktuar numra të rëndomtë

⁴ Për qëllim të mostrës, organizata të konsoliduara janë konsideruar ato OShC të cilat kanë një trend të qëndrueshëm të fondeve, të punësuar me orar të plotë, fusha specifike të veprimit dhe paraqitje të vazhdueshme publike në sferat brenda fushës së veprimit.

secilës OShC në secilën shtresë, duke i ranguar dhe duke përzgjedhur për ta intervistuar organizatën e radhës, në rastet kur organizata e përzgjedhur paraprakisht nuk është përgjigjur apo ka rezultuar të jetë jo-aktive.

Mostrimi i ngjashëm është përdorur edhe për Anketën e Perceptimeve të Jashtme, me të vetmin dallim në listën fillestare të mostrës. Për shkak që nuk ka ndonjë regjistër zyrtar të hisedarëve të jashtëm, ekipi hulumtues fillimisht ka përpiluar një listë të kategorive bashkë me numrat e përafërt të respondentëve për secilën shtresë. Një numër i hisedarëve të jashtëm janë propozuar për secilën shtresë, nga ekipi hulumtues dhe pjesa tjetër e stafit të KCSF-së. Këta individë janë përzgjedhur bazuar në tre kritere të veçanta: 1) ata të cilët janë më bashkëpunues me shoqërinë civile; 2) ata të cilët janë më aktivë dhe të zëshëm në fushat e tyre të veprimtarisë; 3) ata të cilët janë më së paku të ekspozuar ndaj shoqërisë civile. Të intervistuarit në anketë kanë qenë nga sektorë të ndryshëm, siç është Kuvendi i Kosovës dhe partitë politike (4), Qeveria e Kosovës (10), komunat (3), sektori privat (8), media (8), bota akademike (5), gjyqësori (2), agjencitë e pavarura (1), institucionet e tjera publike, siç janë shkollat, spitalet, etj. (4), ndërmarrjet publike (2) dhe partnerët zhvillimorë e organizatat ndërkombëtare (3).


Anketa e partnerëve zhvillimorë (Anketa me donatorë) është realizuar me të gjitha agjencitë donatore të huaja dhe ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, të cilat financojnë programe të shoqërisë civile, derisa në Anketën me rrjete janë përfshirë disa nga rrjetet më aktive në Kosovë si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

E gjithë Anketa me OShC është zbatuar nëpërmjet intervistave sy më sy në zyret e respondentëve, ndërsa secila intervistë ka zgjatur rreth 1.5 orë. Anketat tjera janë zbatuar nëpërmjet një platforme online të anketimit, SurveyMonkey. Megjithatë, disa respondentë të Anketës së Perceptimeve të Jashtme janë intervistuar sy më sy, për shkak të pamundësisë së tyre për të plotësuar anketën online.

Shumica e pyetjeve në secilën anketë kanë qenë pyetje të mbyllura, edhe pse në raste të veçanta janë përfshirë edhe pyetje të hapura, kryesisht në ato raste kur ka qenë e vështirë të kategorizohen përgjigjet paraprakisht. Anketa me OShC përmbante 141 pyetje që kanë mbuluar tema si: demografia e përgjithshme; struktura organizative; menaxhimi, menaxhimi financiar, llogaridhënia, transparenca dhe lehtësirat fiskale; burime njerëzore (përfshirë vullnetarët) dhe kapacitetet e brendshme; rrjetëzimi dhe komunikimi brenda-sektoral; liria e asociimit dhe korniza ligjore për veprimtarinë e shoqërisë civile; liritë tjera themelore; infrastruktura përkrahëse; trendet dhe burimet e financimit; fondet publike dhe kontratat shtetërore; përkrahje jo-financiare nga shteti; ofrimi i shërbimeve; aktiviteti ekonomik, filantropia, përfshirja e shoqërisë civile në programimin e fondeve të donatorëve të huaj; ndikimi i donatorëve në veprimtarinë e OShC-ve; avokimi, bashkëpunimi me institucionet publike, qasja në informata dhe konsultimi publik; perceptimi i ndikimit të shoqërisë civile; dhe ambienti i jashtëm për veprimtarinë e shoqërisë civile.

Anketa e Perceptimeve të Jashtme përmbante 14 pyetje që kanë mbuluar tema si: perceptimi i ndikimit të shoqërisë civile; aktiviteti i shoqërisë civile, besimi në shoqëri civile; financimi i shoqërisë civile; pjesëmarrja dhe ndikimi i shoqërisë civile në vendim-marrje; dhe ambienti i jashtëm për veprimtarinë e shoqërisë civile. Anketa me Donatorë përmbante 35 pyetje që kanë mbuluar tema si: programimi i fondeve të donatorëve për shoqëri civile dhe përfshirja e OShC-ve në programim; mekanizmat e përkrahjes për OShC dhe tipet e përkrahjes; kapacitetet e OShC-ve; efektiviteti i politikave zhvillimore për shoqëri civile; dhe ambienti i jashtëm për

veprimtarinë e shoqërisë civile. Anketa me rrjete përmbante 27 pyetje që kanë mbuluar tema si: anëtarësia dhe struktura e rrjeteve; mekanizmat e përkrahjes së rrjeteve për anëtarët e tyre; kapacitetet e anëtarëve; trendet e financimit të anëtarëve; përfshirja në programimin e fondeve të donatorëve të huaj; dhe bashkëpunimi me institucione publike.



Struktura e shoqërisë civile në Kosovë

Përkundër që ekzistojnë mbi 8,500 OJQ të regjistruara dhe disa të tjera që janë nisma të paregjistruara, numri i OShC-ve aktive në Kosovë llogaritet të jetë rreth 1,500. Më pak se 1,000 OShC kanë pasur ndonjë aktivitet financiar ose të punësuar gjatë vitit 2015. Shumica e sektorit përbëhet nga OShC të vogla, si në kuptim të fondeve ashtu edhe të stafit. Sektori dominohet nga OShC-të me qendër në Prishtinë apo qendrat tjera rajonale të Kosovës. Trendi i regjistrimit të OJQ-ve të reja ka qenë stabil përgjatë gjashtë viteve të fundit, me rreth 500 OJQ të reja që regjistrohen çdo vit.

Në mesin e pyetjeve më të vështira kur kemi të bëjmë me shoqërinë civile është ajo për numrin e OShC-ve që ekzistojnë në vend. Lidhur me këtë mund të përdoren kritere të ndryshme, ku secili prej tyre jep edhe rezultate të ndryshme. Së pari, shoqëria civile përbëhet jo vetëm nga OJQ-të e regjistruara, por edhe nga llojet e tjera të organizatave, duke përfshirë nismat e paregjistruara. Së dyti, edhe nëse fokusohemi në OJQ-të e regjistruara, është vështirë të vlerësohet nëse OJQ-ja është aktive. Në standardet ndërkombëtare nuk parashihet se për të qenë një OJQ aktive duhet të ketë aktivitete të përditshme. Sipas Udhëzimeve të Komisionit të Venedikut për lirinë e asociimit “pasiviteti i stërzgatur (si njëra prej disa arsyeve që rezultojnë me shpërbërjen e shoqatës) ka pak gjasa të aplikohet pa kaluar, fjala bie, disa vite nga mbledhja e fundit e shoqatës dhe pas mosparaqitjes për disa vite radhazi së raporteve vjetore që mund të kërkohen.”⁵ Mungesa e të dhënave sistematike dhe të besueshme për sektorin e shoqërisë civile në Kosovë pamundëson çfarëdo llogaritje të saktë të numrit të OShC-ve.

Të dhënat nga Regjistri Publik i OJQ-ve i Departamentit të OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike⁶ tregojnë se aktualisht të regjistruara në Kosovë janë gjithsej 8,112 organizata vendore dhe 456 organizata të huaja dhe ndërkombëtare. Nga këto, 455 janë klube sportive ose federata të sportit, ndërsa 7 prej tyre janë organizata fetare. Duke marrë parasysh një numër të nismave të paregjistruara dhe lloje të tjera të OShC-ve, numri i OShC-ve është paksa më i lartë se sa numri i OJQ-ve të regjistruara.


Jo të gjitha nga këto 8,500 OJQ të regjistruara janë aktive, ndërsa shumë prej tyre fare nuk ekzistojnë. Pasi çregjistrimi i një OJQ-je nuk është i obliguar, shumë prej OJQ-ve që janë pjesë e Regjistrimit Publik të OJQ-ve kanë ndërprerë aktivitetin pa e çregjistruar formalisht organizatën e tyre. Të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) na japin një orientim më të saktë për madhësinë e sektorit, edhe pse as këto shifra nuk duhet të interpretohen si përfundimtare.

Në mungesë të një sistemi gjithëpërfshirës të mbledhjes së të dhënave për OJQ, nga ATK janë marrë kategori të ndryshme të të dhënave. Nga viti 2009, kur edhe ka filluar të aplikohet numri fiskal në Kosovë, e deri në fund të vitit 2015, 2,230 OJQ kanë marrë numrin fiskal që është parakusht për administrimin e çfarëdo lloji tatimi në Kosovë. Gjithashtu, 748 OJQ kanë dorëzuar në ATK deklaratat e kërkuara vjetore për vitin 2015,⁷ 864 OJQ kanë paguar tatim apo kanë deklaruar ndonjë transaksion financiar, derisa 927 OJQ kanë deklaruar se kanë pasur të punësuar gjatë vitit.

5 “Udhëzimet e Komisionit të Venedikut për lirinë e asociimit.” 17 dhjetor 2014. Qasur më 22 gusht 2016. [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2014\)046-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2014)046-e).

6 Regjistri Publik i OJQ-ve i përdorur për këtë studim është i muajit prill 2016.

7 Emri i plotë i deklaratës vjetore është CD - Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave



(Fig.1: OJQ-të në numra – Burimi: Regjistri i OJQ-ve dhe ATK)

Nëse merren parasysh aktivitetet financiare, siç janë pasja e punëtorëve, pagesa e tatimeve apo deklarimi i transaksioneve, numri i OShC-ve aktive në Kosovë nuk kalon përtej numrit 1,000. Megjithatë, siç edhe dëshmon Anketa me OShC, rreth një e treta e OShC-ve veprojnë plotësisht nëpërmjet vullnetarëve, pa ndonjë të punësuar ose transaksione financiare. Edhe pse të pakta në numër, pjesë e shoqërisë civile janë edhe disa nisma të paregjistruara. Përkundër që nuk mund të jetë plotësisht i saktë, duke i shtuar këtij numri disa qindra OShC që veprojnë në baza vullnetare dhe nismat e paregjistruara, numri i OShC-ve aktive në Kosovë mund të jetë diku rreth 1,500.


Duke pasur vetëm dy forma ligjore të regjistrimit të OJQ-ve, shumica dërrmuese e OJQ-ve vendore (96.2%) janë të regjistruara si shoqata, ndërsa pjesa e mbetur prej 3.8% janë të regjistruara si fondacione. Në mesin e fondacioneve të regjistruara është vetëm një që është regjistruar në bazë të kapitalit fillestar.⁸

Edhe pse Regjistri Publik i OJQ-ve nuk përditësohet rregullisht dhe kryesisht përmban informata të dhëna gjatë procesit të regjistrimit,⁹ prapëseprapë nga kjo listë mund të nxjerrën disa karakteristika.

Zonat urbane kanë përqendrimin më të madh të OShC-ve. Siç paraqitet në grafikonin e mëposhtëm, pothuajse tri të katërtat e OJQ-ve të regjistruara gjenden në qendrat më të mëdha rajonale të Kosovës (70.3%). Prej tyre, më shumë se gjysma e tyre gjenden në Prishtinë (36.7% e të gjitha OJQ-ve të regjistruara).

⁸ Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës. Raport për vlerësimin juridik dhe zbatimin e Ligjit të Kosovës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Raport. 2015.10

⁹ Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës. Raport për vlerësimin juridik dhe zbatimin e Ligjit të Kosovës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Raport. 2015.19



(Fig.2: Shpërndarja gjeografike e OJQ-ve – Burimi: Regjistri i OJQ-ve)

Edhe pse OJQ-ve, me rastin e regjistrimit, u kërkohet të deklarohet fusha e veprimtarisë, Regjistri Publik i OJQ-ve megjithatë nuk është burim i besueshëm i informatave lidhur me këtë karakteristikë. Në bazë të këtij regjistri, fushat kryesore të veprimtarisë (kultura, arsimit, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi shoqëror dhe shëndetësia) ose ato që më së paku deklarohen (personat me aftësi të kufizuara, hulumtime dhe analiza) jo domosdoshmërisht përputhen me gjendjen reale të sektorit. Në këtë pjesë të regjistrit të OJQ-ve paraqiten tri karakteristika të rëndësishme:

1) Fushat e deklaruara të veprimtarisë të shumë OJQ-ve nuk përputhen me fushat e vërteta të veprimtarisë së tyre të përditshme. Kjo është e zakonshme për shumë OShC dhe më së shumti vjen në pah me rastin e aplikimit për fonde. Shumë agjenci donatorësh dhe organizata grantdhënëse kanë përmendur raste kur OShC-të aplikojnë për projekte në fusha të caktuara që nuk janë pjesë e


misionit të tyre apo e fushës zyrtare të veprimtarisë. Një tendencë e njëjtë është vërtetuar edhe në GF me OShC-të serbe në pjesën veriore të Kosovës.

2) Fushat e deklaruara në momentin e regjistrimit kanë prirje të jenë sa më të përgjithësuara në mënyrë që të lejohet fleksibiliteti i punës. Kjo tregohet nga fakti se pjesa më e madhe e OShC-ve të kategorizuara si “të tjera” në Regjistrin Publik të OJQ-ve hyjnë në kategorinë dykuptimëshe “shoqëria për shoqëri”. OJQ-të vendosen në këtë kategori kur misioni dhe fusha e veprimtarisë së tyre janë tepër të përgjithëshme për t’u futur brenda ndonjë kategorie të veçantë.

3) Grumbullimi i informatave nga ana e Departamentit të OJQ-ve nuk është sistematik dhe nuk ofron të dhëna të besueshme për strukturën e vërtetë të sektorit. Kjo vërehet jo vetëm duke e krahasuar Regjistrin Publik të OJQ-ve me informatat publike të shumë OShC-ve aktive në Kosovë, por edhe nga ata që drejtpërdrejtë punojnë me sektorin e shoqërisë civile. Për ta ilustruar këtë, derisa në Regjistrin Publik të OJQ-ve gjenden vetëm dy OJQ të cilat kanë deklaruar të drejtat e pakicave si fushë kryesore të veprimtarisë, në një skemë të granteve të menaxhuar nga KCSF-ja brenda një periudhe të shkurtër janë pranuar aplikacione nga 7 OJQ, të cilat deklarojnë këtë fushë si kryesoren të veprimtarisë së tyre. Shembuj të ngjashëm mund të gjenden në fushën e integritimit evropian, të transparencës, pjesëmarrjes së qytetarëve, etj.

Trendi i regjistrimit të OJQ-ve të reja është relativisht konstant, veçanërisht gjatë disa viteve të fundit. Në vitin 1999 janë regjistruar 46 OJQ, ndërsa në vitin 2001 ku numër kërceu në 621. Përderisa numri i regjistrimeve ka pasur lëvizje mes viteve 2001 dhe 2010, trendi i regjistrimeve është “stabilizuar” me një mesatare prej 500 OJQ-ve të reja të regjistruara në vit nga viti 2009 deri në vitin 2015.


Nga ana tjetër, deri në qershor të vitit 2015, vetëm 102 OJQ vullnetarisht kanë vendosur të çregjistrohen.¹⁰



(Fig. 3: Trendi i regjistrimit të OJQ-ve sipas viteve – Burimi: Regjistri i OJQ-ve)

10 Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës. Raport për vlerësimin juridik dhe zbatimin e Ligjit të Kosovës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Raport. 2015.31

Analiza e të dhënave financiare të mbledhura nga Anketa me OShC dhe nga ATK tregon që një numër i madh i OShC-ve operojnë pa fonde ose me shuma shumë të ulëta të fondeve. Rreth 60% e OShC-ve kanë më pak se 10,000 euro të ardhura vjetore, ku pothuajse një e treta e sektorit nuk ka pasur fare të ardhura gjatë vitit 2015. Grupi i dytë më i madh i OShC-ve (rreth 10%-15% të tyre) gjatë vitit 2015 kishin të ardhura vjetore mes 100,000 dhe 500,000 euro. Vetëm një pjesë shumë e vogël e sektorit (rreth 4%) kanë raportuar të ardhura vjetore për vitin 2015 që e kalojnë shifrën prej 500,000 eurosh. Vlen të theksohet që për Anketën me OShC 10.9% të OShC-ve të anketuara kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje, dhe si rrjedhojë nuk janë përfshirë në këto llogaritje.




(Fig.4: Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anketa me OShC dhe ATK)

Për shumë vite me radhë, sektori i shoqërisë civile nuk ka qenë i përfshirë në të dhënat e prodhuara nga institucionet e ndryshme të shtetit, posaçërisht ato të dhënat të ndërlidhura me vlerën ekonomike të sektorit. Së fundi, KCSF ka bashkëpunuar me Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe ATK-në për të nxjerrë të dhëna të cilat japin disa detaje mbi vlerën ekonomike të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. Megjithatë, varësisht nga burimi i të dhënave, të dhënat për treguesit e njëjtë kanë ndryshime. Rrjedhimisht, këto të dhëna mundësojnë vetëm një vlerësim të përafërt të gjendjes reale lidhur me sektorin e shoqërisë civile.

Sipas FKPK, gjithsej numri i kontribuesve individualë në sektorin e OJQ-ve gjatë vitit 2015 ka qenë 10,466. Nga ky numër, 4,142 përpos në OJQ kanë punuar edhe në sektorë të tjerë, ndërsa 3,329 individë kanë punuar vetëm në OJQ gjatë 12 muajve të vitit 2015. Pasi që brenda numrit të kontribuesve individualë mund të hyjnë të njëjtit individë disa herë, kur këta kanë pranuar pagesa nga OJQ të ndryshme, kjo shifër mund të tejkalojë numrin e vërtetë të individëve që punojnë në sektorin e OJQ-ve. Të dhënat e ATK-së janë më të drejtpërdrejta për numrin e atyre që kanë punuar në sektorin e shoqërisë civile dhe tregojnë se OJQ-të punëdhënëse gjatë vitit 2015 kanë deklaruar 6,412 të punësuar.

Përderisa ka OShC që kanë të punësuar, shumë të tjera punojnë vetëm me vullnetarë, pa asnjë të punësuar me pagë. Nga ato OJQ që kanë të punësuar me pagë, pjesa më e madhe e tyre nuk kanë më shumë se 4 të punësuar.



(Fig.5: Numri i punëtorëve të OShC-ve të cilat kanë deklaruar se kanë të punësuar në vitin 2015 – Burimi: ATK)



Korniza ligjore

Ligji bazë për OJQ në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, edhe pse legjislacioni dytësor që është në fuqi nga viti 2014 ka prodhuar ndërhyrje të drejtpërdrejta të shtetit në punët e brendshme të OJQ-ve. Liria e tubimit, sa i përket OShC-ve, në përgjithësi respektohet, edhe pse vetëm një pjesë e sektorit kanë organizuar ndonjë tubim a protestë gjatë vitit 2015. Nuk ka pasur ndonjë problem serioz me lirinë e shprehjes për aktivistë të shoqërisë civile, përkundër problemeve të kohëpaskohshme të presionit të raportuar për qëndrime kundërshtuese ose kritika ndaj autoriteteve shtetërore. Pjesë të ligjeve të tjera trajtojnë çështje relevante për OShC në fushat si raportimi financiar, trajtimi dhe përfitimet tatimore dhe fiskale, si dhe punësimi. Shumë prej tyre nuk i trajtojnë nevojat e veçanta të sektorit, ndërsa lehtësirat ekzistuese tatimore janë të paqarta ose nuk prodhojnë ndonjë efekt në praktikë, përfshirë ato për Organizatat me Status të Përfitimit Publik. Niveli i plotësimit të obligimeve tatimore nga OShC-të është shumë i lartë, ashtu siç është edhe numri i auditimeve të jashtme financiare i OShC-ve me të ardhura vjetore mbi 100,000 euro. Një numër i dispozitave shumë kufizuese për OJQ të legjislacionit kundër pastrimit të parave tashmë është larguar, përkundër që disa kufizime kanë mbetur ende.


Liria e asocimit

Liria e asociimit është e drejtë kushtetuese, e garantuar përmes nenit 44 të Kushtetutës së Kosovës dhe e përcaktuar në Ligjin 04/L-57 për Lirinë e Asocimit në OJQ. Në kornizën ligjore parashihet se çdo person mund të ushtrojë lirinë e asocimit pa pasur nevojë të regjistrojë organizatën. Megjithatë, pjesa më e madhe e organizatave regjistrohen për të fituar statusin e subjektit juridik dhe përfitimet përcjellëse formale që vinë nga të qenit subjekt juridik (siç është mundësia për hapjen e llogarisë bankare apo e pranimit të fondeve nga donatorët).

Aktualisht OJQ-të mund të regjistrohen në dy forma: shoqatat (të bazuara në anëtarësi) dhe fondacionet (të bazuara në kapital).¹¹ Shoqatat mund të themelohen nga së paku tre persona fizikë apo juridikë, ndërsa fondacionet mund të themelohen nga një person apo përmes testamentit. Themelimi i fondacionit nuk është i kushtëzuar me ndonjë kapital fillestar apo mjete minimale financiare. Rregullat e regjistrimit në përgjithësi janë të thjeshta dhe regjistrimi është falas, ndërsa Departamenti për OJQ duhet përgjigjet në kërkesën për regjistrim brenda 60 ditëve.

Nga 101 OShC-të e anketuara, 18 OShC-të e regjistruara mes 1 janarit 2014 dhe fundit të dhjetorit 2015 janë pyetur për përvojat dhe perceptimet e tyre gjatë procesit të regjistrimit.

Përfaqësuesit e të gjitha këtyre organizatave kanë deklaruar se vendimi për t'u regjistruar ishte vullnetar; gjysma e tyre kanë deklaruar se procedura e regjistrimit ka qenë e lehtë, ndërsa afro gjysma tjetër kanë thënë se procedurat e regjistrimit kanë qenë të rënda dhe se e njëjta ka zgjatur shumë më tepër se sa parashihet me ligj (60 ditë) dhe se procedura nuk ka qenë e shtrenjtë. Vetëm një OShC e intervistuar deklaroi se vendimi nga Departamenti për OJQ gjatë procesit të regjistrimit ishte ndikuar politikisht.



(Fig.6: Vlerësimi i procesit të regjistrimit të OJQ-ve – Burimi: Anketa me OShC (OSHC-të e regjistruara gjatë viteve 2014-2015))

¹¹ Format e tjera të ushtrimit të lirisë së asociimit janë të rregulluara përmes ligjeve përkatëse, siç është ai për sindikatat, partitë politike, organizimet sindikale, komunitetet fetare, etj.

Në praktikë, procedura e regjistrimit në Kosovë kryesisht zbatohet pa ndonjë vështirësi dhe brenda afatit të paraparë. Megjithatë, në një studim të kohëve të fundit të bërë nga KCSF-ja, ka pasur raporte se disa OJQ ballafaqohen me vështirësi të caktuara gjatë këtij procesi që kryesisht kanë të bëjnë me përmbajtjen e statutit. Departamenti i OJQ-ve ofron një shabllon të statutit për të gjithë të interesuarit vetëm si udhëzim për ata që nuk kanë kapacitete për hartimin e statutit të personalizuar për OJQ-të e tyre. Sipas Departamentit për OJQ, nga organizatat nuk kërkohet që të përdorin shabllonin, por mjafton që statuti i tyre të jetë në përputhje me ligjin.¹² Ky studim tregon se shumica e kërkesave shtesë të bëra nga Departamenti për OJQ nuk kanë ndonjë bazë ligjore, por më shumë bazohen në kuptimet e ndryshme të shabllonit të statutit. OJQ-të respektive theksojnë që në vend se të argumentojnë me Departamentin për OJQ rreth dispozitave të kontestuara të statutit, për shkak të kohës më të shkurtër kanë preferuar të kompletojnë procesin e regjistrimit duke i larguar ose përshtatur dispozitat “problematike”, ashtu siç është kërkuar nga Departamenti për OJQ.¹³ Po ashtu, pavarësisht kërkesave ligjore ku parashihet që 3 persona mund të themelojnë një shoqatë, një listë shtesë prej së paku 5 anëtarëve të tjerë që kërkohet nga Departamenti i OJQ-ve praktikisht e rritë këtë numër në 8 anëtarë.¹⁴

GF në pjesën veriore të Kosovës tregojnë se OShC-të serbe në përgjithësi raportojnë për përvoja të mira me procesin e regjistrimit. OShC-të deklarojnë se procesi ka qenë i rregullt, se kohëzgjatja e tij ka qenë në përputhje me legjislacionin ekzistues dhe se zyrtari që merrej me procesin e regjistrimit ka qenë shumë i gatshëm për të ndihmuar. Pjesa më e madhe e korrespondencës është kryer përmes e-mail-it, gjë që ka lehtësuar shumë procesin, duke marrë parasysh largësinë prej Mitrovicës në Prishtinë.

Vetëm 5% e OShC-ve të anketuara deklaruan se gjatë vitit 2015 janë ballafaquar me kufizime të lirisë së asociimit jashtë internetit (shoqata, fondacione, nismat qytetare) dhe/ose në internet (forumet në internet, Skype, Facebook, etj.). Nga këto organizata, njëra ka deklaruar se është ballafaquar me *refuzimin/kufizimin diskriminues të lirisë së asociimit jashtë internetit (p.sh.. në baza gjinore, racore apo fetare)*; njëra ishte ballafaquar me *monitorim të Skype-it, Facebook-ut dhe grupeve të tjera të rrjeteve sociale*; dy janë përballur me *refuzim/kufizim diskriminues të aplikacioneve të internetit, me mbyllje të forumeve, grupeve të Facebook-ut, etj.*; ndërsa katër të tjera janë ballafaquar me *ngacim të stafit, anëtarëve, vullnetarëve dhe personave të tjerë të angazhuar në organizatë*. Pesë për qind të OShC-ve të anketuara gjithashtu deklaruan se gjatë vitit 2015 kanë pasur presione nga shteti apo ndërhyrje të paligjshme në çështjet e brendshme të organizatës. Lloji më i shpeshtë i raportuar nga OShC-të ka qenë *sulm jolegjitim ndaj organizatës* (i raportuar nga tri OShC), *ndërhyrje në objekte të organizatës/inspektim* (i raportuar nga një OShC), *kufizim të paarsyeshëm të aktivitetit të organizatës* (i raportuar nga një OShC) dhe *kontroll të tepërt të rregullave të brendshme të organizatës* (i raportuar nga një OShC). Gjithashtu, gjatë vitit 2015, një nga organizatat raportoi se është përballur me *politizim dhe tendencë për themelimin e strukturave paralele brenda organizatës*.

Derisa ajo që u cek më lart bazohet në perceptime të të qenurit subjekt i ndërhyrjeve, gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport ka pasur raste të faktuara të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të shtetit drejt

12 Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës. Raport për vlerësimin juridik dhe zbatimin e Ligjit të Kosovës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Raport. 2015. 17

13 Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës. Raport për vlerësimin juridik dhe zbatimin e Ligjit të Kosovës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Raport. 2015. 17

14 Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016. 14.

OJQ-ve, si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë praktik. Në nenin 18 të Udhëzimit Administrativ GRK – Nr: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve parashihet që Departamenti i OJQ-ve mund të pezullojë punën e OJQ-së, pas një kërkesë me shkrim dhe arsytimit të institucionit të autorizuar të sigurisë. Kohëzgjatja maksimale e pezullimit është një vit, ndërsa arsyetimi mund të bazohet në rastet kur aktivitetet e OJQ-së pretendohet të mos jenë në përputhje me rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës dhe të drejtës ndërkombëtare. Duke futur kategorinë e pezullimit dhe duke ia mundësuar organit administrativ të pezullojë punën e OJQ-së, ky nen nuk është në përputhje me legjislacionin primar. Përkundër kërkesave të shoqërisë civile për heqjen e këtij neni, i njëjti ende mbetet në fuqi, duke lejuar kështu ndërhyrjen e pajustificuar të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e brendshme të OShC-ve.¹⁵ Në bazë të kësaj dispozite, ka pasur raste të ndërhyrjes së shtetit si në vitin 2014, ashtu edhe në 2015-tën. Në shtator të vitit 2014 janë pezulluar 14 OJQ për një periudhë njëvjeçare,¹⁶ ndërsa në tetor të vitit 2015 janë pezulluar 13 OJQ.¹⁷ Nga Anketa me OShC, 5.1% e OShC-ve të anketuara kanë raportuar se gjatë vitit 2015 kanë pasur ndërhyrje nga shteti në punët e tyre të brendshme.

Përveç kësaj, gjithashtu janë raportuar edhe raste të ndërhyrjes nga palët e treta. Kështu, në shtator të vitit 2015 një bankë komerciale ka pezulluar llogaritë bankare të disa OJQ-ve pa njoftim paraprak dhe pa ndonjë bazë ligjore, derisa institucionet përgjegjëse të shtetit nuk kanë mundur të mbrojnë këto OJQ nga kjo ndërhyrje.¹⁸

Liritë e tjera

Liria e tubimit është e drejtë kushtetuese në bazë të nenit 43 të Kushtetutës, ndërsa në Ligjin 03/L-118 për tubimet publike të gjithë qytetarëve të Kosovës u garantohet e drejta që të organizojnë tubime publike dhe që të marrin pjesë në to. Në kornizën ligjore kërkohet njoftimi paraprak për tubimin publik, përveç në ato vende ku nuk kërkohen masa shtesë të sigurisë. Në rastet kur autoritetet nuk përgjigjen brenda kohës së paraparë (48 orë para tubimit publik), i njëjti mund të organizohet pa kufizime. Për çfarëdo kufizimi pas njoftimit për tubimin publik, organizatorët mund të ankohen në gjykatë përmes procedurës së përsheptuar. OShC-të kanë të njëjtat të drejta dhe obligime, të cilat vlejnë për të gjithë qytetarët dhe subjektet juridike.

Anketa tregon se OShC-të kanë qenë aq aktive në organizimin e tubimeve, ndërsa kur ato janë organizuar, nuk është shënuar ndonjë problem i madh. Njëzet e dy për qind të OShC-ve të anketuara kanë raportuar se gjatë vitit 2015 kanë organizuar ndonjë tubim (protestë, marsh apo performancë në mjedis të hapur). Pjesa më e madhe (86%) nuk kanë pasur ndonjë kufizim, ndërsa 18% kanë organizuar tubim në mënyrë spontane pa njoftuar autoritetet shtetërore. Vetëm një organizatë deklaroi se kishte marrë pjesë në një kundërtubim (tubim të grupeve kundërshtarë në

¹⁵ Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.. 15

¹⁶ Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016..14

¹⁷ Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.. 16


¹⁸ Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.16

të njëjtin vend dhe të njëjtën kohë) dhe organizata u pajtua me deklaratën se *kundërtubimi është mbrojtur nga policia*.

Vetëm njëra nga OShC-të e anketuara që ka organizuar tubime ka pasur sanksione të pajustificueshme, me ç'rast organizatorët e tubimit janë arrestuar. Disa nga rastet e pakta ku është raportuar për ndërhyrje nga policia gjatë vitit 2015 janë protestat e studentëve kundër rektorit të Universitetit të Prishtinës dhe protesta e Shoqatës së Veteranëve të Luftës në qytetin jugor të Kaçanikut.¹⁹ Nga ana tjetër, për dallim nga tubimet e organizuara nga aktivistët e shoqërisë civile dhe OShC-të, shumica e tubimeve të organizuara nga partitë politike gjatë viteve të fundit janë përcjellë me dhunë si të forcave policore, ashtu edhe të protestuesve, ku në mesin e të sulmuarve ka pasur edhe gazetarë.

Dyzet e shtatë për qind e të anketuarve deklaruan se gjatë vitit 2015 kanë marrë pjesë në ndonjë tubim – individualisht apo përmes organizatës së tyre. Më shumë se gjysma e këtyre të intervistuarve deklaruan se *nuk ka pasur kufizime të tepërta të kohës dhe vendit të tubimit (63%)*; *policia nuk kishte përdorur forcën ndaj pjesëmarrësve (61%)* dhe *se nuk ka pasur kufizime në pjesëmarrjen e medieve në tubim (63%)*. Trembëdhjetë për qind e të anketuarve nuk u pajtuan me asnjërën prej deklaratave të renditura më lartë.


Në bazë të nenit 40 të Kushtetutës, liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë, dhe mund të kufizohet vetëm nëse është e nevojshme për parandalimin e dhunës apo të urrejtjes racore, etnike a fetare. Anketa me OShC tregon se shoqëria civile në Kosovë në përgjithësi gëzon liri të shprehjes. Pjesa dërrmuese e OShC-ve deklaruan se nuk kanë pasur kufizime të paligjshme, siç është përndjekja për kritika ndaj autoriteteve shtetërore (91%) ose bllokim të qasjes në mjetet apo kanalet e komunikimit në internet (94%). Presioni si rezultat i kritikave ndaj autoriteteve shtetërore dhe kërcënime për shkak se anëtarët e organizatës kishin mendime të kundërta duken të jenë më problematike. Katëmbëdhjetë për qind e OShC-ve të intervistuar deklaruan se nganjëherë kishin pasur presione të paligjshme si rezultat i kritikës ndaj autoriteteve shtetërore, ndërsa 3% deklaruan se rregullisht janë përballur me presione për shkak të kritikave ndaj autoriteteve shtetërore apo me kërcënime për shkak të mendimit të kundërt.



(Fig.7: Përvojat e OShC-ve në kufizimin e lirisë së shprehjes së tyre – Burimi: Anketa me OShC)

¹⁹ Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.21

Të dhënat tregojnë se problemet me lirinë e shprehjes lidhur me dhënien dhe pranimin e lirshëm të informatave janë edhe më të pakta; vetëm 2% e OShC-ve kanë raportuar se nganjëherë kanë probleme me bllokim të faqeve së internetit, mjeteve/kanaleve dhe platformave të tjera të komunikimit në internet; 3% deklaruan se autoritetet shtetërore nganjëherë monitorojnë ilegalisht komunikimin e tyre dhe 1% thanë se nganjëherë janë dënuar për shkak të pjesëmarrjes në ndonjë grupe të caktuar të rrjeteve sociale.



(Fig.8: Përvoja e OShC-ve në kufizime të kanaleve të tyre të komunikimit – Burimi: Anketa me OShC)

Raportimi financiar

Nga OJQ-të kosovare kërkohet që të përmbushin obligimet e raportimit financiar njëjtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Këtu përfshihet edhe raportimi vjetor për ATK-në dhe raportimi për pagesën e tatimeve përkatëse, siç është tatimi në paga për të punësuarit e tyre (nëse një organizatë ka të punësuar), tatimi në të ardhurat e korporatave (nëse organizata bie në kategorinë e obligimit për të paguar këtë tatim), tatimi në pronë ose në qira (nëse një organizatë posedon pronë ose jep me qera ndonjë pronë). Gjithashtu, OJQ-të duhet të paguajnë pjesën e tyre të kontributit pensional për secilin të punësuar të tyre. Kushtet e përgjithshme për OJQ-të janë identike me ato për bizneset e tjera dhe specifikat e sektorit pothuajse fare nuk merren parasysh në kornizën ligjore.

I vetmi obligim specifik lidhur me raportimin e OJQ-ve është raportimi vjetor i organizatave me status për përfitim publik. Ky grup i OJQ-ve²⁰ është i obliguar të dorëzojë raportin narrativ dhe atë financiar në Departamentin e OJQ-ve, e që është edhe kusht për ruajtjen e këtij statusi. Nëse qarkullimi vjetor i organizatave me status për përfitim publik është më i lartë se 100,000 EUR, raportit financiar gjithashtu duhet t'i bashkëngjitet edhe raporti i auditimit të jashtëm.


Përderisa pjesa më e madhe e kushteve për raportim janë të ndërlidhura me ekzistimin e aktiviteteve të caktuara (pra, nëse OJQ-ja nuk ka të punësuar, nuk paguhet tatimi në të ardhura personale),

20 Në vitin 2015, 247 OJQ kishin Statusin për Përfitim Publik aktiv

raporti vjetor për ATK-në është kusht për të gjitha OJQ-të e regjistruara. Për vitin 2015, vetëm 748 OJQ kanë dorëzuar këtë raport.²¹

Nga OShC-të e anketuara, 55% e tyre kanë deklaruar se paguajnë tatim në paga, 49% paguajnë kontribute pensionale për të punësuarit e tyre, 34% paguajnë tatim në qira/pronë dhe 29% paguajnë Taksë mbi Vlerën e Shtuar (TVSh). Nga ato OJQ që nuk paguajnë asnjërin nga tatimet e cekura më lartë, shumica hyn në kategorinë e atyre OJQ-ve që nuk kanë ndonjë aktivitet që ka të bëjë me obligimet tatimore, siç janë rastet kur të gjithë në organizatë janë vullnetarë; kur organizata nuk ka të ardhura; kur organizata nuk ka pasur ndonjë aktivitet gjatë vitit të kaluar; dhe kur organizata është themeluar rishtazi.

Nga ana tjetër, anketa tregon se të punësuarit në sektorin e shoqërisë civile kryesisht janë të pambuluar me sigurim social. Përderisa kontributi pensional është një obligim ligjor dhe paguhet nga shumica dërrmuese e OShC-ve për të punësuarit e tyre, vetëm 7% e OShC-ve të anketuara kanë deklaruar se ua paguajnë sigurimin shëndetësor punëtorëve të tyre. Duke mos pasur një sigurim shtetëror shëndetësor funksional, të vetmet mundësi mbesin sigurimet private. Për shkak të dominimit të financimit të projekteve në sektorin e shoqërisë civile, vetëm një numër i vogël OShC-sh kanë fonde të mjaftueshme për mbulimin e sigurimit privat për të punësuarit e tyre. I njëjti problem vlen edhe për pagesën e pjesës së OJQ-së gjatë pushimit të lehonisë, sipas dispozitave të Ligjit të Punës,²² si dhe për gjysmën e kontributeve pensionale të cilat janë obligim i punëdhënësit (në këtë rast, OJQ-ve).



(Fig.9: Aktiviteti financiar i OShC-ve dhe pagesa e tatimeve – Burimi: Anketa me OShC)

Në pyetjen se ai raportojnë në përgjithësi Administratës Tatimore të Kosovës, më shumë se gjysma e OShC-ve të anketuara deklarojnë se rregullisht i raportojnë Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) (67%), 11% deklaruan se nuk i raportojnë rregullisht, ndërsa 22% thanë se fare nuk i raportojnë. Dallimi i madh mes atyre që konsiderojnë se i raportojnë rregullisht dhe atyre që

21 Të dhënat zyrtare nga Administrata Tatimore e Kosovës. 6 korrik 2016. Të dhënat e papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.

22 Për më shumë informata rreth pushimit të lehonisë dhe OJQ-ve, luteni të shihni "Sfidat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë në zbatimin e dispozitave të Ligjit të punës lidhur me pushimin e lehonisë": http://kcsfoundation.org/repository/docs/19_03_2015_1341127_KCSF_Commentary_Maternity_Leave_in_CSO_sector.pdf

aktualisht ia kanë parashtruar raportin vjetor ATK-së (që është obligative, pavarësisht nëse organizata ka transaksione financiare ose të punësuar), tregon qartë se niveli i njohurive për kushtet e raportimit është mjaft i ulët. Në anën tjetër, vetëm një nga të gjitha OShC-të e anketuara deklaroi se ka shkelur një dispozitë ligjore gjatë vitit 2015.


Në mesin e OShC-ve të pjesës veriore të Kosovës sjelljet e raportimit, perceptimet dhe përvojat me ATK-në janë mjaft të ndryshme. Një numër organizatash raportuan se komunikimi është pengesa kryesore gjatë përvojës së tyre me ATK-në. Ftesat e ATK-së nuk arrijnë gjithmonë tek OShC-të e këtij rajoni dhe OShC-të gjithashtu deklarojnë se zyrtarët e ATK-së nuk flasin serbisht, kështu që përfaqësuesit e OShC-ve duhet të vinë disa herë në Prishtinë para se të arrijnë t'i plotësojnë obligimet e tyre me këtë institucion. Derisa një numër OShC-sh deklarojnë se kanë paguar vetëm TVSh-në, disa të tjera gjatë diskutimeve në grupe të fokusit kanë deklaruar se kanë paguar vetëm kontributet për punëtorët e tyre. Vërtetimi tatimor që dëshmon se tatimet janë paguar si një kusht për pranimin e fondeve nga donatorët duket të jetë mekanizëm i efektshëm për plotësimin e obligimeve tatimore.

Auditimet financiare

Krahas kërkesave ligjore për t'i raportuar autoriteteve shtetërore, vetëm OJQ-të me status përfitim publik që kanë qarkullim vjetor mbi 100,000 euro janë të obliguara që të kenë auditime të jashtme financiare. Ngjashëm me studimet e kaluara, Anketa me OShC tregon që kjo kërkesë ligjore tejkalohet dhe përmbushet edhe nga shumë OShC të cilat nuk obligohen me ligj.

Anketa tregon se vetëm një e katërta e OShC-ve të anketuara kanë përpiluar një apo më shumë auditime të jashtme financiare gjatë vitit 2015. Dhjetë për qind e OShC-ve të anketuara kanë raportuar për këtë anketë se kanë pasur një auditim të jashtëm financiar gjatë vitit 2015, ndërsa 7% kishin pasur dy të tilla. Derisa kjo përqindje mund të duket e ulët, përqindja e organizatave pa auditim financiar (76%) është pothuajse e njëjtë me përqindjen e OShC-ve me qarkullim vjetor më të vogël se 100,000 EUR (71.7%). Zbërthimi i të kategorive që kanë pasur auditime të jashtme financiare me qarkullimin vjetor për viti 2015 zbulon se mbi 92% e OShC-ve me të hyra prej 100,000-500,000 EUR gjatë vitit 2015 kanë pasur së paku një auditim të jashtëm financiar, ku disa më të mëdha kanë pasur madje gjashtë ose nëntë auditime financiare gjatë vitit 2015.²³

²³ Zakonisht, OShC-të e konsoliduara ndërmarrin auditime të jashtme financiare si për veprimtarinë e gjithë organizatës, ashtu edhe për projektet/programet më të mëdha që zbatohen nga OShC-ja.



(Fig.10: OShC-të me së paku një auditim të jashtëm financiar sipas qarkullimit vjetor të OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anкета me OShC)

Të dhënat e anketës tregojnë që OShC-të që marrin fonde nga donatorët e jashtëm kanë më shumë gjasa të kenë auditime të jashtëm financiare, ndërsa OShC-të që më së paku kanë gjasa të kenë auditime të jashtëm financiare janë ato që marrin fonde nga institucionet vendore apo komunitat.

Aktivitetet ekonomike të OJQ-ve

Në kërkimin e mjeteve të nevojshme financiare për financimin e aktiviteteve të tyre të përditshme, OShC-të janë të lira të gjenerojnë fonde nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe nga aktivitetet e tyre ekonomike. Në fakt ky lloj financimi konsiderohet si një nga më të qëndrueshmit pasi që ua mundëson OShC-ve fleksibilitetin e nevojshëm në përshtatjen e fondeve të tyre nevojave dinamike të grupeve dhe përfituesve të tyre të synuar.

Korniza ligjore ua mundëson OShC-ve të angazhohen në aktivitete ekonomike për aq kohë sa të hyrat e krijuara nga aktivitetet ekonomike të përdoren për avancimin e misionit të OShC-së.²⁴ Derisa llojet dhe niveli i aktiviteteve ekonomike nuk kanë kufizime, ekzistojnë disa çështje specifike kur kemi të bëjmë me aspektet tatimore të aktiviteteve të OShC-ve. Në Ligjin e ri për të hyrat e korporatave, të miratuar në shtator të vitit 2015, përjashtimet nga tatimi në fitim për aktivitetet e ndërlidhura ekonomike nuk janë ndryshuar. Kriteret e ndryshme të parapara në këtë Ligj krijojnë një situatë juridike dykuptimëshe lidhur me trajtimin tatimor të të hyrave të OShC-ve nga aktiviteti ekonomik. Në bazë të ligjit dhe interpretimeve të autoriteteve tatimore, të gjitha të hyrat e OShC-ve nga aktiviteti ekonomik tatimohen me tatimin standard në të ardhura prej 10%, përveç nëse aktiviteti ekonomik ekskluzivisht ndërlidhet me qëllimin publik të OShC-së dhe shkon deri në nivel të arsyeshëm të të ardhurave.²⁵

24 Për lirinë e asociimit në OJQ, Ligji 04/L-057, art.16.4

25 Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.24

Thënë në përgjithësi, vetëm një numër i vogël OShC-sh realizojnë ndonjë aktivitet ekonomik. Vetëm 17% e OShC-ve të intervistuar kanë deklaruar se kanë pasur ndonjë aktivitet ekonomik gjatë vitit 2015. Disa prej tyre krijojnë të ardhura duke ofruar shërbime (pra, ku klienti paguan për shërbime, p.sh.: shërbime të hulumtimit, shërbime të vlerësimit, trajnime për propozime të planeve të biznesit apo projekteve, dhënia me qira e zyrave, dhënia me qira e pajisjeve, etj) (11% e OShC-ve) apo shitjes së produkteve të organizatës (5%). Tri të katërtat e OShC-ve kanë deklaruar se nuk janë ballafaquar me ndonjë pengesë në realizimin e aktiviteteve të tyre ekonomike; 5 OShC janë ankuar për trajtimin e komplikuar apo joadekuat nga sistemi tatimor; 3 janë ankuar për rregullat e raportimit dhe monitorimit, ndërsa 1 është ankuar për kërkesat e shumta administrative dhe 1 tjetër për rregullat e komplikuar të kontabilitetit.

Niveli i ulët i njohurive për legjislacionin tatimor gjithashtu vërtetohet kur kemi të bëjmë me lehtësirat tatimore për OShC-të, pasi që gjysma e OShC-ve të intervistuar deklarojnë se nuk i dinë procedurat për këto lehtësira. Pjesa tjetër e tyre i konsideron procedurat për lehtësira tatimore të komplikuar apo disi të komplikuar, dhe vetëm 6.9% i konsiderojnë ato si të lehta.

Stimulimet për donatorët e OShC-ve

Lehtësirat tatimore për OShC-të dhe donatorët e tyre në përgjithësi janë të ulëta, përkundër që ekzistojnë disa dispozita pozitive ligjore, në veçanti lidhur me donatorët privatë të OShC-ve. Ligji i ri për tatimin në të hyrat e korporatave dhe Ligji për tatimin në të ardhura personale parashohin rritjen e zbritjeve tatimore për donacionet e korporatave apo për ato individuale nga 5% në 10% të të ardhurave të tyre të tatueshme, nëse këto donacione janë për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, të mbrojtjes së mjedisit apo të sportit. Pranuesit me të drejtë të marrjes së këtyre donacioneve përfshijnë OJQ-të dhe cilëndo organizatë tjetër jokomerciale që drejtpërsëdrejti realizojnë aktivitete në fushat e lartpërmendura. Lehtësirat tatimore ofrohen vetëm për një numër të përzgjedhur të aktiviteteve për përfitim publik, numër i cili është shumë më i vogël se numri në listën e aktiviteteve për përfitim publik në Ligjin bazë për OJQ-të.

Sipas të dhënave zyrtare të ATK-së, gjatë vitit 2015 ka qenë vetëm një rast ku një kompani donatore ka kërkuar lirim tatimor për një donacion të dhënë OShC-së. Ky donacion ka qenë në shumë prej 700 EUR.²⁶

Rezultate të ngjashme dalin edhe nga Anketa me OShC, e cila tregon se shumë pak OShC kanë përfituar nga lirimet tatimore gjatë vitit 2015. Lirimi tatimor i raportuar më së shpeshti (TVSh, e raportuar nga nëntë OShC) në vlen për shkak të qenit OJQ por për shkak të përjashtimeve që vlejnë për donatorë të ndryshëm të huaj (p.sh. fondet e BE-së ose donatorë bilateralë). Lehtësirat tatimore tjera kanë qenë jashtëzakonisht të ulta: nga një OShC kanë raportuar se kanë përfituar nga lirimi nga tatimi në qira/pronë, tatime komunale, tatime doganore dhe stimulime për donatorët e tyre privatë.

²⁶ Të dhënat zyrtare nga Administrata Tatimore e Kosovës. 6 korrik 2016. Të dhënat e papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.

Lehtësira tatimore	OShC-të që kanë përfituar nga lehtësirat tatimore
Lirim nga tatimi në të ardhura të korporatave/Tatimin në fitim	0%
Lirim nga tatimi në qera/pronë	1%
Lirim nga Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH)	9%
Lirim nga taksat komunale	1%
Lirim nga taksat doganore	1%
Lehtësira tatimore për donatorët privat të organizatës	1%
Lehtësira tatimore për investimet pasive	0%

(Fig.11: OShC-të që kanë përfituar prej lehtësirave tatimore gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Anketa me OShC tregon mungesë të dijes edhe kur kemi të bëjmë me përfitimet tatimore për donatorët e OShC-ve. Kështu, 57% e OShC-ve të anketuara deklarojnë se nuk kanë njohuri për lehtësirat tatimore për donatorët e OShC-ve, ndërsa 18% kanë deklaruar se në Kosovë nuk ka lehtësira tatimore për donatorë.

Statusi për përfitim publik

Në Ligjin për lirinë e asociimit në OJQ rregullohet themelimi dhe regjistrimi i organizatave joqeveritare, qofshin ato me status të përfitimit publik apo për interes të ndërsjellë, me qëllim të arritjes së qëllimit legjitim, i cili nuk është në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë. Në parim, OJQ-të me përfitim të ndërsjellë kryesisht themelohen për të mbrojtur dhe avancuar interesat e anëtarëve të tyre, të cilat jo domosdo nënkuptojnë interesat publike. Në anën tjetër, OJQ-të me status për përfitim publik janë të organizuara dhe veprojnë që të ndërmarrin në kuadër të aktiviteteve të tyre kryesore së paku njërin prej aktiviteteve që konsiderohet se shërben për të mirën e publikut. Organizatat për përfitim publik kanë të drejtë në lehtësira tatimore dhe fiskale në përputhje me ligjin në fuqi, përveç atyre të cilat në thelb janë pagesa për shërbime publike komunale.²⁷ Për të siguruar që lehtësirat të përdoren në mënyrën e duhur, ato janë të obliguara që çdo vit t'i raportojnë Departamentit të OJQ-ve si për menaxhimin financiar, ashtu edhe për aktivitetet e tyre.²⁸ Një OJQ mund të aplikojë për status të përfitimit publik menjëherë pas regjistrimit ose edhe më vonë.

Gjatë vitit 2015, 247 OJQ kanë pasur status aktiv për përfitim publik.²⁹ Që nga fillimi i procesit për regjistrimin e OJQ-ve në vitin 1999, 496 organizatave iu është hequr ky status. Edhe pse shumë organizata të tjera veprojnë në fushat që konsiderohen për përfitim publik, shumë prej tyre vendosin mos ta marrin këtë status. Pothuajse gjysma e OShC-ve të anketuara që nuk kanë status

27 Për lirinë e asociimit në OJQ, Ligji 04/L-057, art. 17.4.

28 Për lirinë e asociimit në OJQ, Ligji 04/L-057, art.18

29 Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.15

për përfitim publik deklaruan se arsyeja e mosaplikimit për status të tillë është mungesa e ndonjë lehtësie në praktikë. Për më tepër, një e treta e OShC-ve të anketuara u përgjigjen se nuk e dinë arsyen pse nuk e kanë këtë status, duke nënkuptuar se mund të mos jenë të informuara për këtë mundësi.

Derisa Ligji bazë për OJQ-të përfshinë dispozitat ku garantohen lehtësirat tatimore dhe fiskale, legjislacioni specifik tatimor parasheh vetëm disa lehtësi. Në teori, ndër lehtësirat kryesore do të duhej të ishin lehtësirat tatimore për donatorët privatë, të cilët u japin donacione organizatave për përfitim publik. Në realitet, lehtësirat tatimore që vinë nga Ligji për të ardhurat e korporatave dhe Ligji për tatimin në të ardhurat personale nuk ndërlidhen me statusin e përfituesit publik, por më shumë me një numër të kufizuar të të aktiviteteve për përfitim publik. Si rrjedhojë, lehtësirat ofrohen edhe për donacionet e dhëna për llojet e tjera të organizatave, në rast se janë aktive në njërin nga fushat e listuara të aktiviteteve. Dispozitat për aktivitetet ekonomike kanë shumë dykuptimësi dhe vështirë se prodhojnë ndonjë efekt në praktikë për organizatat me status të përfitimit publik. Duke marrë parasysh vetëm një numër të vogël stimulimesh të lidhura me statusin, por të përcjella me kërkesa me rigoroze për raportim, statusi për përfitim publik është shndëruar më shumë në prestigj sesa lehtësi.



Qeverisja dhe kapacitetet e brendshme


Shumica e OShC-ve janë të regjistruara si shoqata, por jo të gjitha i respektojnë kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me organin e tyre më të lartë. Më pak se gjysma e OShC-ve konfirmojnë që kanë dokumente të qeverisjes së brendshme, ndërsa OShC-të më të mëdha kanë më shumë rregulla të brendshme. Rreth gjysma e OShC-ve kanë faqe të internetit ose të Facebook-ut në të cilat mund t'i publikojnë informatat relevante për punën e tyre. Përderisa shumica e OShC-ve kanë pak ose aspak staf, sektori i shoqërisë civile megjithatë përfaqëson një gjenerues të rëndësishëm të punësimit në Kosovë. Përkundër që vlerësojnë që stafi i tyre ka kapacitete solide, OShC-të ballafaqohen me sfida të mëdha kur u duhet të punësojnë staf të kualifikuar. Për dallim nga sektorët tjerë, përfaqësimi gjinor në stafin e punësuar në shoqëri civile është gati se i baraspeshuar ndërmjet burrave dhe grave. Financimi afat-shkurtër rezulton me kohëzgjatje të shkurtër të qëndrimit të stafit në organizatë. Rrjetëzimi dhe komunikimi brenda-sektoral brenda vendit është më i zhvilluar krahasuar me rrjetëzimin dhe komunikimin ndërkombëtar.

Organet udhëheqëse

Pasi që legjislacioni i Kosovës parashihet vetëm dy lloje të OJQ-ve, shoqatat dhe fondacionet, ekzistojnë një numër i vogël kushtesh ose kërkesash për qeverisjen e brendshme të këtyre organizatave. Si organizata me anëtarësi që janë, nga shoqatat kërkohet të kenë Kuvendin e Anëtarëve si organin më të lartë drejtues, i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës. Organi më i lartë drejtues i fondacionit është Bordi i Drejtorëve, i emëruar nga themeluesi apo themeluesit e fondacionit. Organi më i lartë drejtues ka një numër kompetencash të rezervuara, siç është miratimi i raporteve vjetore dhe planeve vjetore, ndryshimin e statutit dhe aktit themeltar, zgjedhjen e zyrtarëve më të lartë të OJQ-së, si dhe bashkimin, ndarjen apo shpërbërjen e OJQ-së. Kushtet e tjera të përgjithshme për qeverisjen e brendshme ndërlidhen me konfliktin e interesit dhe ndalimin e angazhimit në fushata politike e zgjedhje.

Shumica e OJQ-ve të intervistuar (90%) raportuan të jenë të regjistruara si shoqata, ndërsa pjesa e mbetur u deklaruar si fondacione. Megjithatë, përkundër kërkesave të qarta ligjore, rreth 53% e OShC-ve raportuan se organi më i lartë udhëheqës është Kuvendi i Anëtarëve, 35% zgjedhën Bordin, ndërsa 12% thanë se këtë rol e luan drejtori i organizatës. Një e gjetur interesante është se të dyja llojet e OJQ-ve kanë raportuar që kanë organe më të larta drejtuese ndryshe nga kërkesat ligjore. Nga të gjitha shoqatat e anketuara, vetëm 56.8% deklaruan se organi më i lartë i tyre drejtues është Kuvendi i Anëtarëve, ndërsa 30.7% thanë se ky organ është Bordi dhe 12.5% deklaruan se organizatën e drejton drejtori ekzekutiv. Sa i përket fondacioneve, 20% raportuan se atë e drejton Kuvendi i Anëtarëve. Edhe pse shumica e OShC-ve me organ drejtues të ndryshëm nga kërkesat ligjore janë OShC-të të vogla lokale, mund të gjenden edhe raste të disa OShC-ve të konsoliduara, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare. Rezultatet e ngjashme janë konstatuar edhe në Indeksin Kosovari të Shoqërisë Civile të vitit 2014, kur vetëm 60% e shoqatave kishin deklaruar Kuvendin e Anëtarëve si organin më të lartë drejtues.³⁰

Organet më të larta drejtuese të deklaruara nga shoqatat




(Fig.12: Organet më të larta drejtuese të deklaruara nga shoqatat – Burimi: Anketa me OShC)

30 Indeksi Kosovari i Shoqërisë Civile. Raport. Fondacioni Kosovari për Shoqëri Civile, 2014. 14.

Vendimmarrja

Është kusht ligjor që organi më i lartë drejtues i OJQ-së të takohet së paku njëherë në vit, me qëllim të miratimit të raporteve vjetore të vitit paraparak dhe të planeve vjetore për vitin e ardhshëm. Anketa tregon se pjesa dërrmuese e OShC-ve (86.5%) e kanë plotësuar këtë obligim, ku 40% të OShC-ve madje edhe e kanë tejkaluar, duke thënë se gjatë vitit 2015 kanë pasur dy apo më shumë takime të organit drejtues. Megjithatë, janë diku rreth 14% të OShC-ve të anketuara të cilat deklaruan se organi më i lartë i tyre drejtues fare nuk është takuar gjatë vitit 2015. Kjo parqet një rritje të vogël nga Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile për vitin 2014, kur vetëm 4% e OShC-ve të anketuara thanë se nuk e kanë përmbushur këtë obligim. Për shkak të numrit më të mëdh të OShC-ve më të vogla dhe më pak aktive në anketën e vitit 2015, ky ndryshim nuk është befasues.



(Fig.13: Shpeshtësia e takimeve të organeve më të larta drejtuese gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Edhe pse nuk është kusht ligjor, parimi i ndarjes së pushtetit është parim përgjithësisht i pranuar edhe në sektorin e shoqërisë civile. Kjo nënkupton se punonjësit ekzekutiv, pra, drejtorit ekzekutiv, nuk duhet të jetë pjesë e bordit të drejtorëve të fondacionit. Ky parim zbatohet nga shumica e fondacioneve, pasi që 77% e tyre kanë deklaruar për anketë se asnjëri nga anëtarët e bordit nuk është i punësuar në organizatë. Megjithatë, 14% e OShC-ve të anketuara deklarojnë se drejtorit ekzekutiv i tyre është anëtar i bordit, ndërsa 7% thanë se anëtarët e tjerë të bordit janë të punësuar në organizatë.

Megjithatë, kur u pyetën se kush i merr vendimet kryesore në organizatë, të gjeturat e anketës tregojnë se shumë udhëheqës të organizatave nuk kanë njohuri të mjaftueshme për rolet dhe përgjegjësinë e organit më të lartë udhëheqës në organizatë. Në mesin e shoqatave, 41% deklaruan se vendimet kryesore në organizatën e tyre merren nga bordi, ndërsa vetëm 41% e tyre thanë se vendimet i merr Kuvendi i Anëtarëve. Numri i organizatave të regjistruara si fondacione që iu përgjigjen kësaj pyetje ka qenë mjaft i vogël; nga gjithsej nëntë, gjashtë deklaruan se vendimet kryesore në organizatën e tyre i merr bordi, njëra e ceku drejtorin ekzekutiv dhe dy të tjerat thanë se vendimet i marrin punonjësit e organizatës.

Këto të gjetura demonstrojnë se përkundër që kërkesat ligjore për qeverisjen e brendshme janë të pakta, një numër i konsiderueshëm i OShC-ve në Kosovë ende kanë nevojë të rrisin kuptimin lidhur me kushtet dhe parimet e qeverisjes së brendshme.


Dokumentet e brendshme dhe transparenca

Niveli i rregullimit të brendshëm të një OShC-je varet nga madhësia e saj dhe lloji i aktiviteteve që realizon. Organizatat e konsoliduara që operojnë me buxhete të mëdha dhe që kanë shumë punëtorë pritet të kenë më shumë dokumente dhe procedura formale lidhur me punët e tyre të përditshme, ndërsa ato të voglat nuk kanë nevojë domosdo që të kenë procedura të vështira dhe burokratike gjatë aktiviteteve të tyre të përditshme. Një numër pyetjesh prej anketës së organizatave hedhin më shumë dritë në nivelin e dokumenteve formale dhe plotësimin e obligimeve nga ana e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.

Një pjesë e madhe e OShC-ve të anketuara deklaruan se nuk kanë kod të mirësjelljes për punonjësit e tyre (39%); rregullore financiare (43%) apo kontrata të punës për punonjës (39%). Njëzet për qind thanë se nuk kanë rregullore të punës dhe 22% deklaruan se nuk kanë rregullore të punës për Kuvendin e Anëtarëve. Nga ato organizata që thanë se i kanë këto dokumente, vetëm një pjesë e tyre ua treguan ato dokumente intervistuesve gjatë anketës së terren. Kështu, 39% treguan kodin e mirësjelljes për punonjësit, 44% rregulloren e punës, 31% rregulloren financiare, 42% rregulloren e punës të Kuvendit të Anëtarëve /Bordit dhe 35% paraqiten një shabllon të kontratës së punës për punonjësit e tyre.

Zbërthimi i të dhënave të anketës tregon se niveli i formalizimit dhe pasjes së dokumenteve të brendshme përkon me madhësinë e OShC-së. Shumica e atyre që nuk i kishin apo që nuk i treguan këto dokumente të brendshme hyjnë në kategorinë e OShC-ve të vogla në kuptim të qarkullimit vjetor dhe të numrit të punëtorëve.

Të gjetura të ngjashme rezultojnë edhe sa i përket raportimit të ATK. Me 11% të OShC-ve që deklaruan se nuk raportojnë me rregull dhe 22% që deklaruan se fare nuk raportojnë në ATK, shumica e tyre nuk kanë pasur fonde apo punëtorë të punësuar.



(Fig.14: Ekzistimi i dokumenteve të brendshme – Burimi: Anketa me OShC)

Me përparimin e teknologjisë së komunikimit dhe informimit, nga OShC-të pritet që gjithnjë e më shumë të përdorin mënyrat e reja të komunikimit të punës së tyre përfituesve dhe qytetarëve në përgjithësi. Derisa OShC-të më të mëdha mund t'i përballojnë shpenzimet e dizajnit dhe mirëmbajtjes së një faqeje në internet, ato të voglat mund të shfrytëzojnë falas platformat shoqërore. Rezultatet e anketës tregojnë se ka mjaft hapësirë për përmirësime në kuptim të qasshmërisë më të lehtë të qytetarëve në punën e OShC-ve. Nga 101 OJQ-të e intervistuar, 28.7% kanë faqen zyrtare të internetit dhe së paku një faqe në rrjetet shoqërore. Ndërsa 19.7% e tyre kanë faqen në Facebook ose faqen zyrtare, 51.5% nuk e kanë asnjërën, ndërsa 5% kanë faqet tjera të rrjeteve shoqërore përpos Facebook-ut.

Të punësuarit

Sektori i shoqërisë civile vepron me fonde të konsiderueshme dhe punëson një numër domethënës të njerëzve. Përkundër kësaj, shteti nuk njeh vlerën ekonomike të sektorit dhe nuk trajton në mënyrë të duhur nevojat e tij përmes politikave dhe legjislacionit.

Legjislacioni i tanishëm nuk ka dispozita specifike për OShC-të dhe ato kanë kushtet e njëjta me punëdhënësit e tjerë. Në teori, trajtimi i barabartë mund të konsiderohet si gjendje e mirë për sektorin. Megjithatë, për shkak të shumë specifikave të sektorit, posaçërisht të lidhura me mënyrat e tij të financimit, nevojat specifike nuk trajtohen në mënyrë të duhur. Për ta ilustruar këtë, dispozitat për pushimin e lehonisë, të cilat janë obliguese për të gjithë punëdhënësit, janë shumë problematike për OShC-të. Një sfidë tjetër e identifikuar nga OShC-të lidhur me legjislacionin e punës është kontraktimi i punëtorëve në bazë të projektit, që nuk mbulon domosdo të gjitha

përfitimet e mundshme për punëtorët, të garantuara në Ligjin e punës, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e punësimit.³¹

Gjithashtu, OShC-të nuk janë pjesë e asnjë programi shtetëror për punësim. Vetëm 5 OShC pjesëmarrëse të anketës kanë deklaruar se gjatë vitit 2015 kanë përfituar nga programet e punësimit të përkrahura nga shteti. Pjesa e mbetur prej 95% të organizatave thanë se nuk kanë përfituar nga këto programe sepse *ato ekzistueset nuk janë të parapara për OShC-të (18%), sepse nuk kanë punësuar punëtorë të ri gjatë vitit 2015 (36%) ose sepse nuk kanë njohuri për programet e punësimit të qeverisë (41%)*.

Përkundër mungesës së mbledhjes dhe publikimit sistematik të të dhënave rreth sektorit të shoqërisë civile nga institucionet publike, pas kërkesës së KCSF-së disa të dhëna për punësimin në OShC më në fund janë vënë në dispozicion nga FKPK dhe ATK. Përkundër numrave të ndryshëm varësisht prej burimit dhe mungesës së hollësive lidhur me llojin e punësimit, prapëseprapë është e qartë se shoqëria civile është gjenerator mjaft i rëndësishëm i vendeve të punës dhe punëson një përqindje të konsiderueshme të të punësuarve në Kosovë. Sipas FKPK-së, gjatë vitit 2015 OShC-të në Kosovë kanë paguar kontribute pensionale për 10,466 individë.³² Nëse marrim parasysh numrin prej 285,914 të kontribuuesve aktivë në vitin 2015,³³ shoqëria civile përbën rreth 3.66% numrit të përgjithshëm të kontribuuesve të FKPK-së. Nga ky numër, 3,329 kontribuues janë punësuar në shoqërinë civile për tërë 12 muajt e vitit 2015, ndërsa 4,142 kanë pasur angazhime të tjera përveç atyre në shoqërinë civile.³⁴ Sipas ATK-së, 927 OShC kanë deklaruar se kanë punësuar gjithsej 6,412 persona gjatë vitit 2015.³⁵ Asnjë nga burimet e lartpërmendura nuk ka mundur të jep të dhëna specifike për numrin e të punësuarve me orar të plotë, me gjysmë orari apo të atyre vetëm për ndonjë detyrë specifike.

Shpërndarja gjeografike e kontribuuesve individualë nga sektori i shoqërisë civile në përgjithësi është në përputhje me përhapjen gjeografike të OJQ-ve të regjistruara, ku Prishtina gjendet në maje të listës me pothuajse 40% të kontribuuesve. Lista vazhdon me ajonin e Prizrenit (12.7%), Mitrovicës (11.8%), Pejës (9.4%) dhe me qendrat e tjera rajonale të Kosovës. Edhe pse të dhënat e pranuar nga FKPK nuk kanë ndonjë zberthim në raport me komunat specifike, në GF me OShC-të e pjesës veriore të Kosovës është theksuar që disa OShC nga ky rajon gjithashtu mbulojnë edhe komunat e tjera të banuara kryesisht me serbë të Kosovës.


31 Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.³²

32 Të dhënat nga Trusti Pensional i Kosovës. 25 maj 2016. Të dhëna të papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.

33 Vërshim Hatipi dhe Jeton Demi. Raporti vjetor 2015. Raport. Trusti Pensional i Kosovës, 2016.

34 Të dhënat zyrtare nga Trusti Pensional i Kosovës. 25 maj 2016. Të dhëna të papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.

35 Të dhënat zyrtare nga Administrata Tatimore e Kosovës. 6 korrik 2016. Të dhëna të papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.




(Fig.15: Shpërndarja gjeografike e të punësuarve të OJQ-ve – Burimi: FKPK)

Për dallim prej sektorëve të tjerë të punësimit në Kosovë, përfshirë sektorin publik dhe privat, një trend pozitiv në kuadër të shoqërisë civile ka të bëjë me përbërjen gjinore të fuqisë punëtore brenda sektorit. Raporti vjetor i FKPK-së për vitin 2015 tregon që numri i kontribuuesëve sipas gjinisë në përgjithësi në fuqinë punëtore në Kosovë është 69% me 31% në dobi të burrave,³⁶ ndërsa Anketë e Fuqisë Punëtore e Kosovës për vitin 2015 e tregon një dallim edhe më të madh, me 77.44% me 22.56% në favor të burrave.³⁷ Përfaqësimi gjinor në sektorin e shoqërisë civile është pothuajse i baraspeshuar: sipas raportit të FKPK-së për vitin 2015 gjendja është 52.6% me 47.4% në favor të burrave,³⁸ ndërsa sipas Anketës me OShC gjendja është 49% me 51% në favor të grave.

36 Vërsim Hatipi dhe Jeton Demi. Raport vjetor 2015. Raport. Trusti Pensional i Kosovës, 2016.

37 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore të Kosovës 2015. Qershor 2016.10. Mund të gjendet në:
<https://ask.rks-gov.net/en/lm?download=1636:results-of-the-kosovo-2015-labour-force-survey>

38 Të dhënat zyrtare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. 25 maj 2016. Të dhënat e papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.



(Fig.16: Shpërndarja gjinore e të punësuarve në shoqërinë civile dhe në sektorë të tjerë në vitin 2015 – Burimi: FKPK)

Përkundër përfaqësimit në përgjithësi të baraspeshuar, zberthimi i të dhënave të Anketës me OShC³⁹ tregon se përfaqësimi i grave në strukturat menaxhuese të OShC-ve është paksa me i ulët në përqindje, derisa duket të jenë të nënpërfaqësuar në masë mjaft të madhe në nivel të kuvendit të anëtarëve dhe bordeve të organizatave.

Dallime të tilla ndërmjet sektorëve nuk janë prezente kur bëhet fjalë për të ardhurat mesatare. Edhe pse ekzistojnë vështirësi të ngjashme në vlerësimin e këtij indikator për shkak të mungesës së mbledhjes sistematike të të dhënave, disa llogari të përafërta mund të bëhen nga të dhënat në dispozicion. Kjo llogari bazohet në vlerën mesatare të kontributeve pensionale të të punësuarëve të sektorëve të veçantë, dhe faktit që përqindja e kontributeve pensionale të të punësuarëve është e njëjtë pavarësisht sektorit të punësimit. Duke e llogaritur vlerën mesatare të kontributeve pensionale në FKPK, të ardhurat mesatare mujore për të punësuarit në sektorin e shoqërisë civile për vitin 2015 janë 482.3 euro, ndërsa e njëjta në sektorin publik është 473.1 euro.⁴⁰

Rekrutimi i të punësuarëve


Pothuajse tri të katërtat e OShC-ve të intervistuar deklaruan se kualifikimet arsimore për fushën përkatëse dhe përvoja relevante e punës në atë fushë janë dy kriteret më të rëndësishme që ato i marrin parasysh me rastin e punësimit. Referencat nga organizatat apo partnerët e besueshëm janë cekur si kriter të rëndësishme prej 44% të OShC-ve të intervistuar, ndërsa përvoja e punës në sektorin e shoqërisë civile duket të jetë kriter i rëndësishëm për vetëm 40% të OShC-ve. Nga

39 Shifrat janë llogaritur duke mbledhur shumën e të gjithë numrave të dhënë nga secila organizatë. Disa numra të skajshëm të anëtarëve dhe vullnetarëve janë hequr për qëllime të llogaritjeve të sakta.

40 Të dhënat zyrtare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. 13 korrik 2016. Të dhënat e papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.

ana tjetër, 4% e OShC-ve cekin kriteret vijuese si të rëndësishme për punësimin e punëtorëve të ri: aftësinë e të mësuarit të shpejtë, shkathtësitë e komunikimit dhe njohurinë e gjuhëve të huaja.

Gjithashtu, 44% e OShC-ve thanë se punëtorët e tyre qëndrojnë në organizatë mesatarisht 3-5 vite, 28% kohëzgjatjen e qëndrimit të të punësuarëve e kanë mesatarisht dy vite, ndërsa 16.3% më shumë se pesë vite. Një zberthim i kategorive të OShC-ve lidhur me kohëzgjatjen e qëndrimit të punëtorëve në organizatë tregon se OShC-të që kanë projekte më të gjata zakonisht mbajnë punëtorët e tyre më gjatë, dhe e njëjta vlen për OShC-të me të hyra më të mëdha, të cilat mund t'ia lejojnë vetës mbajtjen e stafit për një periudhë më të gjatë. Megjithatë, është me rëndësi të ceket se definimi si punëtorë të OShC-së nuk do të thotë domosdo se ata paguhen rregullisht apo se punojnë vetëm për atë OShC. Kjo vlen posaçërisht për ato OShC me të hyra të ulëta, ku të angazhuarit në ato OShC (drejtori ekzekutiv ose të tjerët) merren me organizatë në baza vullnetare dhe paguhen vetëm herë pas here, me rastin e financimit të ndonjë projekti apo nisme specifike. Kjo rritë drejtpërdrejt kohëzgjatjen e qëndrimit të të punësuarëve brenda grupit të OJQ-ve më të vogla dhe me të hyra më të pakta, përkundër që shumë prej tyre nuk paguhen për punën e tyre për organizatën.



(Fig.17: Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në organizatë krahasuar me qarkullimin vjetor të OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Shumica e OShC-ve në pjesën veriore të Kosovës punësojnë staf vendor (nga rajoni i tyre), dhe zakonisht ata janë të rinj. Edhe pse shumica e OShC-ve që kanë marrë pjesë në diskutime të GF në këtë rajon u pajtuan se ekziston ofertë e mjaftueshme e fuqisë punëtore me kualifikime të larta, shumë OShC deklaruan se duhet të punësojnë punëtorë nga Serbia pasi që aplikuesit për vende të punës në pjesën veriore të Kosovës nuk kanë përvojë të mjaftueshme. Kohëzgjatja e qëndrimit të të punësuarëve në organizatë gjithashtu është cekur si një problem i madh për shkak të pagave të ulëta apo mungesës së plotë të pagave në sektor.


Kapacitetet e brendshme

Për të marrë më shumë informata lidhur me aftësitë kryesore të nevojshme për punën e OShC-ve, përveç vetperceptimit të OShC-ve, anketa është zgjeruar edhe te donatorët e huaj të cilët përkrahin sektorin e shoqërisë civile në Kosovë dhe te një numër rrjetesh të mëdha si në nivelin qendror,

ashtu edhe në atë lokal. Është interesant të theksohet se edhe OShC-të edhe donatorët e huaj kanë perceptime të larta sa i përket kapacitetit të stafit të OShC-ve. Nga ana tjetër, rrjetet e OShC-ve kanë një vlerësim më negativ për kapacitetet e anëtarëve të tyre. Vlerësimi pozitiv i donatorëve të huaj mund të shpjegohet me faktin se këta donatorë kanë prirje të bashkëpunojnë kryesisht me OShC-të më të mëdha dhe më të konsoliduara, dhe kryesisht nuk janë të ekspozuara ndaj pjesës më të madhe të sektorit, p.sh. ato organizata që nuk marrin fonde të huaja. Anëtarësia e shumicës së rrjeteve është e larmishme, dhe pasqyron kategoritë e përgjithshme të shoqërisë civile në Kosovë, ku OShC-të e vogla lokale janë grupi më i madh i anëtarëve të rrjeteve.

OShC-ve vlerësojnë lart veçanërisht kapacitetet e tyre në zbatimin e projekteve (68%) dhe menaxhimin financiar të tyre (68%). Sigurimi i fondeve nga ana tjetër perceptohet të jetë si më problematik, ku 32% e OShC-ve të anketuara deklaruan se organizata e tyre ka kapacitete të dobëta për gjetjen e donatorëve apo ngritjen e fondeve, ndërsa 39% e OShC-ve të intervistuar thanë se kanë kapacitete të larta për hartimin e propozimeve të projekteve.

Megjithatë, kur u pyetën nëse punonjësit e tyre janë të përgatitur profesionalisht për fushëveprimin e aktivitetit të organizatës së tyre, kryesisht OShC-të e konsiderojnë stafin e tyre profesional.




(Fig.18: Vetëvlerësimi i kapaciteteve të brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)

Nga OShC-të gjithashtu është kërkuar që të rendisin tri përparësitë dhe dobësitë kryesore të stafit të tyre. Përmbledhja e përgjigjeve në tabelë tregon se gjuhët e huaja (gjuha angleze si më e rëndësishmja), hartimi i propozimeve të projekteve, mobilizim i resurseve, përvoja profesionale dhe menaxhimi i projekteve janë shumë të rëndësishme për punën në këtë sektor. Një numër mjaft i madh i OShC-ve të intervistuar konsiderojnë menaxhimin, profesionalizimin, përvojën profesionale, shkathhtësitë e komunikimit, shkrimin (si të propozimeve të projektit, ashtu edhe të raporteve hulumtuese dhe publikimeve), shkathhtësitë për trajnim, njohuritë e gjuhëve të huaja dhe aftësitë hulumtuese si përparësi të punonjësve në sektorin e shoqërisë civile. Ndërsa nga ana tjetër, mosnjohja e gjuhëve të huaja, mosaftësia për mobilizimin e resurseve (duke përfshirë hartimin e propozimeve të projekteve), mungesa e përvojës në menaxhim dhe të asaj profesionale konsiderohen si dobësi të punëtorëve të sektorit të shoqërisë civile nga një pjesë e madhe e OShC-ve të anketuara.

Përparësitë	Numri i OShC-ve	Dobësitë	Numri i OShC-ve
Menaxhimi (gjegjësisht, menaxhimi i projekteve)	28	Njohja e gjuhëve të huaja (posaçërisht e anglishtes)	31
Profesionalizmi	27	Mobilizimi i resurseve	14
Përvoja profesionale	27	Hartimi i propozimeve të projektit	8
Komunikimi	19	Menaxhimi	6
Hartimi i projekteve dhe publikimeve e raporteve	17	Mungesa e përvojës profesionale	6
Trajnimi	11	Puna ekipore	5
Njohja e gjuhëve të huaja (anglisht, gjermanisht)	10	Shkathësitë në kompjuter dhe internet	5
Aftësitë hulumtuese	10	Komunikimi	4
Puna ekipore	9	Mungesa e profesionalizimit	4
Organizimi	9	Avokimi dhe lobimi	3
Motivimi	8	TI	3
Lobimi dhe avokimi	7	Mungesa e motivimit	3
Arsimi	5	Rrjetëzimi	3
TI	5	Komunikimi	3
Rrjetet	3	Përkushtimi	2
Shkathësitë për financa	2	Aftësitë trajnuese	2
Hulumtimi	2	Përpikmëria	1
Operacionale	2	Donatorët	1
Transparenca	2	Përvoja përkatëse	1
Përpikmëria	2	Financat	1
Efikasiteti	1	Hulumtimet dhe analizat	1
Përvoja në punën në terren	1	Mosha e vjetër	1
Kryerja e përnjëhershme e shumë detyrave	1	Vullnetarizmi	1
Pozitiviteti	1	Kryerja e përnjëhershme e shumë detyrave	1
Mobilizimi i resurseve	1	Mungesa e shkollimit të duhur	1
Auditimi	1	Aftësia për të punuar individualisht	1
Besimi	1	Mosha e re	1
Fleksibiliteti	1	Monitorimi	1
Mosha e re	1	Mungesa e iniciativës	1
Përkushtimi	1		
Rigrantimi	1		


(Fig.19: Vetëvlerësimi për përparësitë dhe dobësitë kryesore të kapaciteteve të brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)

OShC-të në pjesën veriore të Kosovës zakonisht i ndërlidhin kapacitetet e burimeve njerëzore me efektshmërinë e tyre në mobilizimin e resurseve. Aftësia e ngritjes së fondeve, pasja e kontakteve në institucione dhe hartimi i propozimeve të projekteve janë cekur si shkathtësitë më të rëndësishme të OShC-ve gjatë diskutimeve në grupe të fokusit me OShC-të serbe në pjesën veriore të Kosovës.



(Fig.20: Vlerësimi i donatorëve të huaj lidhur me kapacitetet e brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketat me donatorë)

Agjencitë ndërkombëtare donatore në përgjithësi kanë perceptim të mirë për kapacitetet e OShC-ve lidhur me aktivitete të ndryshme. Përparësia kryesore e shoqërisë civile, sipas donatorëve ndërkombëtarë, duket të jetë njohuria apo ekspertiza e OShC-ve në fushat tematike, ku vlerësimi pozitiv është dhënë edhe për zbatimin dhe menaxhimin operacional të projekteve, përfshirë menaxhimin financiar të projekteve. Vlerësimi për planifikimin strategjik është më pak pozitiv; 38% e donatorëve të huaj ndajnë mendimin se OShC-të kanë kapacitete të ulëta për planifikim strategjik.



(Fig.21: Vlerësimi i rrjeteve të OShC-ve për kapacitetet e tyre të brendshme – Burimi: Anketa me rrjete)

Rrjetet e intervistuar të OShC-ve kanë qenë më pak pozitive për kapacitetet e anëtarëve të tyre, gjegjësisht të OShC-ve. Gjashtëdhjetë për qind mendojnë se OShC-të anëtare të tyre kanë kapacitete të ulëta për gjetjen e donatorëve, ndërsa 40% mendojnë se organizatat anëtare të tyre kanë kapacitete të ulëta për hartimin e propozimeve të projekteve. Zbatimi i projekteve dhe menaxhimi financiar i projekteve duket të jetë më pak problematik: të gjitha e rrjetet e intervistuar të OShC-ve deklaruan se anëtarët e tyre kanë kapacitete mesatare për menaxhim financiar të projekteve dhe 60% mendojnë se kapaciteti i organizatave të tyre anëtare për zbatimin e projekteve është i nivelit mesatar.

Diskutimi në GF me OShC-të më të vogla dhe organizatat përkrahëse vendore zbuloi disa çështje interesante lidhur me kapacitetet e punonjësve të OShC-ve. E para është se ekzistonte një bindje e përhapur se numri i individëve mirë të përgatitur për nevojat e OShC-ve është i vogël dhe se punësimi i profesionistëve është një sfidë e madhe. Sipas OShC-ve pjesëmarrësve - në veçanti ato të voglat – janë shumë më kërkuese gjatë punësimit e stafit të nivelit më të lartë, ku kjo është edhe kërkesë e donatorëve. Megjithatë, problemet paraqiten me punësimin e stafit të nivelit mesatar ose të ulët, ku këta punëtorë shpesh nuk kanë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për kryerjen e detyrave të parapara. Kur fitojnë më shumë përvojë, ata lehtë tërhiqen nga OShC-të e tjera dhe “migrojnë” tek to. OShC-të e vogla gjithashtu kanë hezitime për të kërkuar paga më të larta për punëtorët e tyre për shkak të rrezikut të mosfinancimit nga donatorët. Duke bërë këtë, punëtorët e tyre të paktë në numër shpesh përfundojnë duke punuar njëkohësisht në shumë projekte, duke dëmtuar kështu cilësinë e punës dhe duke ulur performancën e organizatës. Gjithashtu, pjesëmarrësit e GF theksuan kërkesën e dyfishtë për një profesionist të suksesshëm në sektorin e shoqërisë civile – një kandidat ideal duhet të ketë si ekspertizë tematike, ashtu edhe përvojë në menaxhim. Duke pasur parasysh se shumicës së ekspertëve tematikë ju mungon përvoja në menaxhim dhe e anasjelltas, numri i individëve me të dyja këto cilësi është i kufizuar, ndërsa ata që i kanë të dyja janë shumë të vështirë për t’u tërhequr. E fundit por jo më pak e rëndësishme, pjesëmarrësit e GF


ngritën një problem mjaft të zakonshëm brenda sektorit të shoqërisë civile, e që është angazhimi i konsulentëve të jashtëm për shkrim të projekt propozimeve të veçanta. Kjo u pa si problematike në dy aspekte: 1) shpesh herë projekt propozimet e shkruara nga konsulentën e jashtëm janë shumë të ngjashëm nga njëra organizatë në tjetrën, duke bërë që të qarkullojnë në tregun e shumicës së donatorëve të shoqërisë civile; 2) për shkak që shumë konsulentë të jashtëm nuk i njohin si duhet kapacitetet e OShC-ve respektive, projekt propozimet e suksesshme priren të kenë vështirësi gjatë zbatimit, ndërsa në anën tjetër stafi i OShC-ve nuk është plotësisht i njohur me aktivitetet e planifikuara të projektit.

Mendime të ngjashme janë ndarë gjithashtu në GF-të me agjencitë donatore. Duke pranuar faktin e numrit të pakët të profesionistëve në përgjithësi, ato gjithashtu diskutuan për nevojën që punonjësit e OShC-ve ta konsiderojnë rolin e tyre si një rol që shkon përtej një pune të thjeshtë. Disa prej tyre deklaruan se për shumë fusha të veprimit të OShC-ve (p.sh. të drejtat e njeriut), punonjësit e tyre duhet të besojnë në misionin e organizatës dhe jo vetëm të jenë ekspert të një fushe të caktuar. Sipas tyre, derisa kemi shumë aktivistë të shoqërisë civile që janë qytetarë shembullorë, ka raste të tjera ku të punësuarit në OShC kanë mendime të kundërta nga ato të mishëruara në misionin e organizatës.

Infrastruktura përkrahëse për shoqërinë civile


Me përjashtim të ekspertizës specifike tematike, e cila mund të fitohet përmes shkollimit formal, shumica e aftësive të nevojshme për sektorin e shoqërisë civile nuk janë pjesë e ndonjë planprogrami formal. Këto aftësi në Kosovë kryesisht mund të fitohen përmes shkollimit joformal të ofruar nga vet OShC-të ose përmes përvojës së punës në sektorin e OShC-ve apo në organizata ndërkombëtare.

Sipas Anketës me OShC, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kanë përkrahje mesatare në kuptim të organizatave përkrahëse OShC-të në fushën e ngritjes së përgjithshme të kapaciteteve dhe të trajnimeve për menaxhimin e organizatës. Disponueshmëria e organizatave përkrahëse dhe trajnimeve relevante duket të jetë pjesa më pozitive, edhe pse rreth një e treta e OShC-ve të anketuara konsiderojnë se ka shumë pak organizata dhe trajnime të tilla. Më e kufizuar duket të jetë disponueshmëria e trajnimeve specifike për fushëveprimet përkatëse të OShC-ve, si dhe këshillat ligjore e praktike si në fushëveprimin përkatës OShC-ve, ashtu edhe në funksionimin e përgjithshëm të tyre.




(Fig.22: Vlerësimi i OShC-ve për disponueshmërinë e organizatave/shërbimeve përkrahëse për OShC-të – Burimi: Anketa me OShC)

Donatorët e huaj kanë një vlerësim më pak pozitiv lidhur me mjaftueshmërinë e organizatave përkrahëse për ngritjen e përgjithshme të kapaciteteve dhe për këshillat ligjore e praktike. Pothuajse 44% e të anketuarve nga radhët e donatorëve deklaruan për anketë se trajnimet specifike në dispozicion lidhur me fushëveprimin e OShC-ve janë të pakta, dhe 38% mendojnë se ka shumë pak organizata përkrahëse për ngritje të përgjithshme të kapaciteteve të OShC-ve. Një e katërta deklaruan se trajnimet relevante në dispozicion për menaxhmentin e OShC-ve janë të pamjaftueshme e po ashtu janë të pamjaftueshme këshillat ligjore e praktike për çështjet lidhur me funksionimin e organizatave. Mbi një e treta e agjencive donatore nuk kanë qenë të informuara për këshillat ligjore e praktike në dispozicion për OShC-të lidhur me çështjet specifike nga fushëveprimi i tyre.



(Fig.23: Vlerësimi i donatorëve të huaj për disponueshmërinë e organizatave/shërbimeve përkrahëse për OShC-të – Burimi: Anketa me donatorë)

Rrjetet e OShC-ve ishin më pak pozitive sesa agjencitë e donatorëve lidhur me këshillat ligjore e praktike në dispozicion për OShC-të, por më shumë pozitive për organizatat përkrahëse për ngritjen e përgjithshme të kapaciteteve dhe për trajnimet për menaxhim të organizatave.




(Fig.24: Vlerësimi i rrjeteve të OShC-ve për disponueshmërinë e organizatave/shërbimeve përkrahëse për OShC-të – Burimi: Anketa me rrjete)

Rrjetëzimi dhe komunikimi

Duke pasur parasysh misionet e ngjashme të OShC-ve, rrjetëzimi dhe komunikimi në mes tyre është element shumë i rëndësishëm në maksimalizimin e përpjekjeve individuale përmes punës së përbashkët. Në Kosovë ekzistojnë një numër rrjetesh që janë aktive tanimë me vite të tëra, ndërsa shumë OShC të Kosovës janë edhe anëtare të rrjeteve rajonale dhe ndërkombëtare. Disa nga to janë sektoriale (siç është Rrjeti i Grave të Kosovës, Forumi Kulturor ose Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF), të tjerat kanë të bëjnë me proceset specifike (siç është Demokracia në Veprim që është aktive në monitorimin zgjedhjeve në Kosovë), ndërsa Platforma CiviKos është rrjet i vetëm i përgjithshëm me mision për të strukturuar bashkëpunimin e shoqërisë civile me institucionet publike.

Megjithatë, jo të gjitha OShC-të janë anëtare të ndonjë rrjeti. Tridhjetë e tetë për qind e OShC-ve të intervistuar deklaruan se nuk janë anëtare të asnjë rrjeti, grupi ombrellë apo federate të organizatave; një e katërta thanë se janë anëtare të një rrjeti, grupi ombrellë apo federate, ndërsa 12% deklaruan se janë anëtare të më shumë se katër rrjeteve, grupeve ombrellë apo federatave të organizatave.



(Fig.25: Rrjetëzimi i OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)

Të dhënat e anketës tregojnë se gjatë vitit 2015 ndërveprimi mes anëtarëve të rrjeteve të OShC-ve për diskutimin e çështjeve brenda fushëveprimit të rrjetit ka qenë mjaft intensiv. Vetëm 16% e OShC-ve që iu përkisnin rrjeteve më të mëdha të organizatave deklaruan se fare nuk ishin takuar gjatë vitit 2015 për qëllimet e lartpërmendura; 34% thanë se janë takuar deri në tri herë, 18% mes katër dhe gjashtë herë dhe 31% më shumë se gjashtë herë.

Derisa përvoja me pjesëmarrjen dhe regjistrimin në rrjete është kryesisht pozitive, një e gjetur që ia vlen të theksohet, e cila vërteton se shumë pak organizata ndërveprojnë me OShC-të e huaja që kanë fushëveprimtarinë e njejtë, është se mbi gjysma e OShC-ve (51%) nuk kanë përvojë me regjistrim dhe/ose me pjesëmarrje në rrjete të organizatave ndërkombëtare në fushëveprimin e tyre.

Duke pasur parasysh se rrjetëzimi formal është vetëm njëra nga mënyrat e punës së përbashkët, në studim gjithashtu është analizuar niveli i ndërveprimit dhe komunikimit mes OShC-ve në Kosovë dhe jashtë saj. Njohuria e organizatave të shoqërisë civile për homologet e tyre në fushën e tyre të aktiviteteve, posaçërisht për atë jashtë Kosovës, duket të jetë mjaft e kufizuar. Trembëdhjetë për qind e tyre raportojnë se nuk njohin asnjë organizatë në Kosovë që vepron në fushën e aktiviteteve të tyre apo në atë të ngjashme me të, ndërsa 40% deklaruan se nuk e njohin asnjë organizatë jashtë Kosovës që vepron në të njëjtën fushë apo aktivitet.

Ndërveprimi mes organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në të njëjtën fushë brenda Kosovës gjithashtu është mjaft i kufizuar; 33% e OShC-ve deklaruan se nuk kanë pasur asnjë takim apo nuk kanë shkëmbyer asnjë informatë (p.sh.: dokumente, raporte, të dhëna, etj.) me ndonjë nga OShC-të në fushën e tyre të aktiviteteve gjatë tre muajve të fundit. Ndërveprimi me OShC-të jashtë Kosovës është madje edhe më i vogël: 57% e OShC-ve deklaruan se nuk kanë pasur asnjë takim apo nuk kanë këmbyer informata (p.sh.: dokumente, raporte, të dhëna, etj.) me ndonjë organizatë në fushën e njejtë të aktiviteteve jashtë Kosovës gjatë tre muajve të kaluar.

Në mesin e OShC-ve që kanë deklaruar se nuk komunikojnë me organizata të tjera në fushën e tyre të aktiviteteve dhe se nuk janë pjesë e ndonjë rrjeti, shumica janë organizata humanitare, të cilat pasohen nga ato që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe disa që përfaqësojnë interesa shumë specifike.




Angazhimi i qytetarëve

Anëtarësimi i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile mbetet i ulët dhe është pjesë e një apatie më të gjerë ndaj jetës qytetare në Kosovë. Me pak përjashtime, shumë OShC kanë shumë pak anëtarë, përkundër që shumica prej tyre janë të regjistruara si shoqata. Përkrahje më e madhe vërehet për çështjet dhe kauzat e veçanta në të cilat është angazhuar shoqëria civile, ndërsa më shumë se gjysma e qytetarëve kanë besim në shoqërinë civile dhe besojnë që sektori është duke bërë punë të mirë. Trendet e ulëta të vullnetarizmit mbesin të pandryshuara dhe ndër arsyt kryesore për këtë është ambienti jo i favorshëm për vullnetarizëm. Megjithatë, shoqëria civile në përgjithësi ka më shumë vullnetarë sesa të punësuar.

Aktivizmi qytetar


Aktivizmi qytetar mund të shprehet në forma të ndryshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në angazhimin në shoqëri civile. Qytetarëve u është parashtruar pyetja nëse kanë marrë pjesë në projekte qeveritare (komunale apo qendrore), parti politike, projekte të OShC-ve, nisma qytetare, diskutimeve publike, etj. Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, aktivizmi qytetar i kosovarëve është mjaft i ulët. Edhe në rastet kur marrin pjesë në forume apo iniciativa të ndryshme, ajo pjesëmarrje është më shumë pasive. Partitë politike kanë një përqindje pak më të lartë të pjesëmarrësve joaktivë krahasuar me shoqërinë civile dhe nismat qytetare, ndërsa përqindja e pjesëmarrësve aktivë është shumë e ngjashme.



(Fig.26: Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete publike – Burimi: Puls i publik i UNDP-së)

Lidhur me anëtarësinë në shoqërinë civile, trendi ku shoqëria civile është në distancë me qytetarët vazhdon. Me disa përjashtime, një pjesë e madhe e OShC-ve kanë shumë pak anëtarë, përkundër faktit se shumica e tyre janë të regjistruara si shoqata. Derisa anëtarësia dhe bashkimi në shoqatë nuk është i vetmi burim i legjitimitetit për shoqërinë civile, OShC-të në Kosovë ende kanë nevojë të fuqizojnë komunikimin dhe të rrisin përfshirjen e qytetarëve në punën e tyre.

Përderisa vetëm 2.9% të qytetarëve deklarojnë se janë anëtarë të së paku një OShC-je, megjithatë shohim një rritje të vogël krahasuar me vitin 2011, kur vetëm 2% e qytetarëve deklaruan se janë anëtarë të ndonjë OShC-je. Gjithashtu, pak respondentë deklaruan që kanë përfituar nga ndonjë shërbim i ofruar nga shoqëria civile (3.4%) dhe që kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet të organizuar nga shoqëria civile (4.8%). Vlera dukshëm më të larta paraqiten lidhur me përkrahjen e aktiviteteve ose kauzave të shoqërisë civile, ku 21.4% të qytetarëve kanë deklaruar se kanë përkrahur një kauzë (peticion, protestë, etj.) të ngritur nga shoqëria civile. Në anën tjetër, më shumë se gjysma e qytetarëve kanë besim në sektorin dhe besojnë që në përgjithësi shoqëria civile po bën një punë të mirë. Trendi për të gjitha këto kategori është stabil, me një rritje të vogël tek të gjithat, përveç për pjesëmarrjen në aktivitete të organizuara nga shoqëria civile.



(Fig.27: Angazhimi i qytetarëve në shoqërinë civile në vitet 2013 dhe 2016 – Burimi: Puls i publik i UNDP-së)

Mungesa e aktivizimit mund të jetë rezultat i shumë faktorëve, duke përfshirë përkeqësimin e gjendjes politike dhe rënien e besimit se diçka mund të ndryshohet përmes aktivizimit.⁴¹ Kjo e fundit gjithashtu është vërtetuar edhe nga diskutimet në GF, ku qytetarët ceknin një numër nismash në lagjen apo universitetin e tyre, të cilat dështuan për shkak të mungesës së plotë të reagimit nga autoritetet kompetente. Pas dy apo tri nismave të pasuksesshme, qytetarët humbin shpresën se ia vlen të angazhohesh për një kauzë të përbashkët.

Gjithashtu është e qartë se sistemi edukativo-arsimor ka një rol të veçantë në krijimin e qytetarisë aktive, ndërsa sistemi edukativo-arsimor i Kosovës ka mbetur mbrapa në këtë drejtim. Përderisa edukatën qytetare mësohet në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, aktivizmi qytetar, të menduarit kritik dhe angazhimi i komunitetit nuk janë gjëra që zakonisht mësohen në shkollat e Kosovës. Kjo dëshmohet edhe nga Anketa me OShC, ku vërehet se të pakta janë ato OShC që besojnë se sistemi arsimor i kontribuon avancimit të aktivizmit qytetar. Përderisa 38% të OShC-ve të anketuara besojnë që lënda e Edukatës Qytetare e promovon mjaftueshëm angazhimin qytetar, pjesa tjetër ka mendim negativ (30%) ose nuk ka fare mendim për këtë (29%).

Për më tepër, gjatë diskutimeve në GF doli në pah se qytetarët e rëndomtë nuk janë në dijeni se ekzistojnë OShC që merren me çështje të caktuara të interesit të tyre. Kjo vjen si rrjedhojë si e mungesës së interesit nga ana e qytetarëve, ashtu edhe nga mungesa e komunikimit nga ana e OShC-ve. Pjesëmarrësit e GF-ve theksuan rolin e mediave në avancimin e nismave të komunitetit dhe aktiviteteve të shoqërisë civile. Qytetarët ishin të pakënaqur me mediat, të cilat sipas tyre ngarendin pas çështjeve politike dhe lajmeve sensacionale dhe jo pas çështjeve që janë brenga kryesore të qytetarëve. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është se standardi i ulët ekonomik dhe varfëria e lartë janë përmendur të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në mungesën e motivimit për aktivizëm qytetar. Duke pasur parasysh se shumë njerëz ballafaqohen me vështirësi ekonomike, angazhimi qytetar zë vend të ulët në listën e tyre të prioriteteve.


41 Besnik Pula. "Hendeku i Shpresës." Sbunker. 2016. Qasur më 23 gusht 2016. <http://sbunker.net/teh/88052/hendeku-i-shpreses/>.

Vullnetarizmi

Vlerësimi i nivelit të vullnetarizmit në Kosovë, duke përfshirë vullnetarizmin në shoqërinë civile, është shumë i vështirë. Nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për numrin e vullnetarëve, numrin e orëve të punës vullnetare, llojet e punës vullnetare apo demografinë së vullnetarëve. Megjithatë, disa informata për vullnetarizëm janë grumbulluar për Indeksin e Shoqërisë Civile përmes Anketës së Pulsit Publik të UNDP-së, si dhe përmes Anketës me OShC nëpërmjet pyetjes drejtuar OShC-ve nëse kanë angazhuar vullnetarë gjatë vitit të caktuar, sa ka qenë numri i tyre, cili ka qenë lloji i angazhimit, cilat janë perceptimet e tyre për dinamikat e vullnetarizmit dhe ambientin për vullnetarizëm në Kosovë.

Përhapja e vullnetarizmit në Kosovë në përgjithësi mbetet e ulët, edhe pse ka pasur një rritje të vogël që nga viti 2014. Sipas Anketës së Pulsit Publik të UNDP-së të publikuar në nëntor 2015, 3.8% e qytetarëve të Kosovës deklarojnë se kanë bërë ndonjë punë vullnetare për ndonjë organizatë të shoqërisë civile. Nivelet e punës vullnetare për OShC-të kanë qenë pak më të vogla në vitin 2013 (3.1%), ndërsa më të larta në vitin 2011 (4.5%).⁴²

Përkundër punës në një mjedis ku puna vullnetare nuk është e rregulluar e as nuk promovohet, OShC-të e Kosovës ende angazhojnë shumë më shumë vullnetarë se sa punëtorë me paga. Ky është një trend që disa vite me radhë, pasi që rezultatet e ngjashme janë konstatuar edhe në raportet e mëhershme të Indeksit të Shoqërisë Civile.⁴³ Numri i vullnetarëve është më i lartë se sa i punëtorëve me pagë, edhe kur nuk llogarisim tre OShC-të të cilat kanë deklaruar se kanë angazhuar me qindra vullnetarë. Me përfshirjen e këtyre tre organizatave me vlera të skajshme,⁴⁴ numri i vullnetarëve duket të jetë më shumë se katër herë më i lartë krahasuar me numrin e punëtorëve të paguar.




(Fig.28: Numri i vullnetarëve krahasuar me numrin e punëtorëve me paga në OShC-të e anketura, gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

42 Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, 2014.40

43 Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, 2011f.42

44 Vlera të skajshme është vrojtim që paraqet një distancë jonormale nga vlerat e tjera në mostrën e rëndomtë të popullatës. Në këtë rast, brenda vlerave të skajshme janë konsideruar të gjitha ato OShC që kanë deklaruar se kanë angazhuar më shumë se 100 vullnetarë gjatë vitit 2015.

Trendi i vullnetarizmit për OShC mbetet i pandryshuar. Me rastin e parashtrimit të pyetjes për dinamikën e punës vullnetare në Kosovë gjatë vitit të kaluar, pothuajse gjysma e OShC-ve të anketuara (46%) mendojnë se ajo nuk ka ndryshuar, ndërsa vlerësimet e kundërta për zgjerimin dhe tkurrjen e vullnetarizmit pothuajse janë të barabarta me njëra-tjetrën - 26% kanë deklaruar se puna vullnetare është zgjeruar gjatë vitit të kaluar, ndërsa 20% vlerësuan se është tkurrur. Prej atyre që mendojnë se vullnetarizmi është zgjeruar gjatë vitit të kaluar, më shumë se një e katërta ia atribuojnë atë rritjes së vetëdijesimit për punën vullnetare, ndërsa një përqindje shumë e ngjashme besojnë se është rezultat i përfitimeve jomonetare për vullnetarët (p.sh. fitimi i përvojës nga puna vullnetare), mungesës së punës që paguhet në Kosovë dhe i reputacionit të mirë të shoqërisë civile. Nga ana tjetër, 17% e OShC-ve deklaruan se vullnetarizmi është zgjeruar gjatë vitit të kaluar për shkak të dëshirës së individëve ta përkrahin punën e suksesshme të institucioneve përgjegjëse për fushat e caktuara apo për ndryshime pozitive. Në anën tjetër, pothuajse një e treta e OShC-ve që konsiderojnë vullnetarizmin se po tkurret kanë deklaruar se gjendja e dobët ekonomike në Kosovë është arsyeja kryesore e rënies së nivelit të punës vullnetare gjatë vitit 2015; 24% thanë se kjo ndodh për shkak të mungesës së vetëdijesimit për vullnetarizëm, 21% për shkak të zhgënjimit me punën e institucioneve në fushat e caktuara, 20% për shkak të mungesës së përfitimeve jomonetare për vullnetarët dhe vetëm 7% për shkak të reputacionit të dobët të shoqërisë civile.



(Fig.29: Perceptimet e OShC-ve për trendët e vullnetarizmit në shoqërinë civile gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Anketa me OShC tregon se organizatat e shoqërisë civile janë skeptike për politikën e vullnetarizmit dhe kornizën juridike relevante, pasi që vetëm një e treta e konsiderojnë si të favorshme (7%) ose disi të favorshme (30%). Pjesa tjetër e konsideron si aspak inkurajuese (31%) ose mendojnë se nuk ka kornizë ligjore apo të politikave për vullnetarizmin (14%), derisa një pjesë e konsiderueshme e OShC-ve të anketuara deklaroi se nuk janë të njoftuara për këtë (18%). Në mesin e OShC-ve të anketuara, ato që nuk kanë vullnetarë janë më skeptiket krahasuar me ato që gjatë vitit 2015 kishin angazhuar vullnetarë.

Në realitet, rezultatet e anketës janë në përputhje me gjendjen aktuale në kornizën ligjore dhe të politikave. Për disa vite me radhë nuk ka zhvillime në kornizën ligjore për vullnetarizëm. I vetmi ligj që përmban ndonjë dispozitë për vullnetarizmin mbetet Ligji 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, që ka për qëllim stimulimin e vullnetarizmit tek të rinjtë. Asnjë ligj ose rregullore tjetër nuk trajton vullnetarizmin e kategorive të tjera. Regjistrimi i vullnetarëve të rinj është obligues, njëjtë siç janë edhe obligimet për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale dhe mbrojtja e vullnetarizmit të organizuar për të rinjtë. Megjithatë, procedurat administrative për organizatat nikoqire të vullnetarëve të rinj janë të ndërlikuara dhe të ngarkuara. Një nga katër objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 ka të bëjë me vullnetarizmin, por që nga miratimi i saj nuk ka pasur ndonjë zhvillim domethënës.

Rrjedhimisht, edhe pse realizohet në shumë forma dhe është i pranishëm në shumë OShC, vullnetarizmi në masë të madhe mbetet joformal. Sistemi i regjistrimit të vullnetarëve të rinj, i cili është i vetmi sistem i paraparë me Ligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, gjatë vitit 2015 nuk ka funksionuar, me përjashtim të disa komunave që kanë sistem funksional për regjistrimin e vullnetarëve të rinj.⁴⁵ Anketa me OShC tregon se rreth 60% e OShC-ve të anketuara deklarojnë se gjatë vitit 2015 kanë angazhuar vullnetarë në organizatën e tyre. Më tepër se një e treta e OShC-ve që kanë angazhuar vullnetarë gjatë vitit 2015 (37%) thanë se i kanë angazhuar formalisht përmes kontratave me shkrim. Pjesa tjetër kanë angazhuar vullnetarë në mënyrë joformale: 25% përmes marrëveshjeve gojore, ndërsa një e treta tjetër (32%) i konsideruan kontratat si të panevojshme për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të angazhimit. Pjesa tjetër prej 5% e OShC-ve deklaruan se nuk kanë angazhuar vullnetarë formalisht për shkak se ligji nuk obligon për një gjë të tillë.

Një situatë e ngjashme gjithashtu është e pranishme përkitazi me programet e vullnetarizmit të organizuara nga institucionet shtetërore, ku asnjë program i tillë nuk është identifikuar gjatë vitit 2015. Vetëm 10% e organizatave të intervistuar deklaruan për Anketën me OShC se janë në dijeni për programet shtetërore përmes të cilave përkrahet angazhimi i vullnetarëve. Megjithatë, kur u kërkua që t'i cekin ato programe, ata të anketuar iu referuan Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Iniciativës për Zhvillim të Bujqësisë në Kosovë (IADK) ose Këshillit Lokal për Veprim Rinor (KLVR) – ku këto dy të fundit janë OShC e jo institucione shtetërore.

⁴⁵ Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016. 32.




Financimi

Financimi për sektorin mbetet stabil. Dy të tretat e sektorit operojnë me më pak se 10,000 euro në vit, ku gjysma e këtij grupi nuk kanë fare fonde. Donatorët e huaj japin pjesën më të madhe të financimit të sektorit, edhe pse pjesa e OShC-ve që marrin fonde të huaja është zvogëluar. Për shkak të financimit afat-shkurtër, shumica e sektorit nuk është në gjendje të planifikojë mbi një vit. Nëpërmjet konsultimit nga organizatat donatore, disa OShC mund t'i ndikojnë prioritetet e financimit të donatorëve të huaj. Vetëm një pjesë e vogël e sektorit ka pasur sukses të ketë qasje në fondet e BE-së, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve për të aplikuar dhe zbatuar projektet e financuara nga BE. OShC-të e vogla, sidomos ato që veprojnë në nivel lokal, kryesisht janë të varura nga fondet publike, e të cilat nuk janë të rregulluara me ndonjë kriter ose procedurë. Pak OShC mund të marrin kontrata shtetërore për shërbime publike, ndërsa donacionet private janë të ulëta si në kuptim të shpeshtësisë ashtu edhe të shumave.

Qarkullimi vjetor

Siç u theksua edhe më lart, mungesa e të dhënave financiare zyrtare për sektorin e shoqërisë civile në Kosovë gjithashtu përfshin edhe aspektin e qarkullimit vjetor të OShC-ve dhe trendët e tjerë të financimit të sektorit. I vetmi burim i informatave ka qenë Anketa me OShC e realizuar periodikisht për Indeksin e Shoqërisë Civile. Gjatë këtij viti, përveç anketës së OShC-ve, Indeksi i Shoqërisë Civile ka pasur qasje për herë të parë në të dhënat nga ATK për ato OShC që ia kanë dorëzuar raportet vjetore këtij institucioni. Të dyja këto burime japin të dhëna shumë të ngjashme dhe konfirmuan se shumica e OShC-ve në Kosovë veprojnë me më pak se 10,000 euro në vit, ku një pjesë e tyre madje fare nuk kanë fonde.

Gjatë vitit 2015, rreth 60% e OShC-ve të anketuara deklaruan se të qarkullimi vjetor i tyre ka qenë më pak se 10,000 euro (me gjysmën e këtij grupi që nuk ka pasur fare fonde gjatë vitit 2015); 11% të tyre kishin qarkullim vjetor prej 10,000 - 25,000 euro, ndërsa gati 15% mes 100,000 – 500,000 euro. Rreth 5% e OShC-ve të anketuara kanë pasur qarkullim vjetor prej më shumë se 500,000 euro. Rezultatet e ngjashme shihen edhe në deklaratat vjetore të OShC-ve të dorëzuara në ATK.⁴⁶




(Fig.30: Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2015 – Burimi: Anketa e OShC-ve dhe ATK)

Anketa tregon se trendët e financimit në vitin 2015 krahasuar me ata të vitit 2014 në përgjithësi janë të njëjtë, përkundër një rënie të vogël. Me pothuajse gjysmën e OShC-ve që deklaruan se të hyrat e tyre nuk kishin ndryshuar në krahasim me vitin 2014, prapë një pjesë e madhe e tyre (30%) deklaruan rënie të të hyrave në krahasim me ato që deklaruan rritje (23%). Agjencitë donatore gjithashtu konfirmojnë se trendët e financimit janë kryesisht të ngjashëm me ata të dy viteve të fundit; rreth një e katërta e tyre deklarojnë se më shumë fonde i janë vënë në dispozicion sektorit në vitin 2015 se sa në vitin 2014, dhe se një rritje e ngjashme pritet të ndodh edhe në vitin 2016.

⁴⁶ Të dhënat zyrtare nga Administrata Tatimore e Kosovës. 6 korrik 2016. Të dhëna të papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.

Nga ana tjetër, anketa tregon se shpenzimet gjatë vitit 2015 janë rritur, gjë që sygjeron se një pjesë e fondeve e operuar dhe shpenzuar nga OShC-të në vitin 2015 janë pranuar në vitin ose vitet paraqake.



(Fig.31: Trendi i të hyrave dhe shpenzimeve të OShC-ve në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 – Burimi: Anketa me OShC)

Mbizotërimi i OShC-ve që veprojnë me pak fonde apo fare pa to gjithashtu vërtetohet edhe përmes të dhënave që tregojnë se vetëm 37% e OShC-ve të anketuara ia kanë dalë të sigurojnë fonde të mjaftueshme për vazhdimësinë e aktiviteteve gjatë vitit 2015. Numri i OShC-ve që nuk kanë realizuar ndonjë projekt në vitin 2015 është shumë i madh (40%), ndërsa pjesa e mbetur e OShC-ve kanë zbatuar numër të vogël të projekteve: 13% realizuan nga një apo dy projekte dhe 9% zbatuan tri projekte.


Nga OShC-të e anketuara që nuk kanë realizuar ndonjë projekt të ri apo që kanë zbatuar vetëm një projekt gjatë vitit 2015, pjesa më e madhe merren me fushat që nuk financohen nga asnjë donator specifik, siç është bota bimore dhe shtazore, përkrahja shoqërore dhe psikologjike apo organizatat studentore, ndërsa shumica e tyre janë aktive vetëm në nivel lokal. Megjithatë, derisa gati gjysma e tyre nuk kanë staf, gjatë vitit 2015 më shumë se 70% e këtyre organizatave kanë angazhuar vullnetarë.

Burimet e financimit

Pa të dhëna gjithëpërfshirëse qoftë prej institucioneve apo prej donatorëve të jashtëm, vlerësimi i burimeve të financimit mbetet sfidë. Për shumë vite me radhë, Indeksi i Shoqërisë Civile ka pyetur OShC-të për burimet e tyre të financimit në bazë të kategorive specifike të financimit. Botimet paraqake të Indeksit të Shoqërisë Civile kanë vërtetuar se shoqëria civile në Kosovë mbetet e varur nga donatorët e jashtëm, me më shumë se 70% të fondeve që vinë nga jashtë Kosovës. Në vitin 2015, donatorët e jashtëm ende ishin në majë të listës së burimeve të financimit, edhe pse me

një rënie të dukshme, e cila shoqërohet me një rritje të vogël të fondeve shtetërore, posaçërisht të atyre prej institucioneve qendrore. Burimet e tjera të financimit mbesin në përgjithësi të ulëta, edhe pse donacionet individuale dhe pagesat e anëtarësisë kanë shënuar rritje.

Përveç ndryshimit të dinamikës së financimit gjatë disa viteve të kaluara, këto ndryshime kanë gjithashtu edhe një shpjegim metodologjik. Derisa mostrat e mëparshme kanë përfshirë vetëm ato OShC që kanë pasur nivel të caktuar të aktivitetit (pjesëmarrje në takime, përgjigje në e-mail-a, etj.), mostra Anketës me OShC për këtë edicion të Indeksit të Shoqërisë Civile është përzgjedhur me metodë të rastësishme nga Regjistri Publik i OJQ-ve, që do të thotë se janë përfshirë më shumë OJQ me më pak financim dhe aktivitete. Siç është treguar në studimet paraprake, sa më e vogël OShC-ja sa i përket financimit, funksion me më pak fonde të huaja.⁴⁷ E dyta, pasi që burimet e financimit nuk ndërlidhen me shumën e fondeve të zbatuara nga OShC-ja, në llogaritjet e përgjithshme peshë e njëjtë i jepet si OShC-ve të vogla, ashtu edhe atyre të mëdha. Pra, nëse një OShC që punon me 2000 euro në vit finanohet 100% nga donacionet individuale, ka të njëjtën peshë si një OShC që punon me 100.000 euro në vit që finanohet 100% nga fondet e huaja. Dhe e fundit, përkundër faktit se pagesa për anëtarësi dhe donacionet individuale zakonisht janë në shuma të vogla, për OShC-të më të vogla ato mund të përbëjnë përqindje domethënëse të fondeve të tyre. Me më shumë OShC të vogla pjesë të Anketës me OShC, të dyja këto burime të financimit janë më të larta se në studimet e kaluara.




(Fig.32: Burimet e financimit të sektorit të shoqërisë civile – Burimi: Anketa me OShC)

Megjithatë, kur llogariten vlerat reale të fondeve të deklaruara nga çdo OShC e anketuar dhe kur krahasohen me burimet e financimit, të dhënat tregojnë që fondet e huaja përbëjnë gati 99% të gjithëj fondeve për shoqërinë civile në Kosovë. Me fjalë të tjera, për çdo 100 euro të pranuar nga shoqëria civile, 99 euro vinë nga burimet e huaja. Kjo nuk është befasi pasi që shumata e të gjitha llojeve të tjera të financimit janë shumë më të vogla se sa shumata e dhëna nga donatorët e

47 Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, 2014.26

ndërkombëtarë. Shumë projekte të financuara nga institucionet publike sillen prej disa qindra deri në disa mijë euro, ndërsa pagesat për anëtarësi dhe donacionet individuale janë edhe më të vogla. Nga ana tjetër, grantet e donatorëve ndërkombëtarë zakonisht arrijnë me dhjetëra mijëra euro, por edhe me qindra mijëra euro për nismat e gjata dhe të shkallës së gjerë.

Kur analizohet shpërndarja e fondeve bazuar në burimet e financimit, përkundër që janë burimi kryesor i financimit për shoqërinë civile, fondet e huaja u janë dhënë një pjesë më të vogël të OShC-ve. Anketa tregon se vetëm 38.6% e OShC-ve të anketuara kanë pranuar fonde të huaja gjatë vitit 2015. Sa u përket burimeve të tjera, rreth 15% të OShC-ve deklarojnë se kanë marrë fonde nga institucionet qendrore dhe lokale, dhe afro 9% se kanë marrë donacione nga individët privatë dhe bizneset. Gjatë vitit 2015, 31.7% të OShC-ve fare nuk kanë pasur fonde.




(Fig.33: OShC-të sipas burimeve të financimit – Burimi: Anketa me OShC)

Përderisa grafika e mësipërme tregon situatën e përgjithshme për shoqërinë civile në Kosovë, sipas diskutimeve në FG me OShC-të serbe që veprojnë në pjesën veriore të Kosovës, shumica e tyre raportojnë të jenë të përkrahura financiarisht nga donatorët e huaj.

Trendët e planifikimit dhe të financimit

OShC-të në Kosovë zakonisht planifikojnë për periudha të shkurtra kohore, dhe numri i OShC-ve që planifikojnë për një periudhë më të gjatë se 2-3 vite është shumë i vogël (5%). Periudha më e zakonshme e planifikimit është mes gjashtë dhe dymbëdhjetë muaj (60%), ndërsa një pjesë mjaftë e madhe e OShC-ve kanë madje periudhë edhe më të shkurtër të planifikimit.




(Fig.34: Kohëzgjatja e planifikimit të punës së OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)

Llojet e përkrahjes

Të dhënat e Anketës me OShC tregojnë që periudha e planifikimit është drejtpërdrejtë e lidhur me llojet e përkrahjes së pranuar nga OShC-të, pasi që grantet afatshkurtra vazhdojnë të jenë lloji më i zakonshëm i përkrahjes. Anketa me donatorë vërteton se lloji më i zakonshëm i përkrahjes për OShC-të nuk kalon periudhën 12-mujore. Llojet e tjera të përkrahjes janë më pak të zakonshme, edhe pse gjithashtu mund të vërehet një prani solide e granteve më afatgjata, ku rreth 40% e donatorëve kanë dhënë grante të tilla.


Anketa me OShC vërtetohet se grantet e projekteve janë model mbizotërues i financimit, me shumë më pak OShC që kanë deklaruar se kanë pranuar grante institucionale apo kontrata të shërbimeve. Thënë më konkretisht, 47% e OShC-ve të anketuara kanë marrë grante për projekte, nga 11% kanë marrë grante institucionale apo kontrata të shërbimeve, ndërsa 14% kanë pranuar përkrahje në formë të ndihmesës teknike.



(Fig.35: Lloji i përkrahjes së dhënë OShC-ve nga donatorët e huaj gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me donatorë)


Thirrjet e hapura për aplikim mbesin mekanizmi kryesor i marrjes së fondeve nga donatorët, edhe pse kërkesat ndaj donatorëve për financimin e projektit të caktuar gjithashtu duket të jenë mënyra mjaft të përhapura tek OShC-të. Dyzet e katër për qind e OShC-ve deklaruan se kanë marrë fonde nga donatorët përmes thirrjeve të hapura, ndërsa 30% thanë se ato gjithashtu kanë kërkuar fonde drejtpërdrejtë nga donatorët për financimin e projekteve të caktuara. Vetëm 20% e OShC-ve deklaruan se drejtpërdrejtë janë ftuar nga vet organizatat donatore që të aplikojnë për fonde të caktuara.

Anketa me donatorë gjithashtu tregon se thirrjet e hapura për aplikime mbesin mënyra më e zakonshme e dhënies së fondeve për OShC-të, megjithatë, gjysma e donatorëve gjithashtu kanë raportuar se kanë dhënë përkrahje për OShC-të, si përgjigje ndaj kërkesave të drejtpërdrejta të organizatave.



(Fig.36: Lloji i procedurave të aplikimit për fondet e huaja gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me donatorë)

Siç pritet nga një sektor pjesa më e madhe e të cilit vepron me shuma të vogla mjeteve financiare, shumica e OShC-ve i konsiderojnë procedurat e aplikimit si disi të vështira apo shumë të vështira në raport me shumën e financimit. Vetëm 8% e OShC-ve konsiderojnë procedurat për marrjen e fondeve në raport me shumën e financimit gjatë vitit 2015 si të lehta; 57% deklaruan se ato procedura ishin disi të vështira, ndërsa 33% thanë se janë shumë të vështira. Donatorët ndërkombëtarë nuk ndajnë pikëpamjen e njëjtë me OShC-të lidhur me vështirësinë e procedurave të tyre të aplikimit, pasi që gjysma e tyre i konsiderojnë procedurat e veta të aplikimit si të lehta. Megjithatë, disa donatorë konsiderojnë se procedurat e tyre të aplikimit janë disi të vështira dhe se mund të plotësohen vetëm nga një numër shumë i vogël i OShC-ve (19%), derisa një e katërta e donatorëve mendojnë se përkundër se procedurat e tyre të aplikimit janë të lehta, ato mund të përmbushen vetëm nga disa OShC në Kosovë.



(Fig.37: Vlerësimi i donatorëve lidhur me procedurat e aplikimit për fonde të huaja gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me donatorë)

Diskutimi në GF me OShC-të më të vogla shpërfaq një numër problemesh shtesë në aplikimin për fonde tek donatorët ndërkombëtarë dhe në marrjen e tyre. I pari, shumë pjesëmarrës pajtohen se shumica e donatorëve i orientojnë procedurat e tyre të aplikimit (madje edhe në mënyrë të paqëllimshme) vetëm për OShC-të më të mëdha dhe më të konsoliduara. Numri shumë i vogël i donatorëve që lejojnë aplikimin në gjuhët vendore është një dëshmi e kësaj. I dyti, për shkak të mungesës së përvojës me donatorët dhe terminologjinë, OShC-të më të vogla shpesh i huqin qëllimet e thirrjes për aplikim apo kërkesat specifike të donatorëve ndërkombëtarë. I treti, disa OShC që janë aktive në zonat lokale dhe rurale ankohen se OShC-të më të mëdha aplikojnë për aktivitete që gjithashtu i mbulojnë edhe fushat e tyre, por kur pranojnë grantet ato nuk i zbatojnë aktivitetet në terren apo këtë e bëjnë duke angazhuar OShC-të lokale. Dhe e fundit, me përjashtim të OShC-ve më të mëdha, shumë syresh varen nga një individ (zakonisht në një drejtor ekzekutiv), i cili është përgjegjës për çdo gjë në organizatë dhe nuk bart njohuritë tek pjesa tjetër e ekipit. Kur ai ose ajo shkon, pësojnë edhe kapacitetet dhe rrjetet e organizatës.

Nga ana tjetër, diskutimi në GF me përfaqësuesit e disa agjencive donatore jep pikëpamje të tjera. Pikësëpari, shumica e tyre mendojnë se aplikimet e OShC-ve janë të përsëritura dhe pa inovacion. Kjo mund të jetë si rezultat i periudhës kur financimet e donatorëve kanë qenë shumë të larta dhe kur OShC-të mund të merrnin fonde shumë lehtë. Me më pak donatorë dhe me fokus me specifik të strategjive të donatorëve, OShC-të duhet të përgjigjen me propozime më cilësore. Ekziston perceptimi se shumë prej tyre fare nuk i lexojnë strategjitë e donatorëve dhe udhëzimet për aplikim. Po ashtu, disa përfaqësues të donatorëve kanë përshtypjen se OShC-të janë më shumë të fokusuar të hamendësojnë se çka financojnë donatorët dhe jo se cilat janë nevojat e grupit të tyre të synuar dhe përfituesëve.

Programimi i fondeve të donatorëve


Si burim kryesor i financimit për shoqërinë civile në Kosovë, ndikimi i donatorëve të huaj në sektor natyrisht se është i lartë. Ky ndikim zakonisht shprehet përmes temave prioritare të financuara nga këta donatorë, të cilat më pas u barten OShC-ve përmes granteve dhe llojeve të tjera të përkrahjes. Për këtë arsye, Indeksi i Shoqërisë Civile gjithashtu hulumton modalitetet se si donatorët ndërkombëtarë i programojnë fondet e veta dhe nëse merren parasysh prioritetet dhe palët vendore gjatë këtij procesi.

Nga këndvështrimi i shoqërisë civile, me rastin e programimit të fondeve të tyre të ardhshme, duket se donatorët konsultohen vetëm me një pjesë e sektorit. Derisa 40% e OShC-ve deklaruan se kanë kërkuar të konsultohen nga organizatat donatore me rastin e fazës së programimit të fondeve të tyre, vetëm 29% e tyre deklaruan se janë ftuar për konsultime për këtë çështje gjatë vitit 2015. Nga këto, më shumë se gjysma (19 OShC) thanë se janë konsultuar me donatorët, me të cilët bashkëpunojnë rregullisht dhe me ata me të cilët zakonisht nuk bashkëpunojnë, ndërsa 4 raportuan se janë konsultuar nga donatorët, me të cilët nuk bashkëpunojnë. Me rastin e ftesës në konsultime, OShC-të mendojnë se këto konsultime janë me të vërtetë të frytshme, pasi që 53% e OShC-ve të konsultuara deklaruan se kontributet e tyre janë marrë parasysh deri në një masë, ndërsa 23% e tyre thanë se ato janë marrë plotësisht parasysh.

Diskutimet në GF me OShC-të serbe në pjesën veriore të Kosovës tregojnë se këto OShC nuk konsultohen lidhur me programimin e fondeve të donatorëve ndërkombëtarë. Ato pretendojnë se

donatorët rrallëherë apo fare nuk i konsultojnë për programimin e fondeve, kështu që ata besojnë se kanë ndikim të kufizuar në këtë drejtim. Në disa raste kur ka pasur konsultime, është cekur se ky proces ka qenë i parregullt dhe i mbyllur për pjesën më të madhe të OShC-ve. Një pjesëmarrës në diskutime të grupit të fokusit kishte thënë “*Ne shkojmë pas gjërave që na i ofrojnë dhe jo pas asaj që dëshirojmë ne*”.

Nga perspektiva e donatorëve, pak më shumë se gjysma e donatorëve të intervistuar deklaruan se nuk i ftojnë OShC-të që të marrin pjesë në proces të programimit të fondeve të tyre; 23.8% deklaruan se e bëjnë këtë sa herë që krijohet ose rishikohet një program apo skemë e re programore, ndërsa 33.3% thanë se këtë e bëjnë herë pas here. Në mesin e agjencive të donatorëve që i ftojnë OShC-të në konsultime, pjesa më e madhe (84.2%) deklaruan për anketë se zakonisht ftojnë një numër të kufizuar të OShC-ve me të cilat kanë bashkëpunim, ndërsa pjesa tjetër e tyre thanë se ky proces i konsultimit organizohet përmes një thirrjeje të hapur dhe se çdokush mund të marrë pjesë. Megjithatë, shumica e donatorëve (86%) deklarojnë se nuk pranojnë kërkesa nga OShC-të që të konsultohen për programimin e fondeve, dhe se iniciativa për konsultime vjen nga donatorët.



(Fig.38: Ftesa e OShC-ve nga donatorët e huaj për programimin e fondeve të tyre – Burimi: Anketa me donatorë)


Pjesa më e madhe e donatorëve (75%) deklarojnë se nëse OShC-të ftohen për konsultim, shumica e tyre përgjigjen pozitivisht. Shumica e donatorëve (67%) janë gjithashtu të kënaqur me nivelin dhe dobinë e komenteve të OShC-ve, ndërsa pjesa dërrmuese e tyre (92%) deklarojnë se komentet e OShC-ve merren parasysh deri në një masë të caktuar.

Një nga sfidat e rëndësishme që është cekur nga ana e përfaqësuesve të donatorëve në diskutimin e GF është fakti se shumica e donatorëve ndërkombëtarë punojnë me staf shumë të kufizuar në zyrat e tyre në Kosovë. Me vetëm një apo dy persona përgjegjës (të cilët merren edhe me çështje të tjera përveç shoqërisë civile), shpesh herë konsultimi me OShC-të lidhur me programimin e fondeve të tyre bëhet një sfidë e vërtetë. Derisa të gjitha deklarohen se janë të përkushtuara në përfshirjen e OShC-ve në programimin e fondeve të tyre, disa nga to gjithashtu theksojnë se vetëm ato OShC që mishërojnë vlerat e promovuara nga donatorët përkatës merren parasysh për këtë proces.

Ndikimi i donatorëve në punën e OShC-ve

Formalisht, pasi që përkrahja financiare jepet, donatorët nuk duhet të ndërhyjnë në punën e OShC-ve. Kjo veçanërisht është e rëndësishme për grantet e projekteve, të cilat janë edhe lloji kryesor i përkrahjes për OShC-të në Kosovë, dhe bazohen në propozimet e OShC-ve, të cilat janë vlerësuar pozitivisht dhe pranuar nga donatori. Shumica e OShC-ve në Kosovë duket që veprojnë pa ndërhyrje prej donatorëve. Një e gjetur e ngjashme raportohet edhe nga OShC-të serbe në pjesën veriore të Kosovës. Megjithatë, edhe pse të kufizuara, ekzistojnë rastet e ndërhyrjes së donatorëve, të cilët kërkojnë nga OShC-të të veprojnë ndryshe seç do të vepronin në rrethana të tjera.

Ndërhyrja më e zakonshme duket të jetë ndryshimi substancial i përmbajtjes së projektit të propozuar jashtë fushës së aktivitetit të OShC-së (25.9% e OShC-ve kanë pasur kësi lloj ndërhyrjeje) dhe ndryshimi i natyrës së aktiviteteve, për të cilat OShC-ja është financiar paraprakisht (22.5% e OShC-ve kanë kaluar nëpër këtë lloj ndërhyrjeje). Llojet e tjera të ndërhyrjes ndodhin rrallë, siç është kontraktimi i ekspertëve ose kompanive, të cilat OShC-ja nuk do t'i kontraktonte; bashkëpunimi (ose mosbashkëpunimi) me organizatat apo institucionet specifike; ftesat e pjesëmarrësve të caktuar në aktivitetet e OShC-së, etj.



(Fig.39: Ndërhyrja e donatorëve në punën e OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)


Një analizë më e thellë e të dhënave tregon se edhe pse jo të mëdha, prapëseprapë ka dallime në mesin e llojit të donatorëve dhe ndërhyrjes së tyre. Ato OShC që marrin fonde publike raportojnë ndërhyrje më të madhe krahasuar me ato që marrin fonde të huaja, me përjashtim të kërkesës për ndryshimin e përmbajtjes së propozimit jashtë fushës së aktivitetit, ku donatorët e huaj duket se ndërhyjnë më shumë. Nga ana tjetër, ato që marrin donacione private deklarojnë më pak ndërhyrje.

Fondet e BE-së

Edhe pse BE-ja hyn në grupin më të madh të donatorëve të huaj, për shkak të perspektivës evropiane të Kosovës dhe dominimit të pritur të fondeve të BE-së në të ardhmen, në këtë studim është hedhur një shikim më i afërt në fondet e BE-së për shoqërinë civile.

Numri i OShC-ve që kanë pranuar fonde të BE-së gjatë vitit 2015 është shumë i vogël, pasi që vetëm 17% e OShC-ve të anketuara deklaruan se kanë pranuar fonde të tilla. Nga ato që nuk kanë marrë kurrfarë fondesh të BE-së, pjesa më e madhe e tyre as që kanë aplikuar (67%), derisa një pjesë e vogël kishin aplikuar, por nuk ishin përzgjedhur (17%).

Një analizë më e thellë e problemeve, me të cilat ballafaqohen lidhur me aplikimin për fonde të BE-së ose me zbatimin e tyre, vërteton perceptimin se vetëm OShC-të e konsoliduara kanë kapacitetet e përshtatshme që të aplikojnë për fonde të BE-së dhe që t'i fitojnë ato, ku pjesa më e madhe e sektorit madje as që konsiderojnë aplikimin për këto fonde. Procedurat e komplikuar të aplikimit ishin sfida kryesore (32% e përgjigjeve), pasuar nga kërkesat e larta kohore dhe të burimeve njerëzore për procesin e aplikimit (21% e përgjigjeve) dhe vështirësitë në sigurimin e bashkëfinancimit siç kërkohet nga BE-ja (19% e përgjigjeve).



(Fig.40: Sfidat kryesore në aplikimin/zbatimin e fondeve të BE-së – Burimi: Anketa me OShC)

Një nga arsyet kryesore për numrin e ulët të përfituesve të fondeve të BE-së kanë qenë rregullat strikte të BE-së (PRAG),⁴⁸ të cilat lejojnë pak fleksibilitet për t'iu përshtatur kapaciteteve të OShC-ve më të vogla. Ndryshimet e fundit të këtyre rregullave i'a kanë mundësuar BE-së të përshtasë

48 EU PRAG i referohet Udhëzuesit Praktik të BE-së për Procedura Kontraktuese për Veprimet e Jashtme të BE-së

modele të ngjashme me ato të donatorëve të tjerë të huaj lidhur me shfrytëzimin e kapaciteteve vendore për menaxhimin e fondeve të tij për shoqërinë civile, përmes rigrantimit si një mekanizëm kryesor për arritjen tek OShC-të më të vogla dhe ato lokale. Zyra e BE-së në Kosovë tashmë ka filluar me zbatimin e skemave të ringrantimit, të cilat kanë potencial të rritjes së shtrirjes së përfituesve të fondeve të BE-së në të ardhmen.

Fondet publike

Fondet publike për shoqërinë civile mbesin ndër problemet më të mëdha për zhvillimin e sektorit në Kosovë. Përkundër faktit që shteti në shumë raste ofron fonde për OShC-të, posaçërisht OShC-ve më të vogla, nuk ka rregulla e as procedura për këtë proces.

Fondet ekzistuese për OShC-të ndahen nga institucionet e caktuara në nivel qendror dhe lokal, pa ndonjë lloj bashkëpunimi dhe pa ndonjë planifikim brenda buxhetit të shtetit. Vetëm tri raste të fondeve të planifikuara për OShC-të janë identifikuar në buxhetin e shtetit për vitin 2015,⁴⁹ ku trendë të ngjashëm kanë qenë të pranishëm edhe gjatë viteve të kaluara. Në nivelin qendror dhe atë lokal nuk ekzistojnë mekanizmat e financimit, e as që ekziston ndonjë organ me mandat për monitorimin se si fondet publike i shpërndahen shoqërisë civile. Gjithashtu, nuk ekzistojnë procedura specifike për ndarjen e fondeve publike OShC-ve ose kritere standarde të përzgjedhjes, përmes të cilave do të sigurohej që fondet publike të shpërndahen sipas mënyrës së paraparë. Një numër ministrish kanë hartuar legjislacion specifik sekondar për “ndarjen e subvencioneve OJQ-ve”, por baza ligjore e këtyre rregulloreve mbetet e paqartë. Përveç kësaj, në këto rregullore nuk mbulohet i tërë cikli i financimit publik dhe trajtojnë të njëjtat çështje në mënyra dhe nivele të ndryshme të hollësive, varësisht se për cilën ministri bëhet fjalë.

Informatat për dhënien e fondeve publike OShC-ve rrallë janë në dispozicion, ku vetëm disa ministri publikojnë herë pas here disa të dhëna. Përkundër kërkesës së paraparë në Strategjinë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile për publikimin e të dhënave lidhur me të gjitha fondet publike për shoqërinë civile,⁵⁰ një informatë e tillë asnjëherë nuk është publikuar. Si rezultat, nuk ka të dhëna për shumtë, numrin dhe llojin e projekteve dhe organizatave që kanë përfituar nga fondet publike.

Një zhvillim pozitiv është shënuar gjatë majit 2016, kur Qeveria miratoi një model të financimit publik për OShC-të, i cili është dizajnuar bashkërisht me shoqërinë civile. Ky model parasheh kritere të përgjithshme unike për planifikim, shpërndarje dhe monitorim të fondeve publike për OShC-të, ku secila ministri është përgjegjëse për krijimin e procedurave specifike në përputhje me kushtet e përgjithshme. Qeveria ia ka dhënë përgjegjësinë Ministrisë së Financave dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë që të fillojnë hartimin e rregulloreve të nevojshme për ta funksionalizuar këtë model.

I vetmi burim i informatave për fondet publike për OShC-të është Anketa me OShC. Këto të dhëna tregojnë se në vitin 2015 vetëm një e katërta e OShC-ve të anketuara kanë marrë fonde nga autoritetet shtetërore, qofshin ato lokale apo qendrore. Në përgjithësi, pranuesit e fondeve publike janë OShC-të më të vogla që zakonisht janë aktive në nivel lokal dhe që punojnë me buxhet vjetor prej disa mijë eurosh.


49 Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raport për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.28

50 Qeveria e Kosovës. “Strategjia për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 dhe plani i veprimit 2013-2015.” www.zqm.rks-gov.net. 2013. https://zqm.rks-gov.net/Portals/0/Docs/STRATEGJIA_QEVERITARE_PER_BASHKPUNIM_NE_TRI_GJUHET.pdf.

Gjatë vitit 2015, 25% e OShC-ve të anketuara deklaruan se kanë marrë fonde publike. Nga këta, 68% raportuan se i kanë pranuar ato për projekt apo aktivitet specifik, 12% si përkrahje institucionale, 12% si bashkëfinansim për projekte të BE-së dhe të donatorëve të tjerë dhe 12% deklaruan se i kanë marrë fondet për qëllime të tjera, gjegjësisht, për ngritje të kapaciteteve, vizita dhe rekreacion dhe për sigurimin e punës mjekësore të organizatës. Kur u pyetën lidhur me procedurat e aplikimit, pothuajse gjysma e tyre (42%) thanë se i kanë kërkuar fondet drejtpërdrejtë nga institucionet shtetërore, ndërsa gjysma tjetër (54%) deklaruan se i kanë pranuar fondet publike përmes thirrjeve të hapura për aplikime dhe vetëm një numër i vogël (4%) thanë se fondet i kanë pranuar përmes modaliteteve specifike të financimit të pajtuara mes donatorëve dhe komunës. Në këtë drejtim, niveli i thirrjeve të hapura është më i pranishëm në nivel qendror sesa në atë lokal - 62.5% e OShC-ve që kanë marrë grante nga institucionet e nivelit qendror deklaruan se i kanë marrë përmes thirrjeve të hapura, derisa për OShC-të që kanë marrë fonde nga institucionet e nivelit lokal, kjo shifër ishte vetëm 21.4%.


Nga 37 kontrata të fondeve publike të raportuara nga OShC-të e anketuara, pjesa më e madhe e tyre janë nënshkruar me institucionet e nivelit qendror (65%), ndërsa pjesa tjetër me atë lokal. Edhe pse institucionet qendrore kanë dhënë më shumë fonde publike, shumica e pranuesve të këtyre fondeve vinë nga niveli lokal. Nga të gjitha OShC-të që kanë pranuar fonde publike, 90% funksionojnë në nivel lokal. Sa iu përket shumave të pranuar, më shumë se 85% e këtyre kontratave si në nivelin qendror, ashtu edhe atë lokal, kanë qenë më të vogla se 10,000 euro në vlerë, ndërsa pjesa tjetër e tyre kanë qenë prej 10,000 euro deri në 25,000 euro. Nuk janë raportuar raste të dhënies së fondeve publike në shuma më të larta.

Një përparim është vërejtur në raportimin dhe monitorimin e fondeve publike për shoqërinë civile, edhe pse ende nuk ka një sistem koherent. Disa institucione publike janë përgjigjur ndaj raporteve të shpeshta kritike të Auditorit të Përgjithshëm dhe kanë nisur një nivel të monitorimit. Kjo vërtetohet edhe me faktin se rreth tri të katërtat e OShC-ve që kanë marrë fonde publike deklarojnë se kanë dorëzuar raporte të aktiviteteve dhe atë financiar, 40% e tyre raportojnë se kanë pasur vizita të lajmëruara monitoruese. Megjithatë, ende ka raste (12%) ku OShC-të nuk kanë dorëzuar ndonjë raport e as që janë monitoruar nga institucioni përkatës publik.



(Fig.41: Përvoja e OShC-ve me monitorimin dhe raportimin e fondeve publike gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Të dhënat e anketës sugjerojnë një numër problemesh me financimin publik për OShC-të veçanërisht lidhur me prokurimin, të dhënat në dispozicion, transparencën, përshtatshmërinë, planifikimin pjesëmarrës, etj. Më shumë se 80% e OShC-ve nuk u pajtuan me deklaratën se *vendimet për tenderë janë të drejta, të shpallura publikisht, nuk kanë konflikt të interesit dhe se financimi publik është i mjaftueshëm dhe në përputhje me nevojat e OShC-ve*. Dy të tretat e OShC-ve nuk u pajtuan me deklaratën që *financimi publik është i parashikueshëm në bazë të ndarjes së fondeve në vitin paraprak*, si dhe që *OShC-të marrin pjesë në caktimin e prioriteteve të financimit publik*, ndërsa 55% nuk u pajtuan me deklaratën se *kriteret e përzgjedhjes janë të qarta/të kuptueshme dhe të qasshme nga publiku*.



(Fig.42: Vlerësimi i OShC-ve për fondet publike gjatë vitit 2015 – Burimi: Anкета me OShC)


Siç është pritur, deklaratat e OShC-ve që kanë marrë fonde publike janë deri diku më pozitive krahasuar me ato të atyre që nuk kanë pranuar fonde të tilla.

Kontratave shtetërore për shërbime publike

Derisa financimi publik për OShC-të përfshinë vetëm grantet për projekte dhe nisma të tjera të dizajnuara nga OShC-të dhe që shërbejnë për arritjen e objektivave të ndryshme në bazë të modaliteteve të propozuara nga OShC-të, një kategori tjetër e aktiviteteve dhe shërbimeve të OShC-ve janë shërbimet për grupe të qytetarëve, të cilat konsiderohen si shërbime publike. Në këtë kategori hyjnë të gjitha ato shërbime që janë obligim i shtetit, por ofrohen edhe nga OShC-të.

Duke qenë obligim i shtetit, në një situatë ideale, shteti do të mbulonte shpenzimet për të gjitha këto shërbime, duke përfshirë ato të ofruara nga OShC-të. Megjithatë, përkundër ekzistimit të shumë OShC-ve që ofrojnë shërbime të ndryshme për qytetarë për më shumë se një dekadë tashmë, ende pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve përkrahen nga fondet e donatorëve të huaj dhe jo nga shteti.

Nga të gjitha OShC-të e anketuara, 45% e tyre deklarojnë se ofrojnë disa lloje të shërbimeve publike, siç janë shërbimet sociale, arsimore, të kujdesit shëndetësor, të banimit, kulturës, etj. Ato që ndërlidhen me arsimin janë më të pranishmet nga këto shërbime, të pasuara nga shërbimet sociale dhe të kujdesit shëndetësor. Llojet e tjera të shërbimeve janë më pak të pranishme.



(Fig.43: Kontratat shtetërore të fituara nga OShC-të e anketuara gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve (88.4%) ofrohen falas për të gjithë përfituesit, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e shërbimeve (9.3%) kërkojnë një pagesë simbolike vetëm nga ata që nuk janë përfituesit kryesor të synuar të shërbimit. Ishte vetëm një rast kur shërbimi i ofruar nga OShC-ja është bërë me pagesë të plotë për të gjithë përfituesit e shërbimit. Përkundër të qenit shërbim publik, shpenzimet e këtyre shërbimeve ende kryesisht mbulohe nga donatorët e huaj (51.1%) ose nga donatorët privatë vendorë (27.9%). Siç është raportuar nga OShC-të e anketuara, vetëm 23.3% e tyre pranojnë fonde shtetërore për shërbimet publike që ua ofrojnë qytetarëve.

Çështja e kontratave shtetërore për shërbime publike të ofruara nga OShC-të ka shumë sfida si lidhur me shumën e financimit, ashtu edhe me procedurat. Vetëm tani së fundi është bërë e mundur në Ligjin për prokurimin publik që OShC-të të trajtohen në mënyrë të barabartë me ofruesit e tjerë të shërbimeve përkitazi me certifikatën e regjistrimit, derisa vetëm një numër i vogël ligjesh apo i akteve nënligjore trajtojnë nevojat specifike të OShC-ve që kanë të bëjnë me aplikimin për ofrimin e këtyre shërbimeve publike dhe me ofrimin e tyre. Fusha e ofrimit të shërbimeve sociale duket të jetë e vetmja, ku në ligj merret parasysh natyra specifike e punës së OShC-ve. Pas krijimit të sistemit të licencimit të shërbimeve sociale tani së fundi, OShC-të kanë të drejtë të aplikojnë për licenca dhe për kontrata shtetërore për shërbime të caktuara sociale. Megjithatë, edhe në ofrimin e shërbimeve sociale, ende mbesin shumë probleme: nuk ekzistojnë linja specifike buxhetore për financimin e shërbimeve të ofruara nga OShC-të; fondet nuk janë të parashikueshme dhe kohëzgjatja e kontratave shtetërore nuk mund të kalojë periudhën prej 1 viti; fondet e dhëna nga shteti nuk janë të mjaftueshme në mbulimin e shpenzimeve bazike të shërbimit të ofruar, ndërsa asnjë kontratë shtetërore nuk mbulon shpenzimet e tjera institucionale. Procedurat e përzgjedhjes janë

të rregulluara përmes akteve nënligjore dhe jo përmes ligjeve, dhe ekzistojnë vetëm disa kritere dhe procedura të përgjithshme për financimin e OShC-ve që ofrojnë shërbime sociale.⁵¹

Fushat e tjera, siç është arsimi ose shërbimet shëndetësore ende mbesin prapa. Si rrjedhojë, me përjashtim të shërbimeve sociale, rastet e kontratave shtetërore me OShC-të për shërbime në fusha të tjera janë të rralla.

Në anketën me OShC-të vërtetohen shumica e çështjeve të cekura më lartë. Vetëm 10% e OShC-ve deklaruan se kanë konkurruar për kontrata shtetërore gjatë vitit 2015. Kur u pyetën për pengesat, me të cilat janë ballafaquar gjatë procesit, gjysma e këtyre OShC-ve (gjithsej 5) thanë se ka *pasur kushte të shumta administrative*; një e treta deklaruan se *numri i tenderëve publikë në fushën e tyre të aktivitetit është i vogël dhe nga një OShC deklaroi se procedurat për regjistrim/licencim janë të ndërlikuara, se janë hequr nga konkurrenca pa ndonjë shpjegim dhe se ka pasur vonesa gjatë procesit*.

Pjesa më e madhe e OShC-ve që kanë pranuar fonde përmes kontratave shtetërore deklaruan se fondet kanë qenë të pamjaftueshme për t'i mbuluar madje edhe kostot e shërbimeve bazike (6 nga 10), ndërsa 3 të tjera thanë se kanë qenë të mjaftueshme të mbulojnë shpenzimet e ofrimit të shërbimit, por jo edhe shpenzimet institucionale (shpenzimet administrative dhe ato fikse të organizatës). Shumica e OShC-ve që kanë nënshkruar kontrata shtetërore (7 nga 10) gjithashtu deklaruan se ka pasur probleme me pranimin në kohë të mjeteve financiare; vetëm 3 OShC thanë se mjetet financiare nga kontratat shtetërore i kanë marrë me kohë. Sipas OShC-ve të tjera, fondet janë vonuar dhe kjo ka shkaktuar probleme në ofrimin e shërbimit (4 nga 10), ndërsa 2 nga 10 sosh thanë se fondet janë vonuar, por që janë kompensuar për humbjet e shkaktuara prej vonesës së mjeteve financiare.

Më shumë se gjysma e OShC-ve që kanë marrë fonde përmes kontratave shtetërore deklaruan se monitorimi i shpenzimeve dhe sigurimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga organizata ka qenë i rregullt dhe jo i tepërt (7 nga 10), ndërsa 2 OShC thanë se *monitorimi dhe sigurimi i cilësisë ka qenë i tepërt apo i parregullt*. Pjesa më e madhe e OShC-ve të anketuara konsiderojnë monitorimin e kontratave të shtetit njëjtë në krahasim me ofruesit shtetërorë/publikë dhe bizneset, 2 nga 8 deklaruan se është më pak i ndërlikuar në krahasim me ofruesit e tjerë dhe vetëm një ka thënë se është më i hollësishëm.

Perceptimi i drejtësisë gjatë marrjes së vendimeve është i ngjashëm me atë për financimin publik, pasi që vetëm 13% e OShC-ve konsiderojnë që kontratat shtetërore jepen në mënyrë të drejtë dhe transparente. Më shumë se gjysma e OShC-ve (52%) mendojnë se këto kontrata nuk jepen në mënyrë të drejtë dhe transparente, ndërsa 35% e OShC-ve të anketuara deklarojnë se nuk janë të njoftuara për praktikën e vendimmarrjes për kontratat e shtetit. Duke e konfirmuar këtë perceptim, më shumë se gjysma e OShC-ve të anketuara (57.6%) thonë se mendimi i tyre bazohet në përvojën personale apo në atë të organizatës, ndërsa një katërta e krijojnë perceptimin e tyre në bazë të bisedave me të tjerët apo nga mediet.

Përkrahja jofinanciare


Përveç ofrimit të fondeve për aktivitete specifike të OShC-ve, shteti mund të përkrahë sektorin edhe përmes ofrimit të llojeve të tjera të përkrahjes, duke përfshirë ato jofinanciare. Lloji i përkrahjes

51 Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raport për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.43-45

mund të përfshijë forma të ndryshme, siç është dhënia e pronës grupeve të caktuara të shoqërisë civile, shfrytëzimi falas qoftë për afat të shkurtër apo të gjatë i objekteve apo hapësirave shtetërore, etj.

Në Kosovë nuk kemi ndonjë politikë apo kornizë ligjore për përkrahjen jofinanciare të shoqërisë civile. I vetmi ligj ku në mënyrë të tërthortë trajtohet kjo çështje është Ligji 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Në bazë të këtij Ligji, OShC-të janë në mesin e përfituesve të mundshëm të pronës komunale, në bazë të një konkursi të hapur publik për të gjithë personat fizikë dhe juridikë. Kriteret e parapara janë shumë të përgjithësuara dhe nuk ekziston një proces i qartë për ofrimin e kësaj përkrahjeje jofinanciare OShC-ve. Edhe pse në Ligj parashihen rrethanat specifike kur mund të anashkalohej procedura e hapur, OShC-të nuk hyjnë brenda kësaj kategorie. Po ashtu, nuk ekzistojnë dispozitat specifike për përdorim të njëhershëm të pronave komunale apo të pronave të tjera shtetërore nga shoqëria civile.⁵²

Anketa me OShC tregon se vetëm një pjesë e vogël e shoqërisë civile përfiton nga përkrahja jofinanciare e shtetit. Vetëm 22% e OShC-ve deklaruan se kanë marrë përkrahje jofinanciare nga institucionet e shtetit – p.sh. hapësirë të punës falas/pa qira, pajisje teknike, etj. Shumica e tyre këtë përkrahje e kanë përfituar përmes kontakteve të drejtpërdrejta me institucionet shtetërore. Megjithatë, shumica e OShC-ve asnjëherë nuk kanë aplikuar për përkrahje jofinanciare nga shteti: 14% e organizatave të intervistuar thanë se nuk e kanë ditur se mund të marrin përkrahje jofinanciare nga shteti, ndërsa 52% deklaruan se asnjëherë nuk kanë kërkuar përkrahje jofinanciare.



(Fig.44: Llojet dhe sfidat e përkrahjes jofinanciare të OShC-ve gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Thënë në përgjithësi, lloji mbizotërues i përkrahjes jofinanciare është shfrytëzimi falas i objekteve në pronësi shtetërore për aktivitete specifike të OShC-ve, që është raportuar nga 12 OShC, ndërsa llojet tjera të përkrahjes janë më të rralla, dhe përfshijnë material për zyrë dhe mobile (3 OShC), arsim/trajtime dhe ngritje të kapaciteteve (2 OShC) dhe letra e përkrahjes nga kryetari i komunës (1 OShC).

⁵² Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raport për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.30

Donacionet private dhe filantropia


Ngjashëm me burimet e tjera vendore të financimit, donacionet private për shoqërinë civile përfaqësojnë një përqindje të vogël të financimit të përgjithshëm. Vetëm 15% e OShC-ve të anketuara deklaruan se gjatë vitit 2015 kanë marrë fonde nga donatorët vendorë privatë (individ ose kompani). Megjithatë, pasi që shumica e OShC-ve që marrin donacione nga individët privatë apo kompanitë janë OShC të vogla të nivelit lokal pa qasje të duhur në fonde ndërkombëtare, ky burim i të hyrave mund të jetë i rëndësishëm për këtë lloj të OShC-ve. Rreth një e katërta e OShC-ve të anketuara që marrin donacione private kanë deklaruar këtë si të vetmin burim të financimit. Këto janë kryesisht organizata që punojnë në baza vullnetare dhe që mbledhin donacione simbolike nga individët, edhe pse ka raste të izoluara të donacioneve nga kompanitë private.

Me shumicën dërmuese e tyre (79%) që vlersojnë se procedurat administrative për pranimin e donacioneve private ishin shumë të lehta, është evidente se kjo formë e financimit mbledhet në mënyrë më pak formale dhe pa ndonjë procedurë përcjellëse formale. Pasi pothuajse nuk ka beneficione tatimore për donatorët privatë të shoqërisë civile, ata nuk janë të stimuluar të formalizojnë dhëniet e tyre. Sipas të dhënave të ATK, gjatë vitit 2015 ka qenë vetëm një rast i zbritjes së tatimit për kompaninë private si rezultat i donacionit për OShC-në (për më shumë informata shih pjesën për stimulimet e donatorëve të OShC-ve).


Në anën tjetër, si ligji i mëparshëm, ashtu edhe Ligji i ri për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit janë kufizues në kuptim të donacioneve në para të gatshme për OJQ-të. Sipas Ligjit të ri të miratuar në maj të vitit 2016, OJQ-ja nuk lejohet të pranojë më shumë se 500 euro në para të gatshme nga i njëjti dërgues brenda ditës, ose më shumë se 1,000 euro nga i njëjti dërgues brenda vitit. Dënimet për mosrespektimin e këtij kufizimi janë të mëdha, si në kuptim të gjobave financiare, ashti edhe në atë përgjegjësisë penale.⁵³

Nivelet e ulëta të filantropisë, sidomos ndaj shoqërisë civile, janë rezultat i kombinimit të faktorëve të ndryshëm. Disa nga ata shkaktohen drejtpërdrejtë nga mosekzistimi i ndonjë politike qeveritare për zhvillimin e filantropisë, ndërsa faktorët e tjerë janë të ndërlidhur me kulturën përgjithshme të dhënies për kauza publike, ku rol në këtë drejtim luajnë edhe elementet e brendshme të OShC-ve. Sipas perceptimeve të OShC-ve, kultura e pazhvilluar për donacione dhe mosekzistimi i strategjive apo politikave publike për filantropi, janë sfidat kryesore për filantropi. Numri i atyre OShC-ve që besojnë se filantropia është e zhvilluar në Kosovë është vetëm 4.7%.

53 Për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit, Ligji 05/L-096, neni 29



(Fig.45: Vlerësimi i OShC-ve për ambientin për filantropi në Kosovë – Burimi: Anketa me OShC)



Ndikimi i perceptuar


Shoqëria civile e Kosovës ka ndikim të kufizuar në çështjet që janë brenga kryesore të qytetarëve, siç janë zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit. Është interesant fakti që shoqëria civile duket të jetë më kritike ndaj vetes krahasuar me palët jashtë sektorit kur vlerësohet ndikimi i sektorit në këto fusha. Një ndikim më i madh perceptohet të jetë në fushën e demokratizimit. Përkundër ndikimit të perceptuar, fushat ku shoqëria civile shihet të jetë më aktive janë transparenca dhe llogaridhënia si dhe sundimi i ligjit. Shoqëria civile ka një komunikim të mirë me institucionet publike relevante për punën e saj, por kjo nuk përkthehet në qasje të mjaftueshme në informata dhe përfshirje në konsultimet publike për procesin e politikëbërjes. Përderisa OShC-të e mëdha janë më të ekspozuara ndaj procesit të politikëbërjes, ndikimi i sektorit në këtë proces mbetet i kufizuar.

Siç ishte rasti edhe në publikimet e mëparshme të Indeksit të Shoqërisë Civile, studimi mat ndikimin e perceptuar dhe jo ndikimin e shoqërisë civile. Kjo ndodh për shkak të faktit se ndikimi në cilëndo fushë varet nga një numër faktorësh dhe nuk mund t'i atribuohet një iniciative apo sektori. Për më tepër, derisa disa aktivitete të OShC-ve mund të kenë rezultate të dukshme brenda një periudhe të shkurtër kohore, shumë nisma të tjera krijojnë rezultate të prekshme vetëm pas shumë muajsh apo vitesh nga koha kur ndodh një intervenim. Megjithatë, përmes matjes së një numri treguesish specifikë, mund të fitohen disa hollësi lidhur me ndikimin e perceptuar të sektorit.

Reagueshmëria

Të gjitha studimet përgjatë viteve të fundit vërtetojnë se brengat kryesore të qytetarëve të Kosovës janë të ndërlidhura me zhvillimin ekonomik (papunësia, standardi jetësor, çështjet sociale, etj.) apo me sundimin e ligjit (korrupsioni, sistemi i drejtësisë, nepotizmi, të drejtat e njeriut, etj.). Duke qenë pjesë përbërëse e shoqërisë në përgjithësi, shoqëria civile pritet të reagojë ndaj brengave kryesore të qytetarëve, krahas promovimit të çështjeve dhe vlerave të tjera. Kjo është arsyeja pse studimi analizon nëse shoqëria civile reagon ndaj brengave kryesore të qytetarëve, si dhe vendim-marrjen në institucione, si një pjesë shumë të rëndësishme e vlerave të promovuara nga shoqëria civile në Kosovë dhe me gjerë.

Nga perceptimi i tyre për ndikimin e shoqërisë civile në tri kategori, OShC-të e anketuara kanë qenë më pozitive lidhur me demokratizimin e vendimmarrjes në institucione publike, derisa kanë qenë më pak pozitive lidhur me zhvillimin ekonomik. Ngjashëm me vitet paraprake, ndikimi i perceptuar i shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik është mjaft i kufizuar (41.8%) ose pa fare ndikim (31.6%), ku vetëm një e katërta e OShC-ve që perceptonin ndikimin e sektorit si mesatar (22.5%) apo të lartë (2%). Paksa më e mirë është ndikimi i perceptuar në sundimin e ligjit, me përqindje më të ulëta të ndikimit të kufizuar dhe përqindje më të mëdha të ndikimit të madh.




(Fig.46: Perceptimi i OShC-ve për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore të qytetarëve – Burimi: Anketa e OShC-ve)

Të dy këta tregues kanë shënuar rënie të vogël krahasuar me vitet 2011 dhe 2014, që mund të jetë rezultat i gjendjes së përkeqësuar politike në dy vitet e fundit. Në studimet e tjera vërtetohet se pakënaqësia me drejtimin politik të vendit është rritur dukshëm (42.5% në prill 2014; 68.4%

në shtator 2015), derisa perceptimi i favorshëm i qytetarëve lidhur me institucionalizimin dhe drejtimin e duhur të proceseve demokratike në Kosovë është përgjysmuar gjatë periudhës së njëjtë (33% në prill 2014; 15.4% në shtator 2015).⁵⁴ Megjithatë, qasja e shoqërisë civile dhe aktiviteti në këto dy fusha nuk ka shënuar ndonjë ndryshim të dukshëm, ku ende mbetin sfidat e ngjashme. Përkundër aktivitetit intensiv të shumë OShC-ve si në zhvillimin ekonomik, por veçanërisht edhe në sundimin e ligjit, shoqëria civile ka shumë pak mjete në dispozicion për të ndikuar ndryshime në këto fusha.

Vlen të theksohet se shoqëria civile duket se ka pikëpamje më kritike për vetveten sesa të tjerët që janë jashtë sektorit civil. Anketa e Perceptimeve të Jashtme tregon një perceptim më pozitiv të ndikimit të shoqërisë civile në secilën prej këtyre fushave, posaçërisht në fushën e sundimit të ligjit. Rreth gjysma e tyre besojnë se shoqëria civile kishte ndikim mesatar (40%) ose të lartë (9.1%) në fushën e sundimit të ligjit.



(Fig.47: Perceptimi i palëve të jashtme për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore për qytetarët – Burimi: Anketa e Perceptimeve të Jashtme)

Diskutimi në GF me qytetarë të rëndomtë tregon perceptime interesante lidhur me reagueshmërinë e shoqërisë civile. Shumë nga pjesëmarrësit theksuan se shoqëria civile më shumë merret me çështje politike sesa me çështje të shqetësimit ditor të qytetarëve. Kur u pyetën se ku e bazojnë këtë perceptim, duket se për ta shoqëria civile janë “disa drejtues të OShC-ve që rregullisht dalin në emisione politike televizive”. Sipas tyre, kjo ndodh për shkak të rëndësisë së ekspozimit në media për ta rritur profilin individual të drejtuesve të OShC-ve, të cilët më vonë mund të marrin parasysh të hynë në politikë. Megjithatë, diskutimet e mëtejme shpërfaqën se shumë nga aktivitetet për të cilat pjesëmarrësit do të ishin të interesuar, në fakt realizohen nga shoqëria civile, por se këta qytetarë nuk janë të njoftuar për to. Kjo tregon nivel të dobët të komunikimit me qytetarë të rëndomtë, posaçërisht nga ato OShC të cilat nuk merren me çështjet e politikës ditore, por me nisma në interes të qytetarëve e që shpesh kanë mbulesë shumë të ulët mediale.

54 Raporti i pulsit publik. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara. X ed. Prishtinë, Kosovë: UNDP, 2015, f. 3 & 6 http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-10/

Ndikimi i perceptuar

Përveç në fushat që janë brenga kryesore të qytetarëve, OShC-të janë aktive dhe kanë ndikim në shumë fusha të tjera. Më parë, fushat ku shoqëria civile është perceptuar se kishte më shumë ndikim kanë qenë demokratizimi që pasohet nga barazia gjinore, si dhe përkrahja për grupet e varfra dhe të marginalizuara. Demokratizimi ende mbetet numër një, dhe qëndron larg nga fushat e tjera që janë nga më të ndryshmet.

Demokratizimi gjendet në vendin e parë në kuptim të përqindjes së OShC-ve që e zgjedhën si fushë të ndikimit të sektorit të shoqërisë civile (zgjedhur nga 26% e OShC-ve), i cili pasohet nga sundimi i ligjit me 7% të OShC-ve, të drejtat e njeriut (5% e OShC-ve), barazia gjinore, të drejtat dhe fuqizimi i grave, të rinjtë dhe sporti, si dhe transparenca, ku për secilën kjo shifër ishte 4% e OShC-ve. Më shumë se tri të katërtat e OShC-ve ndajnë mendimin se ndikimi i organizatave të shoqërisë civile në këto fusha ishte i lartë (20% të OShC-ve) ose mesatar (57%).

Demokratizimi	26%	Aktivizmi /pjesëmarrja e qytetarëve	2%
Sundimi i ligjit	7%	Bujqësia	2%
Të drejtat e njeriut	5%	Integrimi në BE	2%
Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas	4%	Bashkëpunimi mes qeverisë dhe shoqërisë civile	1%
Kultura, rinia dhe sporti	4%	Mbrojtja e mjedisit	1%
Transparenca	4%	Pakicat	1%
Arsimi	3%	Ndihma humanitare	1%
Monitorimi (i punës së institucioneve)	3%	Personat me aftësi të kufizuara	1%
Zhvillimi ekonomik	3%	Siguria	1%

(Fig.48: Perceptimi i OShC-ve për fushat kryesore të ndikimit të shoqërisë civile në përgjithësi – Burimi: Anketa me OShC)

Treguesi i lartcekur matet në bazë të perceptimeve të OShC-ve të anketuara për ndikimin e shoqërisë civile në tërësi. Nga ana tjetër, kur u pyetën për ndikimin e organizatës së tyre gjatë vitit 2015, perceptimet dallojnë dukshëm.


Siç tregon tabela e mëposhtme, arsimi gjendet në majë të listës me 11% të OShC-ve që kanë përzgjedhur këtë fushë kur organizata e tyre ka pasur më së shumti ndikim, përderisa fushat e tjera të cekura nga OShC-të janë mjaft të larmishme. OShC-të e anketuara deklaruan se në fushat ku kanë më së shumti ndikim si organizata, ky ndikim ishte mesatar (60%), ose i lartë (18%).

Fusha	% e OShC-ve	Fusha	% e OShC-ve
Arsimi	11%	Integrimi në BE	2%
Zhvillimi i kapaciteteve të shoqërisë civile	6%	Pjesëmarrja e qytetarëve	2%
Zhvillimi ekonomik	5%	Vetëdijesimi shoqëror	2%
Rritja e vetëdijesimit në fushën e tyre të punës	5%	Kujdesi shëndetësor	2%
Bujqësia	4%	Transparenca	2%
Demokratizimi dhe sundimi i ligjit	4%	Fuqizimi ekonomik i pakicave	1%
Mbrojtja e mjedisit	4%	Dialogu shoqëror	1%
Të tjera	4%	Marrëdhëniet ndëretnike	1%
Barazia gjinore	3%	Banimit	1%
Ndihma humanitare	3%	Hapësirat publike	1%
Të drejtat e njeriut	3%	Shkenca	1%
Të drejtat e pakicave	3%	Trashëgimia	1%
Mbrojtja e fëmijëve	2%	Turizmi	1%
Rinia	2%		

(Fig.49:Perceptimi i OShC-ve për fushat kryesore të ndikimit të organizatës së tyre – Burimi: Anketa me OShC)

Përderisa nuk ka të dhëna lidhur me fushat specifike të aktiviteteve ku shoqëria civile në veriun e Kosovës perceptohet se ka më shumë ndikim, këto organizata nuk kanë një konsensus për ndikimin e tyre në përgjithësi. Disa OShC që kanë marrë pjesë në GF mendojnë se roli i tyre është i rëndësishëm, duke marrë parasysh institucionet e dobëta në pjesën veriore të Kosovës, të cilat OShC-të duhet vazhdimisht t'i përkrahin. Një OShC tjetër kishte mendimin se OShC-të mund të ndikojnë organizatat e tjera dhe se ndikimi i tyre në fushat e tjera ishte i kufizuar. Megjithatë, OShC-të në pjesën veriore të Kosovës kanë një mendim të përbashkët se janë më pak të fuqishme për të ndikuar në çfarëdo zhvillimi në krahasim me organizatat në pjesën tjetër të Kosovës. Përkatësia etnike, historiku dhe përvoja e punës me institucionet e qeverisë dhe ngritja e vetëdijesimit qytetarë janë cekur si të rëndësishme në mundësimin e OShC-ve që të kenë ndikim. Gatishmëria e institucioneve të nivelit qendror për bashkëpunim gjithashtu është theksuar si e rëndësishme. Për më tepër, ata zakonisht besojnë se efektshmëria e shoqërisë civile në pjesën veriore të Kosovës ka nevojë të rritet dhe se pengohet shumë nga qytetarët në përgjithësi të painformuar, keqinformuar dhe të paangazhuar, të cilët kanë perceptim shumë negativ për shoqërinë civile, e cila nga shumë njerëz konsiderohet si e “*paguar nga të gjitha anët*”.

Ndikimi i perceptuar nuk është domosdo i ndërlidhur me nivelin e aktivitetit. Niveli i aktivitetit është matur përmes perceptimit të hisedarëve të jashtëme, gjegjësisht duke i pyetur ata se cilat ishin fushat ku mendojnë se shoqëria civile ka qenë shumë aktive, por se ky nivel i aktivitetit nuk përkon me nivelin e ndikimit të perceptuar.



(Fig.50: Perceptimi i palëve të jashtme për fushat kryesore të aktivitetit të shoqërisë civile – Burimi: Anketa e Perceptimeve të Jashtme)

Ngjashëm me studimet paraprake, transparencja dhe llogaridhënia, si dhe sundimi i ligjit gjenden në pozita të larta në kuptim të aktivitetit, por e njëjta nuk është e pranishme kur kemi të bëjmë me ndikimin e perceptuar. Kjo ndodh kryesisht për shkak të mjeteve të kufizuara të shoqërisë civile për trajtimin e këtyre çështjeve dhe fushave, si dhe varësisë nga shumë faktorë të tjerë që shkojnë përtej kontrollit të shoqërisë civile. Për ta ilustruar këtë, shumë herë shoqëria civile ka ekspozuar publikisht mungesën e transparencës apo praktikave të korrupsionit, si dhe ka dhënë detaje të sjelljeve të këqija. Megjithatë, ky është kufiri i mundësive të shoqërisë civile, ndërsa institucionet përgjegjëse nuk kanë vazhduar me veprimet pasuese të pritura.


Avokimi

Duke ditur se aktiviteti i shoqërisë civile është i orientuar kah shumë shtresa të shoqërisë civile, një pjesë e rëndësishme e punës së saj është e fokusuar drejt institucioneve publike dhe procesit të hartimit të politikave. Avokimi për kauza dhe çështje të caktuara kërkon një numër parakushtesh. Në këtë studim trajtohet i tërë cikli, duke filluar nga komunikimi me institucionet relevante publike, qasja në informata deri te përfshirja e drejtpërdrejtë në hartimin e politikave.

Fillimisht, Anketa me OShC ka matur nivelin e komunikimit mes OShC-ve dhe institucioneve publike relevante për punën e tyre. Rezultatet e anketës tregojnë se ekziston nivel i mirë i komunikimit, edhe pse ende jo i kënaqshëm. Më shumë se gjysma e OShC-ve të anketuara (52%) thanë se komunikojnë rregullisht (17%) ose shpesh (34%) me institucione publike që veprojnë në fusha të njëjta përmes këmbimit të informatave, takimeve, aktiviteteve të përbashkëta, etj. Megjithatë, më shumë se një e treta e tyre (37.4%) kanë komunikime të rralla dhe 11.1% fare nuk komunikojnë me institucionet publike relevante për punën e tyre.

Një situatë tjetër është e pranishme në pjesën veriore të Kosovës. Derisa komunikimi me institucionet lokale është më pozitiv, komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror është mjaft sfidues. Për disa OShC që kanë marrë pjesë në GF-të në pjesën veriore të Kosovës, arsyeja kryesore për mosmonitorimin e punës e institucioneve qendrore është bindja se nuk janë në gjendje të kenë ndonjë ndikim, si dhe mosgatishmëria e këtyre institucioneve për bashkëpunim. Këto OShC janë ankuar edhe për mungesën e informatave kthyes nga institucionet qendrore të cilat i kanë kontaktuar, vonesën e shpeshtë të informatave dhe mundësitë e kufizuara të ankesës. Shumë pak OShC raportuan të kenë marrëdhënie të mira me ndonjë institucion, përfshirë këtu edhe Zyren e Komisionerit për gjuhë dhe Gjykatën themelore e Mitrovicës. Njëri prej pjesëmarrësve në GF thekso se *“Ata gjithmonë duhet t’i ndjekësh” koment ky i përkrahur edhe nga pjesëmarrësit e tjerë.*

Është interesant të thuhet se niveli i komunikimit është edhe më i ulët kur kemi të bëjmë me institucionet publike që janë të mandatuara të punojnë me shoqërinë civile. Duke mos pasur institucione të tilla në nivel lokal,⁵⁵ institucionet qendrore nuk e kanë komunikimin e nevojshëm me sektorin civil. Si Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyren e Kryeministrit e Zyra ashtu edhe Zyra e Kuvendit për marrëdhënie me shoqërinë civile kanë kontakte vetëm me rreth një të katërtën e shoqërisë civile. Departamenti për OJQ brenda Ministrisë së Administratës Publike ka më shumë komunikim me OShC-të, por për shkak të mandatit të këtij Departamenti, komunikimi është i kufizuar vetëm në çështjet e regjistrimit të OJQ-ve dhe nuk përfshinë çështje të tjera lidhur me punën e OShC-ve.




(Fig.51: Komunikimi i OShC-ve me institucionet publike përgjegjëse për bashkëpunim me shoqërinë civile – Burimi: Anketa me OShC)

55 Komuna e Mitrovicës së jugut është e vetmja komunë që ka personin kontaktues për shoqëri civile.

Një analizë më e thellë e përvojës së OShC-ve lidhur me komunikimin me institucionet për bashkëpunim me OShC-të tregon se sa më të vjetra të jenë OShC-të, aq më i lartë është niveli i komunikimit. Ky korrelacion nuk është i dukshëm për OShC-të e regjistruara gjatë pesë viteve të fundit, por vetëm për OShC-të të regjistruara para 6 ose 7 vitesh e më herët.

Për të ilustruar këtë mungesë të komunikimit, dokumenti kryesor i qeverisë lidhur me shoqërinë civile është Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Edhe pse tani është në vitin e tretë të zbatimit, më pak se 30% e OShC-ve të anketuara deklarojnë se kanë qenë të përfshira në zbatimin e saj. Një statistikë tjetër shqetësuese është se më shumë se 20% e OShC-ve fare nuk janë në dijeni për ekzistencën e një dokumenti të tillë.



(Fig.52: Përfshirja e OShC-ve në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Qasja në informata

Qasja në informata është parakushti kryesor për çfarëdo përfshirje të mundshme të shoqërisë civile në politikëbërje. Pa e ditur se çka po ndodh me institucionet publike, është vështirë të pritët çfarëdo reagoni apo kontributi nga palët e jashtme, duke përfshirë edhe shoqërinë civile.


Korniza ligjore për qasje në informata publike është mjaft pozitive. Qasja në informata publike është e drejtë kushtetuese, e garantuar në nenin 41 të Kushtetutës. Ligji 03/L-215 për qasjen në dokumente publike obligon të gjitha institucionet publike të publikojnë të gjitha dokumentet e miratuara, ndërsa Udhëzimi administrativ për përmbajtjen e faqeve të internetit të institucioneve publike, i miratuar në maj të vitit 2015, gjithashtu obligon publikimin e Planeve vjetore të punës, si dhe projektakteve normative për qëllime të konsultimeve publike. Kur kemi të bëjmë me kërkesat për qasje në dokumente publike, ekzistojnë procedura dhe mekanizma ligjorë solidë për qasje në informata dhe dokumente publike, duke përfshirë afatin prej 7 ditësh për përgjigje

nga institucionet publike. Në këtë Ligj gjithashtu parashihen qartë gjohat monetare për shërbyesit civilë dhe institucionet që shkelin kërkesat ligjore për qasje në informata publike.⁵⁶

Sipas Raportit Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015, qasja në informata publike mbetet sfiduese për tri arsye kryesore: 1) përmbajtja e ligjit mbetet e paqartë; 2) zyrtarët përgjegjës neglizhojnë kërkesat për qasje në informata publike; dhe 3) qytetarët janë të painformuar për të drejtën e tyre për qasje në informata publike.⁵⁷

Në përgjithësi, sasia e informatave në dispozicion nga institucionet publike është shumë e ulët. Edhe pse në kornizën ligjore parashihet publikimi proaktiv i shumë llojeve të informatave nga institucionet publike (pa pasur nevojë që të bëhet kërkesë për to), vetëm 20% e OShC-ve të anketuara deklaruan se janë informuar nga institucionet publike - plotësisht (3%) ose mjaftueshëm (17%) - lidhur me punën e tyre në fushën e OShC-ve.

Nga ana tjetër, vetëm 30% e OShC-ve të anketuara deklaruan se kanë kërkuar qasje në informata publike/zyrtare gjatë vitit 2015. Përvoja e tyre është e ndryshme, edhe pse dy të tretat e OShC-ve që kanë bërë një kërkesë të tillë kanë siguruar qasje në informatat e kërkuara. Megjithatë, çështjet kryesore janë qasja e vonuar në informatën e kërkuar (36%) ose refuzimi i heshtur nga institucionet publike (13%).



(Fig.53: Përvoja e OShC-ve në qasjen në informata publike gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Një GF me OShC-të nxori në pah se derisa informatat teknike janë më të qasshme, është shumë e zakonshme që OShC-ve t'u ofrohen informata jorelevante apo vetëm informata të pjesshme, sa herë që bëjnë kërkesë për dokumente që janë më të ndjeshme ose komplekse. Problemet në qasje gjithashtu janë raportuar lidhur me dykuptimësinë në klasifikimin e dokumenteve dhe në paaftësinë e shërbyesve civilë në këtë drejtim. Qasja në nivelin lokal është më e kufizuar për shkak të përfshirjes së shtresave të shumta të qeverisjes. OShC-të gjithashtu raportojnë probleme

⁵⁶ Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.40

⁵⁷ Raporti Vjetor 2015. Nr:15. Raport. Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës, 2016.39

me trajtimin e ankesave pasi që brenda institucioneve nuk ka mekanizma adekuat për t'u përgjigjur.⁵⁸

Shqetësimet e ngjashme janë ngritur edhe nga OShC-të serbe nga pjesa veriore e Kosovës. Në GF-të, kjo çështje u ngrit si problematike, duke thënë se nuk ju jepen informata apo dërgohen te institucione apo organe të tjera, gjë e cila i largon edhe më shumë nga informata e kërkuar.

Përkundër ekzistimit të dispozitave ligjore për sanksionimin e shërbyesve civilë të cilët në mënyrë të paligjshme ua refuzojnë palëve të treta qasjen në dokumentin e kërkuar, nuk raportohet që këto sanksione janë zbatuar ndonjëherë. Janë bërë përpjekje për kontaktimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me statistikën e vitit 2015, por nuk është marrë ndonjë përgjigje. Në maj të vitit 2015, Gjykata Themelore e Prishtinës nxori një vendim pozitiv lidhur me kërkesën e një OJQ-je kundër refuzimit nga Zyra e Kryeministrit lidhur me dhënien e qasjes në dokumente publike. Megjithatë, përveç obligimit të ZKM-së t'i jep të gjitha dokumentet e kërkuara, nuk është shqiptuar ndonjë dënim për shkelësit.

Pjesëmarrja në politikëbërje


Pjesëmarrja e OShC-ve në politikëbërje mund të bëhet në forma të ndryshme, por zakonisht pason ftesën e institucionit publik për dhënien e komenteve ose të kontributit në dokumentet e caktuara. Korniza ligjore në Kosovë parasheh përfshirjen e OShC-ve dhe të qytetarëve në vendimmarrje në të gjitha nivelet e qeverisjes, me përjashtim të nivelit të Kuvendit të Kosovës, ku përfshirja e OShC-ve është jo obligative. Përveç kushteve të përgjithshme të parapara në Kushtetutë, Rregullorja e Punës e Qeverisë parasheh konsultimet publike për të gjitha porpozimet e politikave dhe ligjeve, ku organi propozues duhet të jep informacionin e duhur dhe me kohë, si dhe informatat për rezultatet e konsultimit. Për më tepër, në prill të vitit 2016, Qeveria ka miratuar Rregulloren për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, që paraqet një bazë sistematike për konsultime me publikun, duke filluar nga caktimi i agjendës, të përfshirja e ekspertëve e deri te konsultimet e përgjithshme me publikun, me kushte specifike për secilin nga hapat. Në Rregulloren e Punës të Kuvendit parashihet mundësia joobliguese që të ftohen OShC-të në takimet e Komisioneve Parlamentare dhe të organizohen dëgjime publike. Ligji për vet-qeverisje lokale përmban mekanizma të ndryshëm të pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal, duke përfshirë konsultimet publike, komisionet sektoriale konsultative, peticionet, takimet publike me kryetarin e komunës, etj. Një Udhëzim administrativ për transparencën komunale është miratuar në fund të vitit 2015, ku përcaktohen një numër obligimesh për të siguruar publikimin e dokumenteve komunale dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Megjithëkëtë, dispozitat e kësaj rregulloreje janë shumë të paqarta dhe lënë shumë hapësirë për interpretim.⁵⁹

Praktika e përfshirjes së shoqërisë civile është ende e pakënaqshme, pasi që shpeshherë proceset e politikëbërjes nuk i plotësojnë kërkesat e parapara në legjislacionin në fuqi. Ekzistojnë probleme si lidhur me publikimin e projektligjeve, ashtu edhe me kohën e publikimit të tyre. Kështu, vetëm 8,2% e OShC-ve të anketuara konsiderojnë se të gjitha propozimet e politikave dhe ligjeve

58 Grupi i fokusit me OShC-të për monitorimin e efektshmërisë së parimeve zhvillimore, 24 mars 2016.

59 Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile: Raporti për Kosovën 2015. Raport. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile. KCSF, 2016.38


publikohen me kohë dhe 22.4% mendojnë se vetëm disa prej tyre publikohen me kohë, pra i plotësojnë kërkesat ligjore. Më shumë se gjysma e OShC-ve të anketuara (58.2%) përmendin çështjen e publikimit të propozimeve të politikave dhe ligjeve, qoftë në nivelin e publikimit të tyre apo të afateve të publikimit. Është interesant të thuhet se pothuajse një e treta e OShC-ve janë të painformuara për këtë proces - 18% deklaruan se nuk kanë njohuri për kërkesat ligjore apo praktikatat e konsultimit publik dhe 11% deklaruan se nuk e përcjellin procesin e hartimit të politikave



e ligjeve.

(Fig.54: Vlerësimi i OShC-ve për publikimin e propozimeve të politikave dhe ligjeve gjatë vitit 2015 – Burimi: Anketa me OShC)

Gjysma e OShC-ve të anketuara (51%) thanë se autoritetet publike e kishin ftuar organizatën e tyre në konsultime publike (takime konsultative, konsultime me shkrim, tryeza të rrumbullakëta, etj.). Prej atyre që janë ftuar, rreth gjysma e OShC-ve kanë marrë ftesa në baza të rregullta, sa herë që ka pasur zhvillime relevante për fushëveprimtarinë e tyre, ndërsa të tjerët janë ftuar kohë pas kohë ose rrallë. Shumica e OShC-ve të ftuara iu kanë përgjigjur pozitivisht ftesës, pasi që 42% e OShC-ve deklaruan se kanë marrë pjesë në procesin e politikëbërjes gjatë vitit 2015 (ku shumica dërrmuese e tyre kanë qenë nga ato që kanë pranuar ftesa nga institucionet publike).




(Fig.55: Ftesat ndaj OShC-ve për konsultime publike – Burimi: Anketa me OShC)

Siç është pritur, sa më e madhe hapësira gjeografike e mbuluar apo sa më i lartë që është niveli i institucioneve të mbuluara nga OShC-ja, aq më shumë ka gjasa që OShC-ja të ftohet nga institucionet publike. Në veçanti, nga ato OShC që janë aktive vetëm në një lokalitet (fshat apo qytet), 75% fare nuk janë ftuar. Nga ana tjetër, nga të gjitha OShC-të që janë aktive në nivel qendror me disa ministri/institucione, gjatë vitit 2015 të gjitha janë ftuar nga institucionet publike, qoftë rregullisht (42.9%) ose herë pas here (57.1%).

Nga ato që kanë marrë ftesë për konsultime publike, 61% deklaruan se janë konsultuar në fazën fillestare të procesit të hartimit të politikës/legjislacionit dhe se kanë marrë informata të mjaftueshme lidhur me përmbajtjen e dokumenteve. Rreth gjysma e OShC-ve thanë se kanë pasur kohë të mjaftueshme për dhënien e komenteve në propozimet e politikave apo ligjeve (15-20 ditë pune), shumë pak OShC (28%) besojnë se shërbyesit përgjegjës civilë janë trajnuar dhe kanë ofruar informata e këshilla të dobishme gjatë këtyre konsultimeve. Njëjtë sikurse në studimet e mëparshme, niveli i informatave kthyes nga institucionet publike mbetet shqetësues. Vetëm 17% e OShC-ve, komentet e të cilave nuk janë marrë parasysh gjatë konsultimeve publike kanë raportuar se kanë marrë ndonjë shpjegim /arsyetim me shkrim për atë se pse komentet e tyre nuk janë konsideruar. Të gjitha OShC-të që kanë marrë arsytet të tilla janë aktive në nivel lokal, gjë që sugjeron se mekanizmat e shpjegimit/arsyetimit janë më të zakonshme në nivelin lokal.

Edhe pse gjatë vitit 2015 një numër relativisht i madh i OShC-ve kishte marrë pjesë në hartimin e politikave dhe të legjislacionit, pjesa më e madhe e sektorit (61%) mendon se ndikimi i shoqërisë civile në hartimin e ligjeve dhe politikave është i kufizuar. Kjo gjithashtu vërtetohet edhe përmes të gjeturës se vetëm 15% e OShC-ve që kanë kontribuar në procesin e hartimit të politikave raportojnë se komentet e tyre gjatë konsultimeve janë pranuar plotësisht (15%), ku pjesa dërrmuese (73%) thanë se komentet e tyre janë pranuar vetëm pjesërisht.




(Fig.56: Perceptimi i OShC-ve për ndikimin e shoqërisë civile në politikëbërje – Burimi: Anketa me OShC)

Ndikimi i OShC-ve serbe në procesin e politikëbërjes ishte një nga çështjet e trajnuara gjatë hulumtimit. FG-të tregojnë se këto OShC janë shumë skeptike për fuqinë e ndikimit ndaj cilitdo procesi të vendimmarrjes në nivel qendror të Kosovës. Disa OShC deklaruan se kanë qenë të dekurajua për ndërmarrjen e ndonjë nisme sepse komuniteti serb në përgjithësi ka ndikim të kufizuar ndaj organeve vendimmarrëse dhe institucioneve në Kosovë. Sipas tyre, kjo vlen jo vetëm për OShC-të, por dhe për ligjvënësit e zgjedhur. Siç tha një pjesëmarrës në njërin prej GF “*Madje as përfaqësuesit serbë në Kuvendin e Kosovës nuk kanë fuqinë e ndikimit ndaj vendimmarrësve në nivel qendror*”. Disa OShC të tjera deklaruan se janë të dekurajua për shkak të tentimeve të dështuara të OShC-ve të tjera nga pjesa veriore e Kosovës në të kaluarën.

Për OShC-të e pjesës veriore të Kosovës, problemi kryesor me pjesëmarrjen në procesin e hartimit të ligjeve, politikave dhe strategjive duket të jetë mekanizmi i informatave kthyesë, qoftë me mungesën e këtyre informatave kur OShC kanë për qëllim pjesëmarrjen në hartimin e ligjeve të caktuara apo me mosnjohimin e OShC-ve pjesëmarrëse se si është marrë parasysh kontributi i tyre. Të qenit anëtar në rrjetet e OShC-ve duket se lehtëson këtë proces pasi që këto rrjete ua përcjellin organizatave anëtare të gjitha dokumentet, në të cilat kërkohet dhënia e komenteve gjatë fazës së hartimit. Platforma CiviKos, që është një rrjet i shtrirë në të gjithë vendin me numër mjaft të madh organizatash anëtare, duke përfshirë edhe ato serbe, është një shembull i mirë i kësaj. Përvoja me pushtetet lokale është më pozitive. Duke marrë parasysh lokacionin e tyre gjeografik në veri dhe përbërjen etnike, OShC-të nga ky rajon raportojnë një bashkëpunim më të frytshëm, derisa disa prej tyre thanë se kanë bashkëpunim të ngushtë me pushtetet lokale në pjesën veriore të Kosovës.

Përveç dërgimit të komenteve me shkrim dhe pjesëmarrjes në takimet publike të organizuara nga institucionet publike, OShC-të gjithashtu mund të avokojnë duke qenë pjesë e grupeve të ndryshme punuese apo organeve të tjera të themeluara nga institucionet publike. Në Anketën me OShC shihet se pjesëmarrja në këto organe është e zakonshme, edhe pse pjesa më e madhe e OShC-ve nuk kanë qenë pjesë e ndonjë grupi punues/këshilli/organi konsultativ. Vetëm 30% e OShC-ve të anketuara deklarojnë se përfaqësuesit e tyre kanë qenë të zgjedhur që të marrin pjesë në këshille/organe konsultative të themeluara nga institucionet publike.

Lidhur me procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në këto trupa, gjendja mbetet e pakënaqshme. Gjysma e atyre që kanë marrë pjesë janë ftuar drejtpërdrejtë nga institucionet publike, ndërsa një e treta janë përfshirë përmes një procedure transparente të shpallur publikisht. Vetëm 13.6% e tyre janë emëruar drejtpërdrejt nga shoqëria civile.



(Fig.57: Përvoja e OShC-ve me procedurat e përzgjedhjes në trupat e përbashkëta të themeluara nga institucionet publike – Burimi: Anketa me OShC)

Në mesin e OShC-ve që nuk kanë marrë pjesë në këto trupa të themeluara nga institucionet publike, pjesa më e madhe (73%) deklaruan se nuk kanë qenë të emëruara e as të ftuara. Megjithatë, duhet të theksohet se një pjesë e konsiderueshme (23%) deklaruan se nuk kanë qenë të interesuara të marrin pjesë në këshilla ose organe konsultative.



Ambienti i jashtëm

Shoqëria civile në Kosovë vazhdon të veprojë në një ambient të jashtëm të pavaforshëm. Ekonomia e Kosovës mbetet e pazhvilluar dhe nuk krijon mjaftueshëm vende pune. Niveli i papunësisë mbetet i lartë ndërsa qytetarët e Kosovës janë ndër më të varfërit e rajonit. Kushtet e rënda socio-ekonomike kanë rezultuar në një valë të gjerë migrimi gjatë viteve 2014 dhe 2015. Perceptimet mbi nivelin e korrupsionit dhe sundimit të ligjit nuk janë aspak të kënaqshme. Përkundër përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, vendi mbetet nikoqire dhe subjekt i organizatave të huaja politike, gjyqësore dhe ushtarake. Progresi fillestar në njohjen ndërkombëtare të Kosovës së fundi është ndalur. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 dhe marrëveshjet e mëvonshme me Serbinë dhe Malin e Zi kanë shkaktuar një krizës të gjatë politike. Polarizimi i spektrit politik ka bllokuar punën e Kuvendit të Kosovës për një pjesë të madhe të dy viteve të fundit. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim me BE-në, Kosova ka shënuar marrëdhënien e parë kontraktuale me BE-në. Megjithatë, progresi në reformat për anëtarësim në BE mbetet i kufizuar. Partitë politike të varura nga liderët e të cilave u mungon transparenca nuk japin shumë shpresë për progres. Kënaqshmëria me drejtimin politik të vendit është në rënie, sikurse edhe besimi ndaj institucioneve kryesore në Kosovë. Përkundër kësaj, gatishmëria e qytetarëve për t'iu bashkuar protestave publike është në rënie, ndërsa niveli i besimit ndërpersonal mbetet i ulët.

Ambienti në të cilin punon shoqëria civile në Kosovë është i vendosur brenda një konteksti më të gjerë. Konteksti shoqëror, politik dhe ekonomik i Kosovës është shumë sfidues dhe i pafavorshëm për punën e shoqërisë civile. Kapitujt më poshtë pasqyrojnë vetëm disa nga çështjet kryesore të ambientit të jashtëm të cilat ndikojnë në punën e shoqërisë civile.

Konteksti socio-ekonomik

Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, të realizuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (2012), Kosova ka 1,739,825 banorë, nga të cilët 50.3% janë meshkuj dhe 49.7% femra. Pothuajse 63% e popullatës së Kosovës janë më të ri se 34 vjet, duke bërë kështu vendin më popullatën më të re në Europë.⁶⁰

Kosova mbetet një nga vendet më të varfra në Europë me nivelin më të lartë të papunësisë, përkundër rritjes pozitive ekonomike madje edhe pas krizës financiare të vitit 2008. Me një BPV për kokë banori të vlerësuar afër 3.000 euro, të ardhurat mesatare janë sa afro një e dhjeta me ato të nivelit evropian. Varfëria mbetet e lartë. Vijat e standardizuara të varfërisë të përdorura nga Banka Botërore — të përcaktuara përmes pragut prej 5 dollarë amerikanë për person në ditë (sipas paritetit të fuqisë blerëse)—qojnë në shkallë të varfërisë prej 80 për qind. Nëse përdoret vija vendore e varfërisë prej 1,72 euro në ditë (të dhënat e vitit 2011) të përcaktuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, 29.7 % e popullatës konsiderohen si të varfër. Papunësia në shkallë të lartë dhe mungesa e vendeve cilësore të punës i kanë kontribuar varfërisë dhe pasigurisë së të ardhurave. Me një shkallë të vlerësuar të papunësisë prej 35.3 % në vitin 2014 dhe me një shkallë të punësimit prej vetëm 26.9 %, Kosova ka një prej shifrave më të ulëta të punësimit në Europë.⁶¹ Shkalla e pasivitetit të fuqisë punëtore është brengosëse. Në vitin 2015, shkalla e përgjithshme e pasivitetit ishte 62.4%, ndërsa te gratë kjo arrinte në 81.9%.⁶²

Zhvillimi ekonomik kryesisht ndikohet nga dërgesat monetare nga jashtë apo remitancat, ndihma e jashtme dhe nga investimet publike në bujqësi, pa ndonjë rritje thelbësore të kërkesës për fuqi punëtore e cila do të zvogëlonte presionin prej 20 000 të ardhurve të ri, të cilët çdo vit hynë në tregun e punës. Rritja e sektorit privat mbetet e kufizuar dhe dominohet nga ndërmarrjet individuale, të cilat punësojnë vetëm një person (56%), dhe nga sektorët që nuk kanë potencial për krijim domethënës të vendeve të punës dhe për tregti me pakicë apo me shumicë (43% e ndërmarrjeve të regjistruara).⁶³ Deficiti tregtar mbetet i madh: eksporteve që kanë arritur shumën prej afër 325.2 milionë euro në vitin 2015, u kundërvihet importi që arriti shifrën prej 2.634 miliardë euro.⁶⁴ Përveç kësaj, të punësuarit mbesin të cenueshëm për shkak të informalitetit të madh në ekonomi.

60 Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Regjistrimi i popullsisë 2011: Të gjeturat kryesore (Prishtinë, 2012). Mund të gjendet në: <https://ask.rks-gov.net/sq/rekos2011?download=333:te-dhenat-kryesore>

61 World Bank Country Program Snapshot for Kosovo, April 2016. Mund të gjendet në: <http://pubdocs.worldbank.org/en/419461462386476530/World-Bank-Kosovo-Program-Snapshot-April-2016.pdf>

62 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore të Kosovës 2015. Qershor 2016.24. Mund të gjendet në: <https://ask.rks-gov.net/en/lm?download=1636:results-of-the-kosovo-2015-labour-force-survey>

63 Oberholzner, Thomas. Report on SME's in Kosovo 2014. Kosovo SME Promotion Programme. 2014. Mund të gjendet në: http://www.eciks.org/repository/docs/Report_on_State_of_SMEs_in_Kosovo_2014_99378.pdf

64 Statistikat e tregtisë së jashtme 2015. Raport. Agjencia e Statistikave e Kosovës. Agjencia e Statistikave e Kosovës, 2016. 5. Qasur në: <http://ask.rks-gov.net/sq/tregetia-e-jashtme>

Një studim i fundit i Institutit RIINVEST konstaton se madhësia e sektorit informal në Kosovë shkon deri në 34% dhe 37%, varësisht nëse matet përmes numrit të ndërmarrjeve që u ikin pagesës së tatimit apo numrit të ndërmarrjeve që nuk raportojnë të punësuarit e tyre tek institucionet përkatëse të shtetit.⁶⁵ Një shkallë e ngjashme vërtetohet gjithashtu edhe nga Ministri i Financave në njërin prej fjalimeve të tij në Kuvendin e Kosovës në mars të vitit 2016.⁶⁶

Diaspora e madhe e Kosovës është rezultat i lëvizjeve tradicionale të qytetarëve të Kosovës në Europën Perëndimore dhe përtej për shkak të rrethanave të ndryshme politike dhe ekonomike. Megjithatë, një trend relativisht stabil i migrimit që zgjati disa vite me radhë u rrit në mënyrë dramatike në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015, ku një valë prej rreth 75 000 kosovarëve⁶⁷ migroi në shtetet e Evropës perëndimore. Në Pulsin Publik të UNDP-së IX, konstatohet se 75% e atyre që dolën nga Kosova gjatë valës së migrimit në vitet 2014-2015 kanë qenë meshkuj. Shumica e anëtarëve të tyre të familjeve në Kosovë raportuan për anketën e Pulsit Publik se arsyeja kryesore për daljen e tyre ishin kushtet e vështira socio-ekonomike në Kosovë. 45% të të anketuarve thanë se papunësia është arsyeja kryesore e migrimit të familjarëve të tyre, 29% thanë se arsyeja kryesore për këtë është varfëria, 10.5% vështirësitë ekonomike, ndërsa 10% thanë se ata dolën jashtë vendit në kërkim të një të ardhme më të mirë për familjet e tyre.⁶⁸

Konteksti socio-politik

Gjatë viteve të fundit, peizazhi politik i Kosovës ka përjetuar disa zhvillime karakteristike. Edhe pse kanë kaluar pothuajse katër vite që nga fundi i mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës nga një entitet i huaj, Kosova ende mbetet nikoqire dhe subjekt i organizatave politike, gjyqësore dhe ushtarake të huaja, siç janë NATO dhe EULEX. Të dyja këto organizata vazhdojnë të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm politik brenda Kosovës, ku në rastin e EULEX-it ky ndikim theksohet edhe më tej nga pushteti ekzekutiv që ka në gjyqësor. Ky pushtet ekzekutiv gradualisht do t'i bartet autoriteteve të Kosovës në varësi të EULEX-it, kur këta të fundit ta vlerësojnë se autoritetet kanë arritur përparim të mjaftueshëm në kapacitetet e tyre. Po ashtu, Kosova mbetet e sfiduar në arenën ndërkombëtare, pasi që pesë anëtare të BE-së dhe një numër domethënës i shteteve anëtare të OKB-së ende nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Pasi që siguroi njohjen e saj të fundit në mars të vitit 2015, procesi duket të jetë ngadalësuar në mënyrë të konsiderueshme. Deri më sot 111 shtete kanë njohur pavarësinë e Kosovës.⁶⁹

65 Zeka, Elda, Premton Hyseni, Julia Leuther, Gent Beqiri, Lumir Abdixhiku, Alban Hashani dhe Agon Nixha. *To Pay or Not to Pay: A Business Perspective of Informality in Kosovo*. Report. Riinvest. Pristina: Riinvest, 2013. Mund të gjendet në: http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2013/BUSINESS_INFORMALITY__ENG_FINAL.pdf

66 "31% e ekonomisë në Kosovë është jo formale." Mars 2016. Telegrafi. Qasur më 22 gusht 2016. <http://www.telegrafi.com/31-e-ekonomise-ne-kosove-eshte-jo-formale/>.

67 Avdiu, Plator. *Departure to the EU Member States: Causes and Consequences of Kosovo's Recent Migration*. Report. Kosovar Center for Security Studies. Kosovo: Kosovar CenterFor Security Studies, 2015. 7. Mund të gjendet në: http://www.qkss.org/repository/docs/Largimi_drejt_shteteve_an%C3%ABtare_t%C3%AB_BE-s%C3%AB_shkaqet_dhe_pasojat_e_migrimit_t%C3%AB_fundit_nga_Kosova_393497.pdf

68 Raporti i Pulsit publik. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara. IX ed. Prishtinë, Kosovë: UNDP, 2015. Mund të gjendet në: http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/pp9/PPR9_Anglisht.pdf

69 "Njohjet Ndërkombëtare të Republikës së Kosovës - Politika e Jashtme - Ministry of Foreign Affairs - Republic of Kosovo." Ministry of Foreign Affairs. Qasur më 22 gusht 2016. <http://www.mfa-ks.net/?page=1,224>.

Në bazë të raportit vjetor të Freedom House, Kosova ende kategorizohet si regjim gjysmë i konsoliduar autoritar, me vlerësimin e saj që ka shënuar rënie të vogël në 5.14.⁷⁰ Më 8 qershor 2014 janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, të cilat janë konsideruar si transparente dhe mirë të organizuara, duke shënuar kështu përparim nga zgjedhjet komunale të vitit 2013.⁷¹ Mirëpo, pas konfirmimit të rezultateve dhe për shkak të dallimeve politike që nxitën zgjedhjet e parakohshme, Kosova hyri në një periudhë të ngërçit politik. Ky ngërç u zgjodh vetëm pasi që dy partitë më të mëdha, PDK-ja dhe LDK-ja, arritën marrëveshjen për koalicion në dhjetor të vitit 2014.⁷² Edhe pse një qeveri e fuqishme në numra, shumë shpejt u ballafaqua me reagime të shumta nga opozita në disa raste. Çështjet siç janë demarkacioni me Malin e Zi, marrëveshjet me Serbinë lidhur me Asociacionin e Komunave Serbe dhe trajtimi i perceptuar i padrejtë përmes themelimit të Dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorisë, nxiti parti të ndryshme opozitare të formojnë një opozitë të bashkuar.⁷³ Kjo ndikoi në polarizimin e rritur mes forcave politike, gjë që nganjëherë nxiste edhe incidente të dhunshme.⁷⁴ Edhe pse partitë opozitare aktualisht nuk veprojnë si të unifikuara, ato ende kundërshtojnë marrëveshjet për demarkacionin me Malin E Zi dhe atë të Asociacionit të Komunave Serbe, duke mbajtur kështu tensionet politike në shkallë të lartë.

Dialogu politik për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë që filloi në vitin 2012 është duke vazhduar, edhe pse me një ritëm shumë më të ngadalshëm. Padyshim se marrëveshja më e rëndësishme që doli nga ky dialog deri më sot është marrëveshja e gushtit 2015 për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë. E cilësuar si marrëveshje historike nga qeveria dhe bashkësia ndërkombëtare, partitë opozitare të Kosovës kategorikisht e kanë refuzuar, duke nxitur protesta të ndryshme qoftë jashtë Kuvendit të Kosovës, ashtu edhe brenda tij, gjatë pjesës më të madhe të vjeshtës dhe dimrit të vitit 2015.

Edhe pse është e fundit në rajon në procesin e saj të anëtarësimit në BE, gjatë dy viteve të fundit Kosova ka shënuar përparim të dukshëm në këtë rrugë. Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA) në mes të Kosovës dhe BE-së përfunduan në maj të vitit 2014.⁷⁵ Këto negociata çuan në nënshkrimin e MSA-së mes Kosovës dhe BE-së më 27 tetor 2015, duke shënuar kështu marrëveshjen e parë kontraktuale mes këtyre subjekteve.⁷⁶ Marrëveshja në të cilën parashihen një numër obligimesh kontraktuale në fusha të ndryshme, ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016.⁷⁷ Thënë më konkretisht, përmes kësaj Marrëveshjeje Kosova fiton qasje në zonën tregtare të BE-së dhe

70 Gashi, Krenar. Nations in Transit 2015: Kosovo Report. Report. Freedom House. Freedom House, 2015. Mund të gjendet në: <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2015/kosovo>.

71 Kosovo Legislative Elections. Report. European Union Election Observer Mission, European Union External Action. European Union Election Observation Mission, 2014. Mund të gjendet në: http://eeas.europa.eu/eueom/missions/2014/kosovo/pdf/eu-eom-kosovo-2014-final-report_en.pdf

72 Gashi, Krenar. Nations in Transit 2015: Kosovo Report. Report. Freedom House. Freedom House, 2015. Mund të gjendet në: <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2015/kosovo>.

73 "Tash E Tutje, VV, AAK E Nisma, Opozitë E Bashkuar (Deklaratë)." Telegrafi. 2015. Qasur më 22 gusht 2016. <http://www.telegrafi.com/tash-e-tutje-vv-aak-e-nisma-opozite-e-bashkuar-deklarate/>.

74 Kosovo Progress Report 2015. European Commission (EC). EC, 2015. Mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

75 Kosovo Progress Report 2014. European Commission (EC). EC, 2014. Mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf.

76 Kosovo Progress Report 2015. European Commission (EC). EC, 2015. Mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf


77 "Stabilisation and Association Agreement (SAA) between the European Union and Kosovo Enters into Force." European Commission. Qasur më 22 gusht 2016. http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1184_en.htm.

mundësinë që të aplikojë standardet e BE-së në fushat, siç është konkurrenca, ndihmat shtetërore dhe prona intelektuale.⁷⁸

Duke qenë se partitë politike janë palët politike me ndikimin më të madh, financimi i tyre mbetet çështja më problematike. Partitë kryesore politike kryesisht financohen nga bizneset private, ndërsa raportet e shpenzimeve të tyre nuk janë publikuar, edhe pse ekzistojnë disa ligje ku parashihet që partitë politike ta bëjnë një gjë të tillë. Përkundër disa tentimeve për reformë të organizimit të tyre të brendshëm (p.sh. rekrutimi i aktivistëve të shoqërisë civile dhe aktivistëve të medieve vetëm disa muaj para zgjedhjeve), partitë politike ende varen nga liderët dhe nuk janë demokratike në vendimmarrje. Duke marrë parasysh këtë mentalitet, për interesa personale dhe politike, ato vazhdojnë të ushtrojnë ndikim ndaj institucioneve publike dhe të rrezikojnë pavarësinë e tyre.⁷⁹

Konteksti socio-kulturor

Gjatë vitit 2015 kënaqshmëria e qytetarëve me drejtimin e vendit ka shënuar rënie të mëtejshme, duke arritur kështu nivelet më të ulëta për një periudhë të gjatë kohore. Kënaqshmëria me punën e Qeverisë (17.3%), të Gjykatave (13.9%) dhe të Zyrës së Prokurorit (12.8%) ka arritur nivelet më të ulëta të shënuara ndonjëherë. Trendë të ngjashëm janë të pranishëm edhe në *kënaqshmërinë me punën e Kuvendit* (19.9%) dhe të Presidencës (30.4%). Pakënaqësia me drejtimin politik të vendit gjithashtu ka tendencë të rritjes dhe perceptimi i qytetarëve për drejtimin e demokracisë është në nivele shumë të ulëta e po ashtu edhe gatishmëria e qytetarëve për të protestuar kundër gjendjes politike është duke rënë.⁸⁰ Edhe pse paradoksale, kjo sinjalizon një dallim shqetësues mes vullnetit të qytetarëve për ndryshime dhe të besimit të tyre se një ndryshim i tillë më të vërtetë mund të arrihet.⁸¹



(Fig.58: Trendët e mendimeve të qytetarëve për drejtimin politik, proceset demokratike dhe gatishmërinë për protesta – Burimi: Pulsi publik i UNDP-së)

78 Po aty.


79 Visar Sutaj dhe Artan Canhasi. National Integrity System Assessment Kosovo. Report. Kosovo Democratic Institute. KDI, 2015. Mund të gjendet në: http://www.kdi-kosova.org/publikime/19-2015-10-31-kdi-tik-nis-eng_all_single_final-3.pdf

80 Public Pulse Report. United Nations Development Programme. X ed. Pristina, Kosovo: UNDP, 2015, p.3-7 http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-10/

81 Besnik Pula. "Hendeku i Shpresës." Sbunker. 2016. Qasur më 23 gusht 2016. <http://sbunker.net/teh/88052/hendeku-i-shpreses/>.

Nga pikëpamja e qytetarëve, përgjegjësia për këtë gjendje duket të jetë e qartë: Qeveria e Kosovës (69.5%) dhe partitë politike (21.2%) mbahen si institucionet kryesore përgjegjëse për gjendjen e tanishme politike. Megjithatë, rreth 3.5% e qytetarëve të Kosovës këtë përgjegjësi ia veshin shoqërisë civile.⁸²

Kur kemi të bëjmë me besimin e qytetarëve në institucione të ndryshme, institucionet e sigurisë (KFOR-i dhe Policia e Kosovës) gjenden në majë të listës, të pasuara nga OJQ-të dhe komunitetet fetare. Qytetarët gjithashtu u besojnë edhe ambasadave dhe BE-së, ndërsa institucionet dhe sektorët me më së paku besim janë Presidenti, Agjencia kundër Korrupsionit, Kuvendi, Qeveria dhe partitë politike.⁸³



(Fig.59: Niveli i besimit të qytetarëve në sektorë/institucione të ndryshme – Burimi: Anketat e RIINVESTIT)

Sipas Raportit të Progresit për Kosovën të vitit 2015 të Komisionit Europian, është arritur një përparim i caktuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, posaçërisht përmes përfshirjes së standardeve ndërkombëtare në kornizën ligjore. Megjithatë, mbrojtja e të drejtave të njeriut argumentohet se ende mbetet sfida për shkak të mungesës së burimeve dhe të vullnetit politik, veçanërisht në nivel lokal. Sipas Raportit të Progresit, mangësitë më të mëdha mbesin dhuna në baza gjinore dhe qasja e kufizuar e femrave në pronësi të pronave, shkelja e të drejtave të


82 Public Pulse Report. United Nations Development Programme. X ed. Pristina, Kosovo: UNDP, 2015, p.3-7 http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-10/

83 Matja e Opinioneve Publik. Report. Riinvest. Pristina, Kosovo: Riinvest, 2015. Mund të gjendet në: http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Opinion_i_Matja_Presentation1450193997.pdf

personave me aftësi të kufizuara, mungesa e hetimit të rasteve të dhunës drejt komunitetit LGBTI dhe moszbatimi i legjislacionit dhe strategjive përkitazi me të drejtat e pakicave.⁸⁴ Shoqëria civile mbetet shumë aktive në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, posaçërisht lidhur me të drejtat e femrave, të personave me aftësi të kufizuara, të pakicave etnike dhe të grupeve LGBTI. Për ta ilustruar këtë, më 17 maj 2015 – Ditën ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë – një numër OShC-sh organizuan marshin e tretë vjetor për shënimin e kësaj dite.⁸⁵

Liria e shprehjes gjithashtu ballafaqohet me probleme, e në veçanti liria e medieve. Ka pasur raste të gazetareve hulumtues që janë kërcënuar dhe u është kërkuar që të mos raportojnë për çështje të caktuara. Vehbi Kajtazi, kryeredaktor i gazetës në internet Insajderi, ka marrë kërcënime të drejtpërdrejta nga kryeministri Isa Mustafa.⁸⁶ Gazetarja e Radio Kosovës, Serbeze Haxhiaj, është kërcënuar sepse ka hetuar nëse njerëzit që nuk kanë qenë veteranë të luftës janë futur në listën e veteranëve të luftës me qëllim të përfitimit të pensioneve. Radio Kosova, radiostacion ky publik, nuk ka emetuar emisionin hulumtues të gazetares Haxhiaj për shkak të asaj që ajo e përshkuan si “censurë”.⁸⁷ Transmetuesi publik vazhdon të ballafaqohet me presione të rregullta nga palët politike në Kosovë, posaçërisht nga partitë politike në pushtet.

Ndërhyrja politike, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthorët, mbetet një shqetësim për transmetuesin publik, Radio-Televizionin e Kosovës (RTK), dhe për stacionet private mediale. RTK-ja, që financohet nga tatimpaguesit dhe udhëhiqet nga bordi i emëruar nga Kuvendi, shihet si zëdhënës i Qeverisë.⁸⁸ Këtë e thekson edhe BE-ja, përmes shefit të mëparshëm të Zyrës së BE-së në Kosovë.⁸⁹



(Fig.60: Niveli i besimit ndërpersonal në mes të qytetarëve – Burimi: Pulsit publik i UNDP-së)

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, qytetarët e Kosovës janë shumë të vëmendshëm kur kanë të bëjnë me të tjerët. Edhe pse me një rritje të vogël gjatë pesë viteve të fundit, niveli i besimit të ndërsjellë në mesin e qytetarëve të Kosovës mbetet shumë i ulët. Sipas Pulsit Publik të UNDP-së IX, vetëm 12.6% e kosovarëve deklarojnë se kur kanë të bëjnë me të tjerët, shumicës së tyre mund t’ju besohet. Duke marrë parasysh se elementi themelor i shoqërisë civile është ndërveprimi mes njerëzve, ky rezultat tregon vështirësinë e krijimit të bashkëpunimit dhe veprimeve të përbashkëta mes qytetarëve.

84 Kosovo Progress Report 2015. European Commission (EC). EC, 2015. Mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

85 “17 MAY - INTERNATIONAL DAY AGAINST HOMOPHOBIA & TRANSPHOBIA.” CEL Kosovo. Qasur më 22 gusht 2016. <http://cel-ks.org/news/401/17-may-international-day-against-homophobia-transphobia>.

86 “Kajtazi: Po, Kryeministri Më Kërcënoi.” Radio Evropa E Lirë. Qasur më 22 gusht 2016. <http://www.evropaelire.org/a/27626234.html>.

87 “Kosovo Watchdog Condemns Threat to Journalist” BalkanInsight. Qasur më 22 gusht 2016. <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-journalism-watchdog-condemns-veterans-threat-to-journalist>

88 Freedom of the Press 2015: Kosovo Report. Report. Freedom House. Freedom House, 2015. Mund të gjendet në: <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/kosovo>

89 “Zhbogar: BE e shqetësuar për presionet politike ndaj RTK-së.” Telegrafi. 2015. Qasur më 23 gusht 2016. <http://www.telegrafi.com/zhbogar-be-e-shqetesuar-per-presionet-politike-ndaj-rtk-se/>.



Anketa e Popullsisë për Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile 2016 është mundësuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) – Zyra në Kosovë, përmes përfshirjes së pyetjeve relevante në Anketën e Pulsit Publik të UNDP-së.

Përkrahur nga:

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo


SWEDEN